

FINANCIMI PUBLIK I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PRAKTIKAT E MIRA NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE BALLKANIN PERËNDIMOR

Me kërkesë të Zyrës së TACSO-s në Mal të Zi
*(Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shtetet e IPA-s -
EuropeAid/127427/C/SER/Multi)*

**“Ngritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në shtetet dhe territoret e
IPA-s”**

Përgatitur nga:

**Qendra Evropiane për të Drejtën Jo-profitabile (ECNL) (European Center for
Not-for-Profit Law)**

1052 Budapest, Apaczai Csere Janos në 17. Hungari
Tel: +36 1 318 6923; Fax: +36 1 266 1479; www.ecnl.org

Janar 2011

Ky dokument është kërkuar nga:



Projekti TACSO, Asistenca Teknike për
Organizatat e Shoqërisë Civile,
Zyra në Mal të Zi

Projekti “*Ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi*” ka si qëllim kryesor ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe forcimin e rolit të tyre në kuadër të demokracisë pjesëmarrëse. Rezultatet kryesore që priten nga ky projekt janë: rritja e influencës së OSHC-ve në proceset e vendimmarrjes demokratike; forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve që t’i çojnë përpara agjendat e tyre; avancimi i kapaciteteve të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve; forcimi i bashkëpunimit dhe rrjetëzimit mes OSHC-ve sikundër edhe në mes palëve të jashtme me interes dhe OSHC-ve; ngritja e vetëdijes së publikut mbi punën e OSHC-ve dhe përmirësimi i imazhit publik të OSHC-ve.

Dokumenti është përgatitur nga:



Qendra Evropiane për të Drejtën Jo-profitabile (ECNL) - një organizatë për përfitim publik, e cila është aktive në shumë vende të botës, ku promovon politikën në përkrahje të shoqërisë civile dhe krijimin e ambientit të favorshëm ligjor për OSHC-të në Evropë dhe më gjerë. ECNL-ja ndan me të tjerët modelet e ndryshme rregullative, mësimet e mësuara dhe përvojat ndërshtetërore si dhe ofron informacione krahasuese për të ndihmuar partnerët vendorë që të adaptohen apo të krijojnë zgjidhje të reja, në përputhje me ambientet ku veprojnë. ECNL-ja ofron ekspertizat më të mira mbi dispozitat ligjore që rregullojnë funksionimin e shoqërisë civile, duke përfshirë edhe ligjet për asociimin në organizatat joqeveritare, financimin publik, filantropinë, antiterrorizmin, pjesëmarrjen e publikut dhe partneritetet në mes të shtetit dhe shoqërisë civile. ECNL-ja ka mbështetur hartimin dhe implementimin e ligjeve, dokumenteve strategjike, zhvillimin e mekanizmave institucional që kanë të bëjnë me financimin publik të OSHC-ve në disa shtete dhe e ka hulumtuar këtë temë në mënyrë intensive me qëllim që t’i mbështesë iniciativat vendorë. Për më shumë informacione shihni: www.ecnl.org.

Dokumenti është hartuar nga Katerina Hadzi-Miceva Evans dhe Dragan Golubovic, këshilltarë të lartë ligjorë të ECNL-së në Budapest, me përkrahjen e Hanna Asipovich, koordinatore të projektit dhe Eszter Hartay, menaxheri i zyrës. Ky dokument mbështetet në gjetjet e hulumtimit “*Financimi publik i organizatave të shoqërisë civile në Evropë: Parimet dhe praktikën në procesin e tenderimit*” përgatitur nga ECNL 2010 (dokument që pritet të publikohet së shpejti)

VËREJTJE:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht edhe pikëpamjet e Komisionit Evropian.

TABLE OF CONTENTS

I. HYRJE	4
II. PËRMBLEDHJE E SHEMBUJVE NGA SHTETET E NDRYSHME	5
III. PARIMET E PRAKTIKËS SË MIRË NË FINANCIMIN PUBLIK	11
IV. FAZA E PROGRAMIMIT: PLANIFIKIMI I PROGRAMEVE FINANCUESE 14	
1. Çështjet që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të programit për financim	15
<i>Kohëzgjatja e skemave të granteve: donacionet afatshkurta dhe shumëvjeçare</i>	15
<i>Kushtet financiare: ndihmë në produkte apo shërbime (in-kind support) dhe kushti për financim të përbashkët</i>	16
<i>Llojet e veprimtarive: ofrimi i shërbimeve dhe avokimi</i>	17
<i>Llojet e përkrahjes: përkrahja për projektin dhe përkrahja institucionale</i>	18
2. Çështjet që duhet marrë në parasysh në rastet e financimit institucional	19
V. FUSHËVEPRIMI I PËRFITUESVE: KRITERET KUALIFIKUESE	22
1. A duhet që programi t'i mbështesë të gjitha OSHC-të apo vetëm organizatat e kualifikuara?	24
2. Cilët janë faktorët që duhet të merren parasysh me rastin e përcaktimit të rrethit të aplikantëve të kualifikuar?	25
<i>Kriteri institucional</i>	25
<i>Kriteret që kanë të bëjnë me projektin/programin</i>	27
<i>Kriteri financiar</i>	28
<i>Përqindjet e lejuara të shpenzimeve institucionale/të përgjithshme të projektit</i>	30
<i>Kërkesat teknike</i>	31
VI. TENDERIMI I GRANTIT DHE PROCESI I APLIKIMIT	32
1. Tenderimi një apo dyfazësh	33
2. Sistemet e para-kualifikimit	33
3. Dizajni (përmbajtja & forma) i konkursit për grant	33
4. Shpallja e tenderit	36
5. Koha dhe afatet	36
6. Dokumentacioni i nevojshëm	38
VII. VENDIMARRJA	39
1. Komisioni përzgjedhës.....	39
<i>Konflikti i interesit</i>	41
2. Kriteret e seleksionimit	41
<i>Kriteret objektive kundrejt atyre subjektive</i>	41
<i>Zgjedhjet themelore strategjike dhe politikat e përzgjedhjes</i>	45
3. Procesi i vendimmarrjes.....	46
<i>Metodat, proceset dhe rregullat e vendimmarrjes</i>	46
<i>Transparenca dhe komunikimi i kritereve dhe vendimit</i>	47
VIII. KONTRAKTIMI DHE PAGESAT	49
1. Përmbajtja e kontratës	49
2. Modifikimi i kushteve të kontratës	50
3. Çështja e afateve në kontratë	51
4. Çështjet financiare gjatë kontraktimit	51
IX. VLERËSIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI	52
1. Pse duhet bërë vlerësimi?.....	52

2. Çështjet që duhet marrë parasysh gjatë përgatitjes së mekanizmave vlerësuese dhe monitoruese.....	54
3. Kërkesat për raportim	57
X. VËREJTJET DHE REKOMANDIMET PËRMBYLLËSE.....	58
BIBLIOGRAFIA.....	62

I. HYRJE

Zyra e TACSO-s në Mal të Zi mandatoi ECNL-në të përgatisë një analizë gjithëpërfshirëse të praktikave të mira në financimin publik (shtetëror) të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-të), të mbështetur me shembuj konkret nga shtete të zgjedhura të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe shtete tjera anëtare të BE-së. Analiza ka për qëllim t'i ndihmojë palët me interes ta kuptojnë më mirë këtë problematikë dhe të krijojnë bazën për forcimin e kornizës ligjore dhe praktikës së financimit të OSHC-ve nga fondet publike në Mal të Zi.

Dokumenti është pjesë përbërëse e komponentit të projektit TACSO të quajtur: *Ndërtimi i marrëdhënieve në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të jashtme me interes*. Raporti mbi vlerësimin e nevojave (NA) i përgatitur nga TACSO e Malit të Zi, ka nxjerrë në pah mungesën e efikasitetit dhe transparencës në financimin publik të OSHC-ve, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë kombëtar. Raporti në fjalë rekomandon ndërmarrjen e veprimeve të mëtutjeshme për të përmirësuar kornizën ligjore dhe praktikën në procesin e financimit të OSHC-ve nga fondet publike.

Dokumenti është hartuar me qëllim që të:

1. Ofrojë një përmbledhje të çështjeve më të rëndësishme që duhet të merren parasysh me rastin e planifikimit të financimit shtetëror të OSHC-ve;
2. Prezantojë shembuj nga shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimi Evropian që do të ndihmojnë për të ilustruar probleme teorike;
3. Potencojë praktikën më të mira të shpërndarjes së fondeve publike për OSHC-të.

Dokumenti bazohet në shembuj nga skemat dhe mekanizmat e financimit publik që praktikohen në Kroaci, Angli, Estoni, Hungari dhe IRJ të Maqedonisë. Përzgjedhja e këtyre shteteve është bërë për arsyet e mëposhtme:

- Janë shtete me sistem ligjor të ngjashëm me atë të Malit të Zi;
- Janë shtete me traditë më të gjatë të financimit shtetëror dhe bashkëpunimit me OSHC-të;
- Janë shtete që mund t'i ndajnë përvojat e implementimit me të tjerët;
- Janë shtete që aplikojnë mekanizma inovativë në financimin publik;
- Janë shtete me mekanizma shtetërore të financimit që mund të shërbejnë si model;
- Iniciativat janë më shumë në nivel kombëtar sesa në atë lokal.

Pas ndryshimeve të kohëve të fundit të qeverive në Angli dhe Hungari, këto shtete kanë bërë ose planifikojnë të bëjnë ndryshime në kornizën që rregullon bashkëpunimin me OSHC-të dhe financimin e tyre. Për këtë arsye disa nga iniciativat e analizuara në këtë dokument mund të mos jenë më në fuqi apo mund të kenë ndryshuar. Pavarësisht kësaj, (*autorët mendojnë se*) mekanizmat e financimit në këto shtete, të analizuara në dokument, paraqesin shembuj të vlefshëm që ia vlen të shqyrtohen.

Dokumenti mbështetet në hulumtimet e kryera, shikimin e formularëve dhe dokumentacionit që lidhet me procesin e implementimit të financimit dhe kontraktimit si dhe diskutimet me disa nga partnerët në shtetet e zgjedhura. Dokumenti merr parasysh edhe studimet dhe analizat e mëhershme të ECNL-së mbi mekanizmat e financimit shtetëror në shtetet e Evropës dhe Bashkimit Evropian dhe bazohet në rekomandimet që ka bërë ECN-ja me qëllim që t'i prezantojë zgjidhjet më të mira për përmirësimin e mekanizmit të financimit publik të OSHC-ve.

Analiza fillon me një vështrim të shteteve të zgjedhura – ku prezantohet ambienti për financim dhe mekanizmat institucionalë për bashkëpunim me OSHC-të. Pas kësaj pason një shqyrtim i detajuar i praktikave të mira në të gjitha fazat e procesit të financimit të OSHC-ve. Dokumenti përqendrohet në çështjet e mëposhtme të procesit për fitimin e granteve: (1) parimet e praktikave të mira në financimin publik, (2) çështjet që duhet marrë parasysh në fazën e programimit, kur planifikohet mekanizmi i financimit publik; (3) fushëveprimi i përfituesve që kualifikohen për financim publik dhe kriteret e ndryshme që duhet të merren parasysh në këtë proces; (4) përshkrimi i problemeve në tenderimin e granteve dhe procesi i aplikimit; (5) faza e vendimmarrjes; (6) nënshkrimi i marrëveshjeve dhe pagesat; dhe (7) vlerësimi, monitorimi dhe raportimi për projektin e financuar dhe për gjithë programin financues.

Shpresojmë se ky dokument do t'iu shërbejë palëve me interes (politik-bërësve në nivel kombëtar respektivisht në atë lokal, sikurse edhe OSHC-ve) si udhërrëfyes për përmirësimet e mëtutjeshme të kornizës ligjore për financimin publik. Dokumenti përfundon duke vënë theksin në aspektet kryesore që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të një kornize të këtillë.

II. PËRMBLEDHJE E SHEMBUJVE NGA SHTETET E NDRYSHME

Ky dokument analizon mekanizmat ekzistues të financimit në Kroaci, Angli, Estoni, Hungari dhe IRJ të Maqedonisë. Në këtë seksion prezantohet një përmbledhje e shkurtër e secilit nga këto pesë shtete.¹ Aty përshkruhet konteksti në të cilin kanë lindur praktikat e mira, që para së gjithash lidhen me këto elemente: korniza e përgjithshme për bashkëpunim në mes të qeverisë dhe OSHC-ve; institucionet dhe mekanizmat që rregullojnë financimin publik të OSHC-ve dhe korniza ligjore dhe rregullative e procedurave të financimit publik. Janë prezantuar shkurtimisht edhe shembuj ku tregohet roli i lotarisë në financimin e OSHC-ve, sepse kemi vënë re se të ardhurat nga lojërat e fatit janë gjithashtu pjesë e rëndësishme e skemës së financimit publik² në Mal të Zi.

Kroacia:

Kroacia³ është shteti i parë i Ballkanit Perëndimor që ka ndërmarrë nisma për krijimin e mekanizmave të veçantë për bashkëpunim mes qeverisë dhe sektorit joqeveritar dhe një

¹ Përshkrimi i shteteve në këtë dokument bazohet kryesisht në materialet e mëposhtme: Hadzi-Miceva, K., “*Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për bashkëpunimin e qeverisë dhe sektorit joqeveritar në Hungari, Estoni dhe Kroaci*”, në “Organizacje pozarządowe. Dialog obywatelski. Polityka państwa,” redaktuar nga Marek Rymsza, publikuar nga Instituti për punë të jashtme, 2007, Poloni dhe Hadzi-Miceva-Evans, K., “*Praktikat evropiane mbi implementimin e dokumenteve strategjike dhe zyrat ndërlidhëse që mbështesin zhvillimin e shoqërisë civile*”, ICNL dhe ECNL, 2009

² Për më shumë informacion mbi lojërat e fatit shih: Hadzi-Miceva Evans, K., “*Kontributet e lotarisë si instrument për mbështetjen e kauzave të mira dhe organizatave të shoqërisë civile – Fat apo koncept i planifikuar?*”, në „Trzeci Sektor” gazetë tremujorëshe (Katerina Hadzi-Miceva „Loterie charytatywne w Europie. Współczesne rozwiązania w wybranych krajach”, botimi 22, 2010

³ Përshkrimi i rastit të Kroacisë në këtë dokument para së gjithash bazohet në librin e mëposhtëm: Vidacak, Igor., “*Krijimi i standardeve dhe mekanizmave për financimin publik të OJQ-ve në*

mekanizëm që mbështet financimin transparent të OSHC-ve. Në vitin 1998, qeveria krijoi Zyrën për shoqata e cila ishte përgjegjëse, përpos tjerash, edhe për shpërndarjen e fondeve shtetërore për OSHC-të. Zyra e qeverisë për shoqata inicioi krijimin e një modeli të ri, i cili synonte ta decentralizojë bashkëpunimin dhe financimin shtetëror nga një zyrë e centralizuar në disa palë të ndryshme me interes. Modeli i ri ngarkon ministritë, agjencitë qeveritare dhe institucionet e ndryshme me përgjegjësi për kanalizimin e fondeve shtetërore drejtpërdrejt te OSHC-të aktive në fushën përkatëse. Me qëllim që të sigurojë një proces transparent të financimit, në vitin 2007 qeveria miratoi *Kodin e praktikës, standardeve dhe kritereve të mira për ndarjen e granteve për programet dhe projektet e shoqatave* (këtej e tutje do t'i referohemi si: Kodi kroat) që përcakton rregullat dhe procedurat themelore të cilave duhet t'iu përmbahen autoritetet publike në të gjitha nivelet me rastin e ndarjes së granteve publike.

Fondacioni kombëtar për shoqëri civile (këndej e tutje: Fondacioni kombëtar kroat) u themelua në vitin 2003, duke u mbështetur në modelin e decentralizimit. Fondacioni është themeluar dhe financohet kryesisht nga kontributet e lojërave të fatit. Fondacioni kombëtar kroat është njohur nga vendet e rajonit si institucioni kryesor që mbështet OSHC-të përmes mekanizmave menaxhuese dhe procedurave financuese të planifikuara me kujdes. Politikat e Fondacionit kombëtar kroat për ndarjen e granteve, politikat mbi konfliktin e interesave si dhe Kodi kroat janë shembuj të mirë për shtetet tjera që ndodhen në të njëjtën fazë të zhvillimit të shoqërisë civile. Fondacioni kombëtar kroat është donatori më i madh që siguron mbështetje institucionale për OSHC-të. Ky Fondacion ka nënshkruar marrëveshje me katër fondacione rajonale, përgjegjëse për menaxhimin e programeve të donacioneve për komunitetet në rajonet përkatëse.

Fondacioni kombëtar kroat parqet pjesë të një kornize më të gjerë e cila e lidh shoqërinë civile dhe qeverinë kroate. Ai është komplementar me sistemin e “modelit të ri” tre palësh kroat⁴ ku përfshihen Zyra e qeverisë për shoqata, *Strategjia për zhvillimin e shoqërisë civile* e vitit 2006 dhe Këshilli për zhvillimin e shoqërisë civile, një organ i specializuar këshillues i qeverisë kroate. Këshilli ka për detyrë të mbikëqyrë, analizojë dhe vlerësojë financimin nga buxheti i shtetit dhe të sigurojë që kjo të bëhet në përputhje me Kodin.

Në vitin 2009 në Kroaci kishte më shumë se 37.000 organizata të regjistruara të shoqërisë civile, duke përfshirë shoqata, fondacione, organizata sportive dhe religjioze.⁵

Po këtë vit, financimi qeveritar për organizatat e shoqërisë civile kapte shumën prej 529.596.954,21 kuna (pak më shumë se 71.3 milionë euro), që është për 15.5% më pak se në vitin 2008. 46.2% e kësaj shume u siguroi nga lojërat e fatit, ku pjesa më e madhe e fondeve u dhanë përmes Ministrisë së Shkencës, Arsimit dhe Sportit (31% e fondeve të përgjithshme). Sporti është aktiviteti më i financuar (31%), pasuar nga projektet në fushën e kulturës, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e rrezikuara sociale.

Kroaci”, Gazeta ndërkombëtare e Ligjit jo për profit (IJNL), <http://www.icnl.org/knowledge/ijnl/index.htm>

⁴ Për më shumë informacion në lidhje me këtë model *shih*: Hadzi-Miceva Katerina, “Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për bashkëpunimin Qeveri-OJQ në Hungari, Estoni dhe Kroaci,” në “Organizacje pozarządowe. Dialog obywatelski. Polityka państwa,” redaktor Marek Rymysza, (Instituti për çështje publike, Poloni).

⁵ USAID, *Indeksi i qëndrueshmërisë së OJQ-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euro-Azi: Kroaci*, www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex 2009.

Nga viti 1999 deri në 2009 shteti ka financuar 27.543 projekte të OSHC-ve, që do të thotë se për këtë sektor janë alokuar më shumë se 320 milionë euro. Sipas hulumtimit në të cilin janë përfshirë OSHC-të që kanë përfituar fonde nga buxheti i shtetit në vitin 2008, pothuajse 70% e OSHC-ve si burim kryesor të financimit e kanë financimin nga buxheti qendror, respektivisht buxhetet rajonale/lokale.

Anglia:

Anglia ka traditë të gjatë të bashkëpunimit me OSHC-të (me organizata bamirëse dhe vullnetare). Financimi qeveritar shpeshherë kanalizohet përmes organeve tjera, si për shembull përmes qeverive lokale dhe agjencive rajonale për zhvillim, agjencive publike joqeveritare dhe fondit lokal të Shërbimit kombëtar shëndetësor.⁶ Kontributet e lotarisë sigurojnë mjete të rëndësishme për OSHC-të që ushtrojnë veprimtarinë në fusha të caktuara. Gjatë dekadës së kaluar kishte shumë iniciativa si nga qeveria ashtu edhe nga agjencitë financuese dhe OSHC-të me qëllim të përmirësimit të praktikave të financimit. Financimi qeveritar mbështet edhe ueb-portalet që lehtësojnë implementimin e skemave të granteve dhe qasjen në informata mbi mundësitë e financimit (për shembull: governmentfunding.org.uk, [Decision Support Tool](http://DecisionSupportTool.org.uk)⁷ dhe fundingcentral.org.uk).

Bashkëpunimi është institucionalizuar përmes Zyrës për shoqëri civile, e cila është reformuar kohëve të fundit dhe funksionon në kuadër të kabinetit qeveritar. Kjo zyrë mbështet në mënyrë aktive sektorin e OSHC-ve përmes bashkëpunimit dhe financimit, ndërmarrësisë sociale, ligjit për bamirësi, rregullimit të punës vullnetare dhe filantropisë si dhe rolit të sektorit në shërbimet publike. Në vitin 2008, Qeveria dhe OSHC-të arritën *marrëveshjen e quajtur Marrëveshja mbi marrëdhëniet në mes të qeverisë dhe sektorit vullnetar dhe komunitetit (këtej e tutje: Marrëveshja angleze)*, e cila përcakton detyrime për të dyja palët që ta përmirësojnë mënyrën e punës në të mirë të komuniteteve dhe qytetarëve. Marrëveshja u rishikua në vitin 2009. Ky dokument përcakton listën e 'Vlerave të marrëveshjes' dhe zotimet në tre fusha – përfshirja në hartimin e politikave publike, ndarja dhe distribuimi i mjeteve dhe arritja e barazisë.⁸

Në Angli dhe Uells veprimtarinë e tyre e ushtrojnë 180.918 organizata bamirëse.⁹ Financimi qeveritar për OSHC-të në vitin 2007/08 kapte shumën 12.8 miliardë funte, që

⁶ NCVO, *Shteti dhe sektori vullnetar; Trendet aktuale në financimin qeveritar dhe ofrimin e shërbimeve publike*, 2009, www.ncvo-vol.org.uk

⁷ Zyra e auditorit kombëtar, *Instrumenti për vendimin mbi mbështetjen e organeve publike në Angli*, www.nao.org.uk/guidance_and_good_practice/toolkits/better_funding.aspx

⁸ Marrëveshja e rishikuar e zëvendësoi Marrëveshjen e vitit 1998 dhe pesë kode të praktikës, duke përfshirë edhe *Kodin e praktikës së mirë të financimit dhe prokurimit* www.thecompact.org.uk

⁹ <http://www.charity-commission.gov.uk/showcharity/registerofcharities/registerhomepage.aspx> (të dhëna nga 1 dhjetori i vitit 2010) Sidoqoftë, organizatat bamirëse nuk janë forma e vetme e aktiviteteve të OSHC-ve. Ato përbëjnë rreth gjysmën e 865.000 OSHC-ve në Mbretërinë e Bashkuar. Komisioni Evropian, *"Iniciativat e fundit publike dhe vetërregulluese që synojnë të rrisin*

përbën më shumë se një të tretën e të gjitha të ardhurave të këtij sektori. Rreth 40.000 organizata janë të lidhura financiarisht me sektorin publik, por më shumë se 75% e OSHC-ve nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta financiare me shtetin.¹⁰ Pjesa më e madhe e fondeve që vijnë nga resurset shtetërore u shpërndahet organizatave që punojnë në fushat e shërbimeve sociale.

Kontributet e lotarisë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të financimit shtetëror. 28% e të ardhurave nga lojërat e fatit u shpërndahen organizatave jofitimprurëse të kategorive të mëposhtme: organizatave për bamirësi dhe atyre që punojnë në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe ambientit (50%); sportit (16.67%); arteve (16.67%); dhe trashëgimisë (16.67%). Deri më tani janë ndarë 25 miliardë £ për rreth 350.000 projekte.¹¹ Donatori më i madh nga lojërat e fatit është Fondi i madh i lotarisë (the Big Lottery Fund).

Estonia:¹²

OSHC-të në Estoni pranojnë fonde nga disa burime në nivel kombëtar (ministritë, lojërat e fatit, fondacionet kombëtare) dhe në nivel lokal. Burimet më të rëndësishme të financimit janë donacionet nga lojërat e fatit; sidoqoftë, ky fond është zvogëluar rreth 30 për qind në vitin 2009. Në vitin 2008, Estonia themeloi Fondacionin kombëtar për shoqëri civile (këtej e tutje: Fondacioni estonez) duke u mbështetur në përvojat e Kroacisë dhe Hungarisë. Fondacioni parashihet përfshirjen e disa inovacioneve interesante në sistemin e tij, siç është për shembull shpërblimi i OSHC-ve për menaxhimin e mirë të projekteve. Fondacioni estonez ka si kusht për financim respektimin e *Kodit të etikës së organizatave jo-profitabile të Estonisë* (që është hartuar nga vetë sektori i OSHC-ve), kurse organizatat që aplikojnë për fonde nga Fondacioni duhet të tregojnë se në çfarë mënyrë i respektojnë parimet e Kodit.¹³

Në vitin 2009 qeveria miratoi konceptin e financimit shtetëror ku përshkruhen problemet e financimit publik bazuar në një analizë të detajuar të praktikave ekzistuese. Ky dokument ka për qëllim të harmonizojë praktikat e financimit në mes të institucioneve të ndryshme

transparencën dhe llogaridhënien e organizatave joqeveritare në Bashkimin Evropian", të hartuar nga ECNL, 2009, www.ecnl.org

¹⁰ NCVO, Komisioni financues, *Dokumenti 4- Financimi i sektorit publik - Gjetjet dhe rekomandimet, 2010*, www.ncvo-vol.org.uk

¹¹ www.lotterygoodcauses.org.uk/lottery-grants/lottery-grant-faq/

¹² Informacioni mbi Estoninë në këtë dokument është përgatitur me ndihmën e z. Agu Laius, Drejtor ekzekutiv dhe znj. Merlin Sepp, Koordinator i programit të Fondacionit kombëtar të Estonisë për zhvillimin e shoqërisë civile, www.kysk.ee/. Për më shumë informata shihni: Kubar, Urmo., "Koncepti i zhvillimit të shoqërisë civile në Estoni (EKAK): Korniza e bashkëpunimit të sektorit të tretë dhe atij publik: vështrim i shkurtër dhe disa mësimet të mësuara", Konferenca Evropiane „Si të forcohet dialogu civil në Evropë?“, 15 maj 2008, Bruksel dhe USAID, *Indeksi i qëndrueshmërisë së OJQ-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazi: Estonia*, www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex 2009 dhe 2008.

¹³ Për më shumë në lidhje me Kodin shih: Komisioni Evropian, " *Iniciativat e fundit publike dhe vetërregulluese që synojnë të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e organizatave joqeveritare në Bashkimin Evropian* ", hartuar nga ECNL, 2009, www.ecnl.org

publike, të rrisë transparencën dhe efikasitetin dhe ta bëj financimin shtetëror më të fokusuar dhe më efikas.¹⁴

Numri i OSHC-ve të regjistruara në Estoni është 30.267 prej të cilave 813 janë fondacione dhe 29.454 janë shoqata. Gjatë vitit të parë të aktivitetit të tij më 2008, Fondacioni estonez mbështeti 85 projekte me një shumë të përgjithshme prej 23 milionë kroons (përafërsisht 1.5 milion euro). Gjatë periudhës 2008-2011 shteti ndau rreth 20 milionë kroons të Estonisë (rreth 1.3 milion Euro). Në vitin 2007, ministritë ndanë rreth 700 milionë kroons estoneze (rreth 44 milionë Euro).

Bashkëpunimi me OSHC-të është institucionalizuar nëpërmes Departamentit për qeveri lokale dhe Departamentit për çështje rajonale, nën patronazhin e Ministrisë për Çështje Rajonale¹⁵ e cila ka detyrë specifike të ndërmarrë aktivitete për të mbështetur zhvillimin e shoqërisë civile. Parlamenti estonez miratoi në vitin 2002 *Konceptin estonez për zhvillimin e shoqërisë civile – EKAK* dhe ia dërgoi qeverisë për implementim. Qëllimet dhe aktivitetet kryesore të EKAK-s janë implementuar me sukses. Ekspertët lokalë kanë theksuar se: *“EKAK ka mundur një qasje strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile (në vend se të merret me projekte të rastit). Duke iu falënderuar këtij dokumenti, Estonia ka një shoqëri civile funksionale dhe sektor të qëndrueshëm të OJQ-ve jo-profitabile”*.¹⁶ Qeveria miratoi planet për zhvillim në përputhje me dokumentin e EKAK, me qëllim që të bëjë të mundur realizimin e synimeve afatgjate të EKAK-ut dhe të sigurojë vazhdimin e implementimit të aktiviteteve të saj.¹⁷

Hungaria:

Hungaria është e njohur mes shteteve të Evropës Qendrore për ndihmën e gjithanshme që ky vend u jep organizatave të shoqërisë civile. Hungaria ofron financim shtetëror përmes një numri të madh të kanaleve qendrore dhe lokale. Qeveria ndanë fonde për OSHC-të nga “mekanizmi i përqindjes,” përmes së cilit ndahen mjete nga fondet e taksapaguesve për të mbështetur OSHC-të. OSHC-të gjithashtu financohen edhe nga kanalet e centralizuara, siç janë buxhetet e ministrive të caktuara, programet e granteve që udhëhiqen nga ministritë, subvencionet që u ndahen organizatave shoqërore nga buxheti i shtetit ose fondacionet publike (fondacionet kuazi-qeveritare grant-dhënëse të themeluara nga parlamenti, qeveria kombëtare apo qeveritë lokale).¹⁸ Viteve të fundit Hungaria ka filluar të zhvillojë në legjislacionin e saj parimet dhe procedurat univerzalisht të zbatueshme që kanë të bëjnë me financimin e OSHC-ve, duke përfshirë edhe Ligjin mbi transparencën në financimin publik (të vitit 2008, i plotësuar në vitin 2010).

¹⁴ Shih: <http://www.siseministerium.ee/>

¹⁵ Ministria e Çështjeve Rajonale vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

www.legaltext.ee/en/andmebaas/ava.asp?m=022

¹⁶ Kubar, Urmo., “*Koncepti i zhvillimit të shoqërisë civile në Estoni (EKAK): Kornizë për bashkëpunim në mes sektorit të tretë dhe atij publik: Vështrim i shkurtër dhe disa mësim të nxjerra*”, konferenca evropiane „Si të forcohet dialogu civil në Evropë“, Bruksel, Maj 15, 2008

¹⁷ Planet e zhvillimit mund t’i gjeni në: <http://www.ngo.ee>

¹⁸ Hadzi-Miceva K., dhe Suplisson, F., “Vështrim i skemave shtetërore të financimit për organizatat e shoqërisë civile”, ECNL dhe COW I/A (2007)

Fondi qytetar kombëtar (këtej e tutje: Fondi qytetar hungarez) u themelua në vitin 2003 me qëllim që ta plotësojë ndihmën e shtetit për OSHC-të, e cila realizohet përmes mekanizmit ekzistues të përqindjes. Fondi synon forcimin e aktiviteteve të OSHC-ve dhe zhvillimin e sektorit të tretë, duke ndarë grante për të mbuluar shpenzimet operacionale të organizatave të shoqërisë civile, hulumtimet mbi sektorin e tretë dhe format tjera të aktiviteteve. Fondi gjithashtu përcakton prioritetet dhe kahet e zhvillimit të këtij sektori, duke hartuar politikat e veta mbi mekanizmat financues. Fondi qytetar hungarez administrohet nga Këshilli dhe një numër i kolegjeve rajonale. Ai ua mundësoi përfaqësuesve të OSHC-ve që për herë të parë të marrin pjesë në shpërndarjen e fondeve.¹⁹

Nga korriku i vitit 2010 puna e Fondit qytetar hungarez bien në përgjegjësinë e Ministrisë të Administratës dhe Drejtësisë. Ministri i koordinon detyrat e qeverisë që kanë të bëjnë me zhvillimin e marrëdhënieve qytetare dhe shoqërore, përgatit konceptet për legjislacionin që rregullon sektorin civil, koordinon ekzekutimin e strategjisë së përgjithshme qytetare të qeverisë dhe politikat e granteve dhe zbaton detyrat tjera që synojnë zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore dhe qytetare.

Në vitin 2002, Qeveria miratoi *Dokumentin strategjik të Qeverisë hungareze mbi shoqërinë civile*. Elementet kryesore të Strategjisë u implementuan, ndërsa në të njëjtën kohë u realizuan edhe qëllimet kyçe të këtij dokumenti (siç ishin: themelimi i Fondit kombëtar qytetar; miratimi i legjislacionit mbi voluntarizmin; rritja e përqindjes së financimit publik në të hyrat/ardhurat e OSHC-ve). Në vitin 2007, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale e cila ishte përgjegjëse për çështjet qytetare, para ndërrimeve të fundit në qeveri të ndodhura në vitin 2010, miratoi *Rezolutën mbi dispozitat për zhvillimin e marrëdhënieve qeveri-qytetarë* me qëllim të përparimit të mëtutjeshëm të raporteve mes qeverisë dhe sektorit të OSHC-ve. Rezoluta identifikon parimet udhëheqëse dhe krijon procedurat për bashkëpunim me sektorin e tretë në nivel të qeverisë. Rezoluta përcakton pesë qëllimet kryesore si dhe parasheh detyrat dhe afatet kohore për arritjen e këtyre synimeve. Një nga këto pesë synime është krijimi i një ambienti të përshtatshëm për financim qeveritar. Dy detyrat kryesore në kuadër të këtij qëllimi janë: (1) krijimi i organizatës së përbashkët ministrore dhe puna e saj në menaxhimin e granteve dhe (2) sigurimi i procedurës transparente të financimit, lehtësimi i barrës administrative, vlerësimi i dobisë nga grante e shpërndara dhe ngritja e kapaciteteve të organizatave që aplikojnë për donacione.

Në vitin 2008 në Hungari kishte 57.693 OSHC. Shuma e përgjithshme e financimit të drejtpërdrejt të OSHC-ve nga qeveria në këtë vit ishte 484.600 miliardë HUF (rreth 1.73 miliardë euro). Kjo shënon rritje në financim krahasuar me vitet e mëparshme. Nga kjo shumë, 2.816 miliardë HUF (rreth 10.057 milionë euro) u janë dhënë OSHC-ve aktive në fushën e mbrojtjes ligjore.

Në vitin 2009, Fondi qytetar hungarez kishte 7.7 miliardë HUF (rreth 27.5 milionë euro), nga të cilat 7.084 miliardë (rreth 25.3 milionë euro) u janë shpërndarë OSHC-ve përmes tenderëve. Deri në fund të vitit 2009 janë financuar gjithsej 10.276 organizata. OSHC-të që merren me mbrojtje juridike kanë pranuar rreth 0,79% të shumës së përgjithshme të përkrahjes së ofruar në vitin 2009, që është rreth 57.25 milionë HUF (apo rreth 207.5 mijë euro)

¹⁹ Për më shumë shih: Hadzi-Miceva, K., “Mekanizmat ligjor dhe institucional të bashkëpunimit Qeveri-OJQ në Hungari, Estoni dhe Kroaci”, në “Organizacje pozarządowe. Dialog obywatelski. Polityka państwa,” edituar nga Marek Rymysza, publikuar nga Instituti për çështje publike, Poloni

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë:

Sektori i OSHC-ve në IRJM përfiton nga disa mekanizma financuese. Fondet ndahen drejtpërdrejt nga qeveria, përmes ministrive apo agjencive të ndryshme. Financimet nga lojërat e fatit bëhen vetëm për profile të caktuara të organizatave të parapara me ligj. Përpos kësaj, Sekretariati për çështje evropiane financon aktivitetet që fokusohen në promovimin e procesit të integrimi evropiane. Procedura e financimit bazohet në parimet e *Kodit të praktikave të mira për mbështetjen financiare të OSHC-ve* (këtej e tutje: Kodi i IRJ të Maqedonisë), të miratuar në vitin 2007. Qeveria për çdo vit publikon *Programin për financimin e aktiviteteve të shoqatave dhe fondacioneve* në bazë të së cilës miraton *Vendimin për përcaktimin e kriterëve dhe masave për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve nga buxheti i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*.

Në vitin 2009 në Maqedoni kishte 9.830 shoqata dhe fondacione të regjistruara.²⁰ Qeveria e Maqedonisë ndan mes 3.5 dhe 5.1 milionë euro në vit për organizatat e ndryshme joprotitabile (të dhënat për periudhën 2004-2009), që përbën rreth 0.20-0.30% të buxhetit të përgjithshëm. Fondet shpërndahen drejtpërdrejt nga qeveria apo përmes ministrive dhe agjencive të ndryshme. Buxheti i shtetit përmban dispozitën e përgjithshme “transferet për organizatat joqeveritare”, përmes së cilës mjetet u ndahen shoqatave dhe fondacioneve, por edhe sindikatave, komuniteteve fetare dhe partive politike.

Përpos financimit nga buxheti dhe vijat e caktuara buxhetore të ministrive, lojërat e fatit për çdo vit ndajnë 75.000.000 denarë (rreth 1.2 milionë euro) për organizatat që janë në listën e *Ligjit për lotari dhe lojëra argëtuese të vitit 1997 (i plotësuar në vitin 2001 dhe 2007)*. Bëhet fjalë kryesisht për programet e shoqatave të njerëzve me aftësi të kufizuara, shoqatave sportive dhe aktivitetet e Kryqit të kuq.

Në vitin 2004 IRJ e Maqedonisë themeloi Zyrën qeveritare për bashkëpunim me OSHC-të, e cila, përpos tjerash, është përgjegjëse për organizimin e procesit të shpërndarjes së mjeteve financiare të qeverisë për OSHC-të. Me qëllim që ta ndihmojë zhvillimin e shoqërisë civile, qeveria ka miratuar *Strategjinë për bashkëpunim në mes qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile (2007-2013)* dhe *Planin përcjellës të punës*; Zyra është përgjegjëse për Monitorimin e implementimit të strategjisë dhe përgatitjen e raportit mbi statusin e implementit. Në kuadër të Strategjisë ekziston një seksion i veçantë i cili ka të bëjë me masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë së OSHC-ve. Këto aktivitete kanë mundësuar që strategjia e planifikuar për zhvillimin e sistemit të financimit të jetë e bazuar në transparencë, kriterë të përcaktuara qartë dhe e bazuar në nevojat dhe prioritetet e komunitetit, të cilat janë caktuar paraprakisht. Si rezultat u aprovua Kodi i lartpërmendur.

III. PARIMET E PRAKTIKËS SË MIRË NË FINANCIMIN PUBLIK

Parimi kryesor i financimit publik është se ky financim duhet të konsiderohet si mundësi dhe jo si e drejtë e OSHC-ve. Kjo duhet theksuar sepse potencon një aspekt të rëndësishëm

²⁰ USAID, *Indeksi i qëndrueshmërisë së OSHC-ve Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euro-Azinë: Maqedonia*, www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex, 2009. Sipas ligjit të ri mbi shoqatat dhe fondacionet të vitit 2010, të gjitha OSHC-të duhet të ri-regjistrohen, prandaj mund të pritët që në vitin 2011 të kemi një numër të ri dhe të saktë të OSHC-ve.

të raporteve në mes të qeverisë dhe OSHC-ve, meqenëse sektori joqeveritar është i “pavarur” apo “autonom” nga qeveria dhe posedon një nivel të caktuar të aftësive vetë-financuese.

Pikërisht për këtë arsye Marrëveshja e Anglisë e thekson parimin e pavarësisë:

”Pavarësia e sektorit të tretë pranohet dhe përkrahet. Kjo përfshin të drejtën e këtij sektori që, për aq sa e lejon ligji, të bëjë fushatë, të komentojë dhe t’i sfidojë politikat qeveritare (pavarësisht nga raportet financiare apo raportet e natyrave tjera që mund t’i ketë me qeverinë) si dhe të vendosë për punët e veta dhe t’i menaxhojë ato”

Parimet tjera që shpesh potencohen janë:

- **Transparenca:** procesi duhet të bazohet në procedura të qarta të aplikimit dhe vlerësimit, në mënyrë që të sigurojnë korrektësi maksimale të procesit, për shembull duhet kërkuar që konkursi të shpallet në mediet zyrtare dhe lokale, duhet vendosur kritere të qarta dhe objektive, duhet dhënë kohë e mjaftueshme për dorëzimin e propozimeve, duhet publikuar kriteret përzgjedhëse dhe emrat e aplikuesve të zgjedhur, duhet dërguar kopje të shpalljeve dhe duhet ofruar përgjigje në pyetjet e aplikuesve potencialë, etj.
- **Trajtimi i barabartë i të gjitha aplikacioneve:** është një grup i kriterëve objektive paraprakisht të përcaktuara, që do ta shmangin diskriminim dhe do të mundësojnë zgjidhjen e aplikuesit më të suksesshëm të bazuar në propozimin e ofruar.
- **Gara e lirë dhe e ndershme:** nënkupton që informacionet në lidhje me mundësitë e financimit shtetëror të publikohen në të gjitha mënyrat e mundshme dhe të inkurajohet një garë e ndershme në mes të aplikuesve potencialë.
- **Llogaridhënia:** shpenzimi i fondeve të ndara në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me rregullat e qarta të raportimit.
- **Orientimi drejt qëllimit:** financimi publik duhet të ketë qëllime dhe prioritet të përcaktuara qartë, në përputhje me politikat e qeverisë dhe nevojat e qytetarëve. Përpos kësaj, Marrëveshja e Anglisë thekson se përfshirja e OSHC-ve në përgatitjen e programeve të reja të financimit dhe shërbimeve si dhe përqendrimi në rezultate mund t’i ndihmojë qeverisë që *”t’i sigurojë mjetet e duhura, t’i identifikojë rreziqet dhe zgjidhjet e mundshme dhe të arrijë rezultate më të mira.”*
- **Proporcionaliteti:** procedura e aplikimit, dokumentet e nevojshme për aplikim, raportet e kërkuara, Monitorimi dhe kontrolli duhet të jenë proporcionale me lartësinë e financimit të ofruar.

Instrumenti për marrjen e vendimit për financim (The Decision Support Tool) në Angli thekson parimet e mëposhtme:²¹

- *Përqendrohuni në rezultate:* mos u përqendroni së tepërmi në procesin e ndarjes së fondeve. Shqetësimi juaj kryesor duhet të jetë arritja e rezultateve të dëshiruara;

²¹ Zyra e auditorit kombëtar, *Instrumenti për marrjen e vendimit për përkrahje për organet publike në Angli*, www.nao.org.uk/guidance_and_good_practice/toolkits/better_funding.aspx

- *Ndjeshmëria*: nëse ju dhe organizata e financuar keni mirëkuptim për nevojat dhe kërkesat e ndërsjella, atëherë kjo do t'ju mundësojë të shmangni problemet dhe t'i arrini rezultatet;
- *Thjeshtësia dhe proporcionaliteti*: thjeshtësoni sa më shumë procesin e financimit. Kontrolli i pagesave, informatat e kërkuara, Monitorimi dhe vlerësimi si dhe inspektimi i jashtëm duhet të jetë në proporcion me lartësinë e mjeteve në dispozicion dhe rrezikun për keqpërdorim;
- *Planifikimi i mirë kur merret rreziku*: nuk duhet të hezitoni së tepërmi. Duhet ta menaxhoni rrezikun: përshtateni atë ashtu që të arrini baraspeshën më efikase dhe më përshtatshme të rrezikut në mes jush dhe organizatës që financohet;
- *Kohezioni dhe koordinimi*: aty ku është e mundur bashkoni apo standardizoni elementet e modelit tuaj financues me modele tjera të përshtatshme të financimit, siç janë ato që shfrytëzohen nga donatorët tjerë qeveritarë për fusha të përbashkëta apo për financimin e organizatave të ngjashme
- *Afatet kohore*: ndani kohë për planifikim, marrjen e vendimeve dhe veprim;
- *Transparenca dhe përgjegjshmëria*: merrni vendime për financim ashtu që të jeni të hapur si për qeverinë edhe për organizatat e interesuara.

Kodi i IRJ të Maqedonisë përfshin parimet e mëposhtme:

- *Financimi strategjik* i bazuar në planet dhe programet e hartuara paraprakisht.
- *Pavarësia* e shoqatave dhe fondacioneve gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre.
- *Njohja* e diversitetit të aktiviteteve që implementohen nga shoqatat dhe fondacionet dhe nevoja që ato të financohen nga burime të ndryshme.
- *Transparenca dhe korrektësia* e procedurës për ndarjen e fondeve, zgjedhjen e anëtarëve të organit vendimmarrës dhe publikimin e rezultateve dhe projekteve që do të financohen.
- *Miratimi i kriterëve objektive* që mundësojnë trajtim të barabartë, shmangin diskriminimin, nxisin garën dhe ndihmojnë në zgjedhjen e projekteve që i përmbushin kushtet më së miri.
- *Vendimmarrja dhe vlerësimi korrekt dhe i paanshëm* i raporteve nga zyrtarët e përgjegjshëm, e bazuar në procedurë objektive dhe pa ndërhyrje të interesave personale.
- *Ndarja dhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i fondeve* për qëllimet e parapara.
- Procedura dhe kërkesat që duhet të përmbushen nga organizatat në procesin e aplikimit dhe raportimit duhet të jetë *proporcionale* me lartësinë e fondeve që janë në dispozicion dhe llojin e programeve që do të financohen.
- *Vlerësimi i projekteve bazuar në indikatorë* që mundësojnë verifikimin e rezultateve të projekteve dhe përmbushjen e planeve dhe strategjive të parapara.

Kodi kroat thekson tetë parime që udhëheqin me proceset e financimit:

1. përcaktimi i prioriteteve për financimin e programeve dhe projekteve të OSHC-ve për vitin buxhetor;
2. shpallja e tenderëve publik me kushte të qarta tenderuese dhe standarde për vlerësimin e aplikacioneve dhe procedurave për ndarjen e granteve (ku përfshihen fushat prioritare për aplikim, mënyrat për parandalimin e konfliktit të mundshëm të

interesit dhe mundësia për shikimin e procedurës së vlerësimit). Tenderi publik për aplikimin e OSHC-ve duhet të jetë i hapur të paktën 30 ditë nga dita e shpalljes;

3. hapja e aplikacioneve të pranuar nga komisioni;
4. vlerësimi i projekteve dhe programeve të pranuar nga organet e posaçme, të themeluara prej institucioneve grant-dhënëse e të përbëra nga përfaqësuesit e administratës shtetërore, institucioneve hulumtuese dhe profesionale dhe subjekteve juridike jo për-përfitim (shoqatat, fondacionet dhe të tjerat), në përputhje me rregullat e procedurës apo me ndonjë akt tjetër që rregullon funksionimin e organeve eksperte;
5. njoftimi me shkrim i aplikuesve për aprovimin e financimit apo arsyet për refuzimin e tij;
6. shpallja e rezultateve të tenderit bashkë me informatat për shoqatat, programet dhe projektet që kanë fituar grantet si dhe për lartësinë e tyre;
7. përmbyllja e kontratave për financimin e programeve dhe projekteve me shoqatat fituese të granteve, të paktën 60 ditë nga dita e skadimit të afatit për aplikim;
8. Monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të programeve dhe projekteve të aprovuara dhe shpenzimit adekuat të donacioneve të dhëna, në përputhje me raportin e domosdoshëm përshkrues dhe financiar, që OSHC-të duhet t'ua dorëzojnë grant-dhënësve konform dispozitave të marrëveshjes për donacion;

IV. FAZA E PROGRAMIMIT: PLANIFIKIMI I PROGRAMEVE FINANCUESE

Skemat shtetërore të financimit, marrë në përgjithësi, pasqyrojnë një politikë të caktuar qeveritare. Për këtë arsye thirrjet për propozime bazohen në plane strategjike dhe u përshtaten programeve të financimit të hartuara në atë mënyrë që reflektojnë prioritetet e caktuara të këtyre politikave. Programet e financimit shtetëror mund të hartohen në nivel të qeverisë, por edhe në nivel të secilës ministri.

Me rastin e hartimit të këtyre planeve shtetet nxisin pjesëmarrjen e palëve me interes (OSHC-ve dhe palëve tjera të interesuara). Kjo ndihmon që thirrjet për propozime t'u përgjigjen nevojave dhe të arrijnë rezultatet e dëshiruara. Programimi ndoshta është pjesa më e rëndësishme e procesit për OSHC-të sepse kjo është faza në të cilën ato duhet t'i përcaktojnë prioritetet dhe interesat e tyre, në përputhje me kërkesat e thirrjes për propozime.

Instrumenti për marrjen e vendimit për financim (Decision Support Tool) në Angli thekson:²² “shfrytëzoni ekspertizën e brendshme në mënyrën më të mirë të mundshme, ashtu që të krijohen praktiket e financimit të mirë: inkuadroni këshilltarin ligjor, departamentet financiare dhe njësitë e prokurimit të organizatës tuaj. Gjithashtu, përfshini edhe palët e jashtme me interes. Ju mund të mësoni shumë nga përfituesit dhe donatorët potencialë të programit tuaj. Kjo mund t'i rrisë pritjet tek palët me interes. Sido që të jetë, këto pritje mund të realizohen nëse procesi është korrekt dhe rezultatet konsiderohen me rëndësi primare në punën tuaj.”

Pas hartimit të dokumentit programues apo strategjisë, ai duhet të shpërndahet dhe publikohet sa më shumë që është e mundur. Kjo do t'iu mundësojë aplikuesve të interesuar

²² Zyra e auditorit kombëtar, *Instrumenti për marrjen e vendimit për përkrahje për organet publike në Angli*, www.nao.org.uk/guidance_and_good_practice/toolkits/better_funding.aspx

që ta planifikojnë mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të tyre dhe, nëse është e mundur, të sigurojnë financim shtesë për të mbështetur implementimin e projekteve potenciale. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për OSHC-të, meqenëse i bën ato më pak të varura nga një burim i vetëm i financimit dhe u mundëson që të hartojnë strategji shumëvjeçare.

Rekomandohet që qeveria të raportojë në baza vjetore mbi implementimin e programit të saj dhe të publikojë të dhënat mbi të arriturat e rëndësishme. Për shembull, ministri hungarez i Administratës dhe Drejtësisë është i obliguar të raportojë një herë në vit para Komitetit parlamentar për të drejta të njeriut, pakica dhe religjion, mbi aktivitetet dhe veprimtaritë e Fondit gjatë vitit paraprak.²³

Kodi i IRJ të Maqedonisë:

Qeveria dhe secili organ i administratës shtetërore duhet ta hartojë programin për financimin e shoqatave dhe fondacioneve, në të njëjtën kohë kur hartohet edhe projekt-buxheti i organeve përkatëse shtetërore dhe administrative për vitin në vijim, i cili duhet të përmbajë:

- përshkrimin e prioriteteve, planin për ndarjen e fondeve dhe formën e financimit që do të ofrohet (programues, organizativ, etj);
- fusha që do të financohet, rezultatet që duhet të arrihen, prioritetet dhe qëllimet kryesore, procesi dhe përshkrimi i shkurtër i nevojave, mendimet e grupeve të caktuara, lartësia e fondeve të ndara për secilën fushë, orari vjetor për thirrjet publike, përqindja e mbështetjes organizative që do të ofrohet përmes financimit të aktiviteteve dhe kohëzgjatja e programeve që duhet të financohen (programet afatshkurta dhe afatgjate);

Programi duhet të publikohet në faqen e internetit të qeverisë dhe organit të administratës shtetërore, në draft-formë dhe në formën përfundimtare.

1. Çështjet që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të programit për financim²⁴

Gjatë fazës së programimit mund të adresohen disa nga çështjet kyçe që kanë të bëjnë me skemat e financimit.

Kohëzgjatja e skemave të granteve: donacionet afatshkurta dhe shumëvjeçare

Pjesa dërmuese e skemave të granteve qeveritare mbështet projektet në kohëzgjatje deri në një vit, që është në përputhje me proceset e planifikimit të buxhetit nga qeveritë. Përparësia e dhënies së donacioneve njëvjeçare është se ato u mundësojnë shumë OSHC-ve të garojnë për grante në secilin cikël të financimit vjetor, duke e mbajtur procesin të hapur për propozime të reja.

²³ Seksioni 9/A i Ligjit mbi Fondacionin kombëtar qytetar

²⁴ Çështjet e përshkruara në këtë seksion mbështeten në dokumentin “Fondet kombëtare në mbështetje të organizatave të shoqërisë civile” të përgatitur nga Qendra ndërkombëtare për Ligjin jo për profit (ICNL) për Ministrinë e Zhvillimit Social të Mbretërisë Hashemite të Jordanisë.

Meqenëse disa projekte kërkojnë planifikim afatgjatë dhe nuk mund t'i përmbushin rezultatet vetëm për një vit, disa qeveri kanë filluar të aplikojnë skemat e financimit shumëvjeçar (për shembull 3-5 vjet). Disa skema financuese mundësojnë kombinimin e të dy formave të mbështetjes (për shembull, Fondacioni kroat).

Fondacioni estonez bëri përpjekje të aplikojë skema dyvjeçare të financimit, por kjo eksperiencë tregoi se OSHC-të nuk janë gjithmonë te afta të planifikojnë implementimin e projekteve aq të gjata. Për këtë arsye, Bordi mbikëqyrës i fondacionit lansoi financimet në kohëzgjatje 14-16 muaj.²⁵ Në Kroaci pjesa më e madhe e projekteve të financuara nga qeveria zgjasin 12 muaj, por në një përqindje të vogël të rasteve (6.3%) financimi zgjat më shumë se 12 muaj.²⁶

Donacionet shumëvjeçare mundësojnë implementimin e projekteve më të gjata, arritjen e rezultateve afatgjata dhe zhvillimin e sektorit të OSHC-ve. Që projektet e financuara në këtë mënyrë të japin rezultatet e dëshiruara nevojitet mbikëqyrje nga afër dhe vlerësime më të shpeshta. Përpos kësaj, kërkohen kritere dhe procedura të qarta për suspendimin e pagesës në rast se vërehet që procesi nuk shpie drejt rezultateve të pritura.

OSHC-të që marrin donacione shumëvjeçare përfitojnë edhe nga reduktimi i shpenzimeve sepse ato duhet të paguajnë vetëm një herë shpenzimet fillestare për projektin e tyre, e pastaj mund të koncentrohen në implementimin e projektit për periudhën njëvjeçare. Përpos kësaj, financimi shumëvjeçar është i dobishëm edhe për faktin se u mundëson OSHC-ve të përqendrohen në punë dhe programe dhe të shpenzojnë më pak energji në ngritjen e fondeve.

Instrumenti për marrjen e vendimit për financim (Decision Support Tool) në Angli
Donacionet afatshkurtra (njëvjeçare apo në kohëzgjatje më të shkurtër) janë të dobishme në rrethana të caktuara. Për shembull, nëse arrini marrëveshje me ndonjë organizatë për të zbatuar një projekt të caktuar brenda disa muajve në një rajon të pazhvilluar, mënyra më e përshtatshme e përkrahjes është financimi afatshkurtër. Kjo është e lidhur qartë me përmbushjen e një qëllimi të caktuar.

Donacionet afatgjata mund ta zvogëlojnë rrezikun dhe pasigurinë për donatorin dhe mund të kenë kosto më të ulët për organet qeveritare. Shfrytëzimi i vazhdueshëm i marrëveshjeve njëvjeçare me mundësi vazhdimi në programe shumëvjeçare mund të rezultojë në humbjen e mjeteve të vlefshme pa marrë shërbime të mira. Marrëveshjet afatgjata financiare mund të jenë të dobishme posaçërisht në rast të financimeve të investimeve madhore kapitale ose në shërbime afatgjate, siç është kujdesi për personat e rritur me vështirësi në mësim. Nuk ka asnjë 'Rregull të thesarit' që ndalon organet qeveritare për të hyrë në marrëveshje afatgjate financiare, nëse ato paraqesin vlerë të mirë për paratë e dhëna dhe janë të domosdoshme për të realizuar qëllimet e programit tuaj.

Kushtet financiare: ndihmë në produkte apo shërbime (in-kind support) dhe kushti për financim të përbashkët

²⁵ Burimi: Z. Agu Laius, Drejtor ekzekutiv i Fondacionit kombëtar për shoqëri civile, Estoni

²⁶ Zyra për bashkëpunim me shoqata, Raport mbi përkrahjen financiare ofruar projekteve dhe programeve të organizatave të shoqërisë civile, 2009. Për më shumë informata në lidhje me skemën e financimit shihni këtë raport. www.usuvrh.hr

Ndihma në produkte apo shërbime

Skemat e financimit shtetëror mund të jenë në formë të ndihmës financiare apo/dhe në formë të produkteve ose shërbimeve. Përmes skemave të financimit shtetëror ofrohet ndihmë financiare për OSHC-të kryesisht në formë të granteve, por gjithashtu edhe në formë të kontratave. Ndihma në produkte dhe shërbime për OSHC-të ofrohet në formë të mallrave ose shërbimeve siç janë kompjuterët, softuerët apo trajnimet e ndryshme.

Një formë e ndihmës në produkte apo shërbime është ndarja e shpërblimeve dhe mirënjohjeve. Për shembull, Fondacioni kombëtar kroat për çdo vit ndan shpërblime për zhvillimin e voluntarizmit, përmes dhënies së mirënjohjes për shkollat e suksesshme në organizimin e programeve të voluntarizmit. Fondacioni gjithashtu ndan edhe shpërblimin “Më mirë të bashkuar” (“Better together”) për qeveritë lokale që vendosin bashkëpunim të mirë me shoqërinë civile.

Financimet e përbashkëta

Nganjëherë OSHC-ve u kërkohet të sigurojnë një pjesë të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të projektit (të quajtura “ndarja e shpenzimeve” ose “financime të përbashkëta” – “cost share” or “matching funds”). Nuk është e pazakontë që donatori (qoftë financues qeveritar apo privat) të kërkojë nga OSHC-të që të sigurojnë një pjesë të mjeteve, zakonisht prej 10% deri 20% të shumës së fondeve të kërkuara. Është e rëndësishme që proporcioni i pjesëmarrjes të jetë realist dhe të përcaktojë qëllime të arritshme për OSHC-të, duke marrë parasysh edhe ambientin e përgjithshëm të financimit. Nganjëherë, përkundër përpjekjeve maksimale, OSHC-të nuk janë në gjendje të sigurojnë mjete shtesë për projektin e tyre. Kjo mund të jetë si pasojë e mungesës së kulturës filantropike apo mungesës së donatorëve që mbështesin një fushë të caktuar (për shembull fushën e asistencës ligjore). Herë-herë donacionet janë aq të vogla sa që nuk mund t’i mbulojnë as shpenzimet administrative për të kërkuar fonde shtesë. Për këtë arsye, nuk rekomandohet që bashkëfinancimi të vendoset si kusht i domosdoshëm për të gjitha financimet që ofron qeveria. Do të ishte mirë që vendimmarrësit t’i vlerësojnë nevojat dhe dobësitë e kërkesave të tilla për çdo rast veç e veç. Në Angli donatorët qeveritarë inkurajohen që ta shqyrtojnë mundësinë e financimit të plotë të projektit.²⁷

Fondacioni estonez: Thirrje për financimin operativ të OSHC-ve rajonale, 2010

Përfituesit e granteve duhet të sigurojnë 10% të shumës së projektit në formë bashkëfinancimi, gjysma e së cilës mund të jetë në produkte apo shërbime. Në rast se aplikuesi ofron bashkëfinancim në lartësi më të madhe, ai do të fitojë pikë shtesë gjatë evaluimit teknik, në përputhje me sistemin e propozuar të poentimit (deri në 5 pikë shtesë). Kontributi në formë të produkteve apo shërbimeve, siç është puna vullnetare, duhet të vlerësohet në përputhje me rrogën mesatare në vend, kurse me këto të dhëna disponon Zyra qendrore e statistikave.

Llojet e veprimtarive: ofrimi i shërbimeve dhe avokimi

Shpesh shtrohet pyetja nëse qeveria duhet të financojë organizatat që merren me avokim. Ndarja e OSHC-ve në dy kategori – në organizata që ofrojnë shërbime dhe ato që merren me avokim – nuk është e dobishme, meqenëse shumica e OSHC-ve përfshihen në të dy këto

²⁷ Për shqyrtimin e rimbursimit të shpenzimeve të përgjithshme shih: HM Treasury, Përmirësimi i marrëdhënieve financiare me sektorin e tretë: udhërrëfyes për donatorët dhe blerësit, maj 2006

aktivitete. Shpeshherë organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe punojnë me grupet e marginalizuara të popullsisë (për shembull, organizatat që merren me të drejtat e romëve apo të drejtat e gruas) janë më të thirrura t'i identifikojnë rrënjët e problemeve dhe kështu të avokojnë për zgjidhje të caktuara strategjike. Nga ana tjetër, një organizatë që avokon për të drejtat e njeriut mund të ofrojë asistencë ligjore falas me qëllim që ti mbrojë të drejtat e nëpërkëmbura të klientëve të tyre (për shembull, të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuar mendore). Për këtë arsye, financimi i avokimit në asnjë mënyrë nuk duhet të perceptohet thjesht si “shpenzim buxhetor” (kundrejt pagesave për ofrimin e shërbimeve) meqenëse përkrahja për avokim mund të rezultojë në përfitime të prekshme për qeverinë. Për shembull, grantet e ofruara për organizatat që avokojnë për arsimin adekuat dhe integrimin social të të rinjve romë (përndryshe të paprivilegjuar) mund të ndihmojnë në përpjekjet për të ulur shkallën e veprave të lehta kundërvajtëse në mesin e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për organizatat e ashtuquajtura “watchdog” (mbikëqyrëse), të cilat nuk i përkasin asnjërës nga këto dy kategori. Dhënia e granteve për organizatat “watchdog” që mbikëqyrin korrupsionin forcon përpjekjet qeveritare në luftë kundër korrupsionit, që mund të rezultojë në përfitime të prekshme dhe të matshme si dhe në kursime buxhetore.

Meqenëse dallimi mes organizatave që ofrojnë shërbime dhe organizatave avokuese është mjaft i vështirë, duke pas parasysh se funksionet e tyre nganjëherë gërshetohen, qeveritë nuk përipiqen t'i bëjnë të dukshme dallimet mes tyre. Në vend të kësaj, ato inkorporojnë në programet e tyre të financimit fushat e aktiviteteve të organizatave të tilla (për shembull, demokracia, të drejtat e njeriut, të drejtat e gruas, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e pakicave etj).

Kroacia:

Projektet në fushën e demokracisë, zhvillimit të shoqërisë civile, vullnetarizmit, kohezionit social dhe filantropisë kanë marrë 7.3%, përderisa projektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut kanë marrë 1.6% të financimit të përgjithshëm. Megjithatë, niveli i financimit për demokraci dhe të drejta të njeriut është rritur krahasuar me vitin 2008.²⁸

Llojet e përkrahjes: përkrahja për projektin dhe përkrahja institucionale

Shteti mund të ofrojë financim në formë të përkrahjes institucionale, përkrahjes për projektin apo të dy format e përkrahjes.

Përkrahja për projektin mund të ofrohet për të inkurajuar zhvillimin e sektorit në përgjithësi apo për projekte specifike në fusha të caktuara, me prioritet për qeverinë. Qëllimet dhe fushat me prioritet përcaktohen nga qeveria apo organi qeveritar që bën distribuimin e fondeve gjatë fazës programuese. Për shembull, nëse qëllimi është të përkrahët zhvillimi i sektorit si tërësi, mund të financohet puna mbi reformën e kornizës ligjore që rregullon funksionimin e OSHC-ve. Nëse qëllimi është të çohen përpara politikat e caktuara të qeverisë, fushat me prioritet për financim do të jenë në përputhje me politikat

²⁸ Zyra për bashkëpunim me shoqatat, *Raport mbi përkrahjen financiare dhënë projekteve dhe programeve të organizatave të shoqërisë civile*, 2009. Për më shumë informacion në lidhje me skemat e financimit shih këtë raport. www.usuvrh.hr

e përgjithshme të cilat ajo dëshiron t'i përkrah, për shembull: rritjen e mundësive të punësimit, uljen e numrit të të pastrehëve, aktivitetet e rinisë etj. Rrjedhimisht, OSHC-të do të ftohen t'i dorëzojnë projektet specifike në fushat përkatëse.

Financimi institucional nganjëherë quhet financim operacional apo thelbësor dhe fokusohet në mbështetjen e shpenzimeve organizative të OSHC-ve, të cilat nuk mund të ndahen për projekte të caktuara por janë të domosdoshme për aktivitetet e suksesshme të organizatës. Këto shpenzime mund të prezantohen si shpenzime administrative siç janë shpenzimet e zyrës apo infrastrukturës, ngritja e kapaciteteve, mbledhjet e bordit, shpenzimet e auditimit dhe shpenzime tjera që përsëriten, të cilat nuk mund të lidhen gjithëherë me projekte të caktuara.

2. Çështjet që duhet marrë në parasysh në rastet e financimit institucional

Financimi institucional është i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve të sektorit dhe "investim" në qëndrueshmërinë e OSHC-ve. Kjo formë e financimit është në veçanti e rëndësishme në ambientet ku ekziston financimi privat i projekteve. Financimi institucional mbështet në veçanti organizatat e vogla që kanë vështirësi në sigurimin e fondeve për t'i mbuluar shpenzimet operationale. Shpeshherë shpenzimet operationale janë shumë të vogla dhe nuk mund t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet e natyrës organizative që nuk lidhen me aktivitetet e projektit, siç janë përgatitja e projekteve dhe shpenzime për ngritjen e fondeve, shpenzimet e bordit dhe menaxhmentit, planifikimit strategjik apo përmirësimit të sistemeve të menaxhimit financiar.

Përkrahja institucionale mund të ketë disa forma: *normative*, e bazuar në nevojë dhe në formë të shërbimeve dhe mallrave. Në rastin e përkrahjes normative shfrytëzohet një normë apo formulë në bazë të së cilës përcaktohet mbështetja për secilin aplikues, si në rastin e Fondit civil hungarez. Në rastin e *Përkrahjes së bazuar në nevojë*, një sasi e të mjeteve jepet për mbulimin e nevojave të veçanta që lidhen me përmirësimin e kapaciteteve institucionale. Për shembull, granti mund t'u ofrojë OSHC-ve mjete të nevojshme për azhurnimin e sistemit të teknologjisë informative. *Përkrahja në formë të shërbimeve apo mallrave* mund t'u jepet OSHC-ve si shërbime dhe mallrave. Në rast se ajo ofrohet në formë të shërbimeve lind nevoja e krijimit të një mekanizmi për të zgjedhur mënyrën se si të ofrohet shërbimi në fjalë. Ato mund të ofrohen brenda organizatës, duke shfrytëzuar ekspertizën e qeverisë apo mund të kontraktohen ndonjë organizatë tjetër që ofron shërbimin e kërkuar.

Fondi civil hungarez (Mbështetja normative)

Fondi civil hungarez është një nga fondet e pakta nacionale që ka si qëllim kryesor të ofrojë mbështetje institucionale për OSHC-të. Sipas ligjit mbi Fondin kombëtar qytetar, Këshilli (i këtij fondi) do të ndajë për çdo vit një përqindje të caktuar të mjeteve që do të shpenzohet për mbështetjen institucionale të OSHC-ve, që do të përbëjë të paktën 60% të mjeteve financiare të Fondit. Mesatarja e përqindjes së dedikuar për mbështetje institucionale mes viteve 2004 dhe 2009 ishte 66.81%, mesatarja e përkrahjes së projekteve ishte 24.9%, ndërsa 8.66% e mjeteve financiare u shpenzuan për punën e Fondit. Mbështetja institucionale e ofruar për OSHC-të ishte në masë të madhe normative; secili aplikues mund të marrë deri në 30% të shpenzimeve operationale, duke përfshirë edhe rrogat e të punësuarve, të cilat

kalkulohen në bazë të vitit paraprak.²⁹ Fondi gjithashtu mbështet hulumtimet që kanë të bëjnë me OSHC-të, trajnimin dhe zhvillimin e resurseve njerëzore të sektorit të OSHC-ve, publikimet që lidhen me këtë sektor dhe promovimin e OSHC-ve.

Përpos kritereve të përfshira në Ligjin për Fondin kombëtar qytetar dhe Parimeve të financimit të publikuara nga Këshilli, po ashtu edhe Udhëzuesi dhe thirrjet për propozime kanë kriteret e veta që përcaktojnë se cilat organizata kanë të drejtë të aplikojnë për financim e cilat jo. Në bazë të Parimeve të financimit të aprovuara së fundmi nga Këshilli (të vlefshme nga viti 2011), rrjetet ku organizata fitimprurëse dhe përfituesit e tyre përbëjnë më shumë se 50% të rrjetit nuk do të marrin ndihmë institucionale.

Meqenëse thirrjet për propozime për ndihmë institucionale shpallen nga Kolegjet rajonale, të drejtë aplikimi për financim kanë vetëm organizatat që kanë zyrë të regjistruar në rajonin përkatës. Për më tepër, nëse organizata është aktive në të paktën 3 rajone dhe 8 qarqe, ajo mund të aplikojë vetëm për thirrje për propozim të shpallura nga Kolegji, të cilat synojnë të mbështesin organizatat civile me rezultate në nivel kombëtar...

Tabela e mëposhtme tregon mënyrën se si e ka përcaktuar Fondi civil hungarez nivelin e mbështetjes institucionale për OSHC-të, duke filluar nga viti 2011.³⁰

Shpenzimet operative vjetore (mijëra forinta hungareze)	Shuma maksimale për të cilën mund të aplikohet:
- 500.000	300.000
500.000 - 3.000.000	300.000 + 16% e shumës më të lartë se 500,000
3.000.000 - 10.000.000	700.000 + 15 % e shumës më të lartë se 3.000.000
10.000.000 -	1.750.000 + 12% e shumës më të lartë se 10.000.000, por maksimumi 7.000.000

Është me rëndësi të theksohet se përkrahja institucionale gjithashtu mund të shërbejë për të investuar në organizata të caktuara. Kjo praktikë ndiqet nga Fondacioni kombëtar kroat. Fondacioni u kërkon OSHC-ve të hartojnë plane të zhvillimit organizativ (“planet strategjike - të biznesit”) për tre vjet dhe t’i dorëzojnë ato së bashku me aplikacionet e tyre. Planet duhet të përmbajnë të gjitha aktivitetet kryesore të OSHC-ve (për shembull, aktivitetet në ofrimin e shërbimeve sociale) sikurse edhe mënyrat se si OSHC-të do të mund

²⁹ Bullain, Nilda, “Mësimet nga Fondi civil nacional në Hungari,” ECNL, 2008

³⁰ Kjo tabelë paraqet vetëm një mjet teknik të shqyrtuar për vlerësimin e përkrahjes, por ajo nuk çon në përkrahje “automatike”. Kriteret tjera të rëndësishme me rastin e vendimmarrjes për financim përfshijnë raportimin transparent për aktivitetet dhe financimet e organizatave, përkrahjet tjera në dispozicion të OSHC-ve, qëllimet dhe objektivat organizative të caktuara nga OSHC-të dhe relevanca e aktiviteteve të OSHC-ve në arritjen e objektivave të përcaktuara për rajonin e caktuar (përpos tjerash).

t'i përmirësojnë shërbimet dhe aspektet e ndryshme të vet organizatës (për shembull, përmirësimin e strukturës qeverisëse, mekanizmat e llogaridhënies, gjenerimin e burimeve tjera të të ardhurave, rritjen e vizibilitetit në publik etj.). Aplikacioni vlerësohet nga vlerësues profesionistë dhe grantet jepen për tre vjet, duke u mundësuar OSHC-ve që ta krijojnë bazën për qëndrueshmërinë e tyre në të ardhmen.

Fondacioni kombëtar kroat: Përkrahja institucionale

Përkrahja institucionale ka për qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së OSHC-ve përmes mbështetjes financiare dhe profesionale, e cila mundëson stabilizimin e tyre dhe zhvillimin e mëtejshëm organizativ e programor dhe kontribuon në demokratizimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Kroaci. Përkrahja institucionale paraqet një pjesë të veçantë të Programit për ndarjen e granteve të Fondacionit kombëtar, me synimin për të investuar gjatë një periudhe trevjeçare në zhvillimin organizativ apo stabilizimin e punës së OSHC-ve të regjistruara në Republikën e Kroacisë.

Sipas të dhënave të Programit për përkrahje institucionale të vitit 2010³¹, të publikuar në ueb-faqen e Fondacionit kombëtar, gjatë këtij viti janë ndarë tre kategori të mjeteve për OSHC-të: ndihma deri në 51.000 euro për organizatat e regjistruara në Kroaci dhe që janë aktive në pesë vitet e fundit; ndihma deri në 23.000 euro për organizatat e regjistruara në Kroaci dhe që janë aktive në tre vitet e fundit dhe ndihma deri në 8.000 euro për organizatat e regjistruara në Kroaci dhe që janë aktive në vitin e fundit. Në secilën kategori mund të përfitojnë deri në 10 organizata. Ndihma jepet në baza vjetore gjatë një periudhe trevjeçare, varësisht nga vlerësimi i performancës në vitin paraprak. Nga organizata pritet të sigurojë 5-10% të bashkë-financimit nga fondet tjera.

Kriteret e përzgjedhjes përfshijnë: kualitetin e projektit; statusin për përfitimi publik dhe kontributi në zhvillimin e komunitetit; personelin dhe kapacitetet e duhura organizative për implementimin e projektit; ndihmën në rritjen e punësimit në sektorin jo-për-përfitim; ndikimin që ka projekti në nivel kombëtar dhe rajonal; analizën shpenzim-përfitim; bashkëpunimin ndër-sektorial dhe bashkëpunimin me OSHC-të tjera; inovacionin dhe qëndrueshmërinë e projektit. Formularët e vlerësimit të projekt-propozimeve janë në dispozicion në ueb-faqen e Fondacionit.

Fushat me prioritet për grante institucionale në vitin 2010 ishin:

- promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit;
- edukimi institucional mbi zhvillimin e qytetarisë demokratike;
- mbrojtja e natyrës, ambientit dhe zhvillimi i qëndrueshëm;
- përmirësimi i gjendjes së të rinjve;
- aktivitetet kulturore jo-institucionale;
- zhvillimi i OSHC-ve që ofrojnë shërbime sociale në komunitetet përkatëse.

Tenderi për ndarjen e granteve të përkrahjes institucionale për stabilizimin dhe/ose zhvillimin e shoqatave është i vetmi tender i Fondacionit kombëtar që implementohet në dy pjesë. Pjesa e parë përfshinë dorëzimin e aplikacioneve nga të

³¹ Fondacioni kombëtar kroat, Shpallje për përkrahje institucionale : http://zaklada.civilnodrustvo.hr/upload/File/hr/natjecaji/natjecaji_zaklade/objave_i_dokumentacija/2010/20_kolovoz/ip/tekst_natjecaja.pdf

gjitha shoqatat e interesuara për përkrahje institucionale. Faza e dytë e tenderit fillon me zgjedhjen e shoqatave të ranguara më lartë gjatë vlerësimit të kryer nga Këshilli për investim strategjik në zhvillimin e shoqërisë civile. Kjo pasohet nga vlerësimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me programin dhe veprimtaritë financiare në shoqata, pas së cilës bëhet vlerësimi dhe rangimi përfundimtar i aplikacioneve.

Përkrahja institucionale është një nga çështjet më delikate në profesionin e grant-dhënies dhe kërkon njohje të mirë të aktiviteteve të OSHC-ve, zhvillimit organizativ, marrëdhënieve donator-përfitues i donacionit dhe çështjeve tjera siç është menaxhmenti financiar apo qeverisja. Ajo gjithashtu kërkon një shkallë të caktuar të përvojës profesionale në dhënien e granteve në fushën ku OSHC-ja ushtron aktivitetin e saj. Prandaj, disa shtete janë përcaktuar që fondet e tilla t'i ndajnë përmes organeve të ngritura enkas për këto qëllime (si për Shqipëri, Kroacia dhe Hungaria). Shembujt e Kroacisë tregojnë se mbulimi i shpenzimeve kryesore të një OSHC-je mund të bëhet në mënyrë të përgjegjshme përmes kriterëve të qarta dhe objektive dhe kërkesave për raportim.

V. FUSHËVEPRIMI I PËRFITUESVE: KRITERET KUALIFIKUESE³²

Kriteret për financimin e OSHC-ve janë të lidhura ngushtë me objektivat që skema financuese synon të arrijë. Financimin transparent e karakterizojnë kriteret e qarta gjatë fazave të ndryshme të procesit të financimit. Përcaktimi i kriterëve kualifikues (që mundësojnë aplikimin e të gjitha apo vetëm disa OSHC-ve) është i domosdoshëm dhe pasohet nga kriteri i përzgjedhjes (që përcakton OSHC-të aplikuese të përzgjedhura për financim). Si kriteret kualifikuese ashtu edhe ato përzgjedhëse mund të shfrytëzohen për të përmirësuar politikat qeveritare. Me qëllim që të sigurohet transparenca duhet që kriteret kualifikuese dhe përzgjedhëse të vihen në dispozicion të OSHC-ve dhe publikut të gjerë në kohën e publikimit të thirrjes për propozime.

Kriteret kualifikues përcaktojnë se cilat OSHC mund të aplikojnë për financim nga Fondi kombëtar. Kriteret kualifikuese mund të përmbajnë komponentët substancialë, do të thotë komponentët që udhëhiqen nga tema apo objektivat e grantit, dhe komponentët proceduralë, që kanë të bëjnë me përmbushjen e kushteve teknike, siç është dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara në kohë.

Fondi i madh i lotarisë, Programi kombëtar për mirëqenie:³³

Organizatave që mund të aplikojnë janë:

- organizatat bamirëse të regjistruara,
- grupet tjera vullnetare dhe të komunitetit,
- organet statutoare,
- kompanitë bamirëse jo për profit,
- organizatat private,
- ndërmarrësit publike.

³² Informacioni në lidhje me këtë seksion është marrë nga dokumenti: Qendra ndërkombëtare për Ligjin jo për profit (ICNL), *Fondet kombëtare në mbështetje të organizatave të shoqërisë civile*, 2010 (në dosja me ICNL dhe ECNL)

³³ http://www.biglotteryfund.org.uk/prog_well_being

Portofoliot (fushëveprimet) mund të jenë në nivel kombëtar dhe rajonal. Ato mund të përbëhen nga disa projekte lokale. Vlerësuesit do të përpiqen të sigurojnë mbulimin e baraspeshuar të rajoneve gjeografike, përfituesve dhe fushave të ndryshme të aktivitetit.

Kriteret e seleksionimit ofrojnë udhëzime për personat e ngarkuar me përzgjedhjen e OSHC-ve që do të përfitojnë ndihmë financiare prej grupit të OSHC-ve të kualifikuara. Kriteret e përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të saktë do t'iu mundësojnë anëtarëve të komitetit për grant-dhënie që të marrin vendime në përputhje me udhëzuesit objektiv dhe paraprakisht të përcaktuar. Udhëzuesit mund të lënë një hapësirë të vogël për diskrecion, por jo në atë shkallë sa procesi i selektimit të ndikohet nga preferencat personale.

Fondacioni estonez (NFCS)³⁴, procedurat për financimin e projekteve „Ideja e mirë”:

...

4.2. Vlerësimi teknik

4.2.1. Vlerësimi teknik do të kryhet nga Zyra e NFCS-së, kurse rezultatet do të bëhen të ditura në dokumentin e vlerësimit teknik. Do të kontrollohet me sa vijon:

- a është aplikacioni i kompletuar dhe a është dorëzuar në kohë;
- a janë plotësuar të gjitha hapësirat në formularin e aplikimit dhe a është buxheti në përputhje me kushtet e thirrjes për aplikim;
- a i plotësojnë aplikuesit kushtet e thirrjes për aplikim;
- a është shuma e bashkë-financimit në përputhje me kushtet e caktuara nga bordi;
- a e ka publikuar në ueb-faqe aplikuesi statutin e shoqatës, bordin e drejtorëve dhe raportin e vitit të fundit fiskal.
- mungesa e obligimeve tatimore.

...

4.3. Vlerësimi i përmbajtjes

4.3.1. Aplikacioni do të eliminohet nga gara nëse gjatë vlerësimit të përmbajtjes të paktën dy ekspertë konstatojnë se ai nuk është në përputhje me qëllimet e thirrjes së hapur.

4.3.2. Ekspertët do t'iu vlerësojnë aplikacionet:

- Në rast të thirrjeve të hapura, kriteret e vlerësimit të thirrjes së hapur të NFCS-së aprovohen nga Drejtori ekzekutiv i NFCS-së;
- Në rastin e projekteve „Ideja e mirë” do të zbatohet qasja analitike pas së cilës do të pasojë analiza e projektit kurse në lidhje rekomandimet me financimin e projektit do t'iu dërgohen implementuesit dhe Bordit mbikëqyrës së NFCS-së.

Gjithashtu do të vlerësohen edhe aktivitetet e mëhershme të aplikuesit, kapacitetet për implementimin e projektit, respektimi i kushteve dhe kërkesave të thirrjes së hapur, përmbajtja, përputhshmëria e aktiviteteve dhe buxhetit me qëllimet e thirrjes së hapur, orientimi kah qëllimi, saktësia dhe lidhja e qartë me buxhetin, definimi i qartë i rezultateve në aplikacion, qasja e orientuar kah arritja e rezultatit dhe

³⁴ Procedurat për shpalljen e thirrjeve të hapura, procedimit të aplikacioneve dhe projekteve “Idea e mirë”, kontrolli i implementimit të grantit:

www.kysk.ee/sisu/310_8739674_Procedures_for_announcing_open_calls_proceeding_applications_and_Good_Idea_projects_disclosing_and_monitoring_the_implementation_of_the_grant.pdf

qëndrueshmëria e projektit, gatishmëria e aplikuesit për partneritet dhe bashkëpunim me autoritetet publike, organizatat e biznesit dhe/ose organizatat tjera jo për profit.

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e çështjeve që kanë të bëjnë me kriteret e kualifikimit dhe përzgjedhjes që merren parasysh në procesin e financimit.

1. A duhet që programi t'i mbështesë të gjitha OSHC-të apo vetëm organizatat e kualifikuara?

Shpeshherë qeveritë gjenden para dilemës nëse fondet shtetërore duhet t'iu ndahen të gjitha OSHC-ve apo vetëm organizatave të përfshira në aktivitetet për përfitim publik, respektivisht organizatave që kanë fituar statusin për përfitim publik (OPP).

Është e drejtë e OSHC-ve të përcaktohen për cilindo prej këtyre qëllimeve legjitime, qoftë për statusin për përfitim privat apo publik. Megjithatë, shumica e shteteve nuk duan të ofrojnë lehtësira (lirim nga tatimi, financim shtetëror etj) për të gjitha organizatat; në vend të kësaj, shteti ua ofron këto beneficione vetëm një grupi të OSHC-ve bazuar në synimet që kanë dhe aktivitetet që zhvillojnë, kurse në këmbim kërkon shkallë të lartë të menaxhimit dhe përgjegjshmërisë. Përmes këtyre beneficioneve shteti kërkon të promovojë aktivitete të caktuara që janë në interes të publikut. OSHC-të që merren me aktivitete të tilla kanë emërtime të ndryshme, për shembull “bamirëse” dhe “organizata për përfitim publik”. Për më shumë, në disa shtete ligji nuk e përcakton statusin e organizatave në mënyrë eksplicite, por megjithatë qëllimet dhe aktivitetet vet organizatës janë të lidhura me përfitime të caktuara.³⁵

Nganjëherë qeveritë vendosin që fondet shtetërore t'ua ndajnë vetëm OSHC-ve me status për përfitim publik sepse, siç është përshkruar më lartë, këto organizata janë të angazhuara në veprimtari me interes publik dhe u nënshtrohen rregulloreve më strikte dhe mbikëqyrjes së shtuar, gjë që e rrit llogaridhënien e tyre.

Sidoqoftë, mundësia që një grup më i madh i organizatave të aplikojë për financim nga shteti (e jo vetëm OSHC-të me status për përfitim publik) mund të tregohet më e favorshme për qeverinë. Para së gjithash statusi për përfitim publik është çështje vullnetare dhe nëse ky status bëhet kusht për financim qeveritar shumë organizata tjera të afta dhe të kualifikuara mund ta humbin mundësinë për të marrë fonde dhe për t'i implementuar projektet për të cilat ka nevojë qeveria. Në shtetet ku standardet për të marrë statusin e organizatës për përfitim publik (OPP) janë të larta dhe për rrjedhojë vetëm një numër i vogël i OSHC-ve vendos të aplikojë dhe t'i marrë obligimet përkatëse, përjashtimi i organizatave që nuk e kanë statusin e OPP-së nga mbështetja e drejtpërdrejt financiare e qeverisë mund të tregohet kundër-produktive.³⁶ Së dyti, mundësitë e ndryshme për financim kërkojnë kriteret të

³⁵ Për më shumë informacion shih: Moore, D., Hadzi-Miceva, K., dhe Bullain N., *Vështrim krahasues i statusit për përfitim publik në Evropë*, Gazeta ndërkombëtare e Ligjit jo për profit, Vëllimi 11, Numri 1, nëntor 2008

³⁶ Sidoqoftë, qeveria mund të shqyrtojë mundësinë që ndihmën operationale (institucionale) t'ua ofrojë organizatave me status bamirësie apo OPP. Në raste të tilla, niveli i lartë i llogaridhënies, që është karakteristikë e statusit OPP, mund të shërbejë si garancion shtesë kundrejt mungesës së përgjegjshmërisë në shfrytëzimin e fondeve, që përbën një rrezik të përgjithshëm në rastin e financimit institucional.

ndryshme dhe, siç është thënë më lartë, ato duhet të jenë në përputhje me fushëveprimin dhe fondet në dispozicion për projektin. Së treti, kërkesat për raportim, mbikëqyrje dhe llogaridhënie gjithashtu do të jenë pjesë e kontratës të cilën qeveria do ta nënshkruaj me organizatën përkatëse dhe për këtë arsye nuk ka nevojë që ndihma të kufizohet vetëm për organizatat me status për përfitim publik. Së katërti, qeveria (lokale) mund të ofrojë grante për OSHC-të lokale që të zbatojnë projekte në komunitet (siç është rindërtimi i kopshteve apo pastrimi i varrezave). OSHC-të lokale, të cilat janë shoqata me anëtarësi dhe më të përshtatshme për ndërmarrjen e projekteve të tilla, nuk aplikojnë gjithmonë për të marrë statusin e OPP-së.

Në rast se qeveria ua mundëson të gjitha OSHC-ve të kualifikohen për ndihmë financiare, ajo mund t'ia përshtat skemën e financimit fushave të zgjedhura që reflektojnë prioritetet e saj politike.

Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve të qeverisë së Maqedonisë për vitin 2010 përfshin këto pesë fusha të përgjithshme për mbështetje të drejtpërdrejt financiare: (1) zhvillim ekonomik, kompeticion, nivel më të lartë të punësimit, rritje të standardit dhe kualitetit të jetës; (2) integrim në NATO dhe BE; (3) lufta kundër krimit dhe korrupsionit; (5) marrëdhëniet ndër-etnike; dhe (6) investimi në arsim.³⁷

OSHC-të në Estoni mund të aplikojnë për t'u përfshirë në listën e qeverisë për lehtësime të caktuara tatimore, të cilat ofrohen në bazë të aktivitetit për përfitim publik dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për tatim në të ardhura dhe udhëzuesit përkatës.³⁸ Fondacioni i Estonisë e ka lidhur skemën e vet të financimit “*Programi për ngritjen e kapaciteteve të organizatave dhe fondacioneve jo profitabile*” me projektet për përfitim publik, të cilat janë përcaktuar në Ligjin për tatim dhe udhëzuesit përkatës. Për këtë arsye, edhe pse shoqatat dhe fondacionet që aplikojnë për financim duhet të ushtrojnë aktivitetin në fushat e cekura, përfshirja e tyre në listën e qeverisë nuk është e domosdoshme.

2. Cilët janë faktorët që duhet të merren parasysh me rastin e përcaktimit të rrethit të aplikantëve të kualifikuar?

Kriteri institucional

Thirrjet për propozime zakonisht i përcaktojnë llojet e organizatave të kualifikuara për të aplikuar në bazë të strukturës së tyre ligjore (për shembull shoqata, fondacione, korporata jo-profitabile). Nganjëherë mund të ketë kriteret shtesë në përputhje me kërkesat ligjore dhe qëllimin e grantit. Kriteret kualifikuese shtesë që kërkohen më së shpeshti janë:

- misioni dhe fusha e aktivitetit (e tillë që përputhet me qëllimet e projektit);

³⁷ Gazeta Zyrtare e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 8/2010 (<http://www.nvosorabotka.gov.mk>)

³⁸ Për më shumë informacion shihni këtë udhërrëfyes: “*Implementim i projekteve për përfitim publik nga shoqatat dhe fondacionet që përfitojnë prej lehtësimeve në tatim*” Bordi i Tatimeve dhe Doganave, <http://www.emta.ee/?id=14383>. Shih gjithashtu: Moore, D., Hadzi-Miceva, K., dhe Bullain N., *A Vështrim krahasues i statusit për përfitim publik në Evropë*, Gazeta ndërkombëtare për Ligjin jo për profit, Volumi 11, Numër 1, nëntor 2008.

- kohëzgjatja e ekzistencës së organizatës (zakonisht një deri në tre vjet);
- kërkesat për partneritet (vlejnë për projektet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndër-shtetëror apo ndër-sektorial, të cilat duhet të zbatohen nga konsorciumet);
- përjashtimi nga financimi paralel (që nënkupton se OSHC-së nuk i lejohet të pranojë fonde nga i njëjti burim apo ndonjë burim tjetër qeveritar që përkrah të njëjtën çështje, brenda të njëjtit vit);
- të ketë statusin për përfitim publik;
- pozita gjeografike apo fushëveprimi i aktivitetit.

Kodi i IRJ të Maqedonisë përmban kriteret e mëposhtme:

1. Të jetë e regjistruar në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione.
2. Të ketë zhvilluar aktivitete për një periudhë minimum njëvjeçare.
3. Të jetë e përfshirë në aktivitete dhe projekte qëllimi i të cilave është plotësimi i nevojave të komunitetit më të gjerë dhe që janë me interes publik.
4. Të mos ketë pranuar fonde nga ndonjë organ tjetër i administratës shtetërore apo nga burime tjera për projektin për të cilin dorëzohet aplikacioni, sepse kjo do të nënkuptonte financim të dyfishtë për të njëjtin aktivitet.

Qeveria dhe organet e administratës shtetërore vendosin kriteret e veçanta programore për shpërndarjen e fondeve, në përputhje me programin dhe rezultatet që duhet të arrihen.

Fondet e tranzicionit, Anglia (kriteret):³⁹

Ju mund të aplikoni për këto fonde vetëm nëse organizata juaj i plotëson të gjitha gjashtë kriteret e mëposhtme:

1. Ju jeni një nga organizatat e mëposhtme të shoqërisë civile:
 - shoqatë bamirëse vullnetare e komunitetit,
 - shoqatë bamirëse e regjistruar,
 - shoqatë për përfitim të komunitetit, e regjistruar si shoqëri industriale dhe për mirëqenie,
 - kompani për interesa të komunitetit
 - lloj tjetër i organizatës, nëse operoni si ndërmarrësi shoqërore dhe tepicën e investoni në të mirë të shoqërisë.
2. Pjesën dërmuese të shërbimeve e ofroni në Angli.
3. Ju shpenzoni të paktën 50 për qind të të ardhurave të përgjithshme në një apo më shumë prej shërbimeve të mëposhtme publike:
 - përkujdesje shëndetësore dhe sociale,
 - përkujdesje për të pastrehët,
 - arsim dhe trajnime,
 - rehabilitimin e kryesve të veprave penale,
 - mirëqenien në punë/shërbime për punësim
 - fëmijë dhe familje,
 - konsultime për borxhe dhe këshilla juridike.

³⁹ <http://www.biglotteryfund.org.uk/transitionfund?regioncode=-uk>

4. Janë miratuar raportet vjetore që nuk janë më të vjetra se 12 muaj dhe të cilat tregojnë se:
- të ardhurat tuaja të përgjithshme për vitin në fjalë ishin mes 50.000 dhe 10 milionë funte dhe
 - të paktën 60 për qind të të ardhurave të përgjithshme vinin nga burimet e fondeve të taksapaguesve.
5. Keni të dhëna apo keni arsye të forta të besoni se mes periudhës prill 2011 dhe mars 2012 organizata juaj do të ketë një zbritje prej të paktën 30 për qind të të ardhurave që ju i merrni nga fondet e mbledhura prej taksapaguesve për ofrimin e shërbimeve publike në Angli.
6. Rezervat me të cilat dispononi mund t'i mbulojnë shpenzimet e përgjithshme të organizatës për jo më shumë se gjashtë muaj.

Kriteret për kualifikim të përcaktuara ligjërisht: përfituesit e Fondit kombëtar hungarez⁴⁰

Vetëm organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në gjykatë të paktën një vit para ditës së parë të shpalljes së tenderit dhe që ushtrojnë aktivitetet e tyre në përputhje me statutin kualifikohen për të marrë ndihmë nga Fondi kombëtar qytetar.

Përpos ndihmës institucionale, organizatat e shoqërisë civile që kanë marrë statusin për përfitim publik me rrugë ligjore, në përputhje me Aktin CLVI të vitit 1997 mbi Organizatat për përfitim publik, kanë të drejtë në financim nga Fondi kombëtar.

Organizatat qytetare nuk kualifikohen për ndihmë institucionale nga Fondi kombëtar nëse gjatë vitit buxhetor pranojnë subvencione për veprimtaritë e tyre – në bazë të Aktit buxhetor.

Kriteret që kanë të bëjnë me projektin/programin

Politikat apo prioritetet qeveritare mund të përmirësohen duke i ngushtuar dukshëm kriteret themelore kualifikues apo seleksionuese, ashtu që të përfshihen OSHC-të që zbatojnë apo propozojnë projekte në fushat me interes për qeverinë. Kriteret për kualifikim të bazuara në program janë të lidhura ngushtë me qëllimin e grantit dhe mund të përkufizohen në mënyrë të gjerë apo të ngushtë. Zakonisht sa më specifike që të jenë kriteret kualifikuese aq më e madhe do të jetë përqindja e projekteve të mbështetura, meqenëse do të aplikojnë vetëm OSHC-të me programin adekuat. Kriteret tipike që kanë të bëjnë me projektin varësisht nga qëllimet e thirrjes për propozime mund të jenë:

⁴⁰ Seksioni 3 i Aktit L të vitit 2003 për Programin e Fondit kombëtar qytetar

- Grupet e caktuar (për shembull: njerëzit me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë e papunësuar)
- Fushëveprimi gjeografik (për shembull komunë apo rajon);
- Inovacioni (për shembull, duhet të jetë projekt i tillë që nuk është zbatuar më parë në shtet/rajon/komunë);
- Përsëritja (për shembull, duhet të jetë projekt që është përsëritur një herë me sukses, apo projekt që mund të përsëritet apo zgjerohet);
- Metodologjia (për shembull, duhet apo nuk duhet të jetë konferencë; duhet të jetë participuese; duhet ta përmbajë komponentin e vlerësimit); dhe
- Tema kryesore apo qasja “cross-cutting” (qasja që bashkon palët me interes) (për shembull, projekti duhet të demonstrojë diversitet, zhvillim të qëndrueshëm etj).

Thirrja për propozime mund t'i numërojë llojet e projekteve që nuk kualifikohen për financim.

Fondi i madh i lotarisë, Rinia në fokus, Angli (përmbledhje e kriterëve):⁴¹

Anglia ka në dispozicion 30 milionë funte për projektet që mbështesin grupet vulnerabile të të rinjve që kalojnë nëpër periudha të vështira në jetën e tyre.

Ju nuk mund të aplikoni për programin “Rinia në fokus” nëse projekti juaj nuk merret në mënyrë specifike me një nga këto grupe:

- * Kujdestarët e rinj;
- * Të rinjtë që largohen nga institucionet e përkujdesjes;
- * Të rinjtë që lirohen nga institucionet për kundërvajtje.

Rezultatet e programit: ne dëshirojmë të financojmë projekte që punojnë me të rinjtë, të cilat kanë për qëllim të:

- * rrisin vetëbesimin, përmirësojnë shkathtësitë dhe njohuritë – në mënyrë që të përballen më mirë me problemet jetësore;
- * ofrojë mbështetje më efektive që lidhet me shërbimet tjera – në mënyrë që ata të përballen më mirë me sfidat jetësore.

Në mënyrë që këto ndryshime të bëhen realitet në kërkojmë nga aplikuesit që:

- * të kenë si cak një apo më shumë prej grupeve që programi ynë “Rinia në fokus” synon t'i ndihmojë,
- * të përfshijë të rinjtë që do të përfitojnë gjatë gjithë projektit, prej fazës më të hershme të implementimit,
- * të krijojnë partneritet me sektorin e organizatave vullnetare, publike apo private me përvojë relevante, i cili udhëhiqet nga organizatat vullnetare
- * të sigurojë që përfitimet nga projekti të vazhdojnë edhe pas përfundimit të financimit tonë, dhe
- * t'i ndajnë mësimet e mësuara me ne dhe të tjerët.

Kriteri financiar

Ekzistojnë disa kritere që janë kusht për ndihmë financiare. Kriteri më i rëndësishëm është përcaktimi i lartësisë maksimale të fondeve në dispozicion për një propozim. Pa këtë kriter

⁴¹ http://www.biglotteryfund.org.uk/youth_focus_guidance.pdf

kualifikues qeveria do ta ketë shumë të vështirë të marrë vendime transparente për alokimin e mjeteve. Disa qeveri publikojnë fondet minimale dhe maksimale në dispozicion për skema të caktuara. Kriteret tjera mund të përfshijnë:

- Shumën e ko-financimit të kërkuar (bashkë-financimi apo shpenzimeve e përbashkëta);
- Shpenzimet e pranueshme. Nganjëherë thirrjet për propozime mund të përmbajnë listën me llojet e shpenzimeve të cilat janë të pranueshme dhe ato që nuk janë pranueshme për tu financuar;
- Shpenzimet e përgjithshme që mund të mbulohen.

Fondi i madh i lotarisë, 'Të rinjtë në fokus', Angli (përmbledhje e kriterëve):

Ne presim që shumica e aplikacioneve të sillen prej 500.000 deri në 1 milion funte. Do t'i shqyrtojmë edhe aplikacionet për më pak se 500.000 funte, por duhet të bisedoni me ne paraprakisht, meqenëse projektet më të vogla mund ta kenë të vështirë t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e paraqitura në këtë udhëzues.

Gjithashtu, dëshirojmë të ofrojmë tre grante deri në 1.500.000 funte.

Këto grante janë paraparë për projektet që synojnë ngritjen e vetëdijes mbi problemet e të rinjve dhe implementohen në gjithë territorin e Anglisë. Projekti 'Të rinjtë në fokus' ka për qëllim përhapjen e njohurive dhe informimin për problemet e të rinjve. Nëse mendoni të aplikoni për ndonjë nga grantet e mëdha duhet që paraprakisht t'i diskutoni idetë tuaja me ne.

Çka do të paguajmë ne:

- Një pjesë apo gjithë shpenzimet e projektit për një periudhë prej tre deri në pesë vjet.
- Një pjesë të shpenzimeve të përgjithshme të organizatës tuaj.

Çka nuk do të paguajmë ne:

- Aktivitetet që kanë të bëjnë me ndërtim apo renovim.

Fondacioni i Estonisë: Thirrja për financimin institucional të OSHC-ve rajonale, për vitin 2010⁴²

Pranuesi i grantit duhet të siguroj 10% të bashkëfinancimit, gjysma e së cilës mund të jetë në mallra apo shërbime. Në rast të një shume më të madhe të bashkëfinancimit, aplikuesi merr pikë shtesë gjatë vlerësimit teknik, në përputhje me shkallën e propozuar (maksimum deri në 5 pikë shtesë). Kontributi me mallra dhe shërbime, siç është puna vullnetare, duhet të vlerësohet në përputhje me nivelin e rrogës mesatare, që mund të sigurohet nga Zyra qendrore e statistikave. Thirrja mundëson mbulimin e 10% të shpenzimeve direkte të aktivitetit.

⁴² <http://kysk.ee/?s=321>

Përqindjet e lejuara të shpenzimeve institucionale/të përgjithshme të projektit.

Një nga mënyrat për të mbështetur qëndrueshmërinë financiare të OSHC-ve është përmes mbulimit të shpenzimeve indirekte apo shpenzimeve të përgjithshme që kanë lidhen me implementimin e projektit. Shpenzimet indirekte janë shpenzimet institucionale të organizatës që rrjedhin nga veprimtaria e saj dhe nuk mund t'i përshkruhen direkt një projekti të caktuar. Shembuj të shpenzimeve indirekte janë auditimi vjetor, shpenzimet e bordit, trajnimi i personelit, zhvillimi i programit dhe shumë aktivitete tjera të domosdoshme për funksionimin adekuat të organizatës. OSHC-të që e kanë të zhvilluar sistemin e kontabilitetit mund t'i vlerësojnë me lehtësi shpenzimet e tyre indirekte dhe t'i ndajnë ato në mënyrë proporcionale mes projekteve të ndryshme që po implementon organizata.

Ekzistojnë qasje të ndryshme për rimbursimin e shpenzimeve indirekte. Donatori zakonisht mundëson që një përqindje e caktuar e mjeteve financiare të projektit të shkojë për mbulimin e shpenzimeve indirekte. Për shembull, sipas rregullave financiare të Fondacionit kroat për shpenzime indirekte mund të ndahen deri në 20% e buxhetit të projektit. Fondacioni estonez lejon shfrytëzimin deri në 10% të buxhetit për mbulimin e shpenzimeve indirekte.

Mbretëria e Bashkuar i mbulon në tërësi shpenzimet indirekte. Kjo mënyrë e alokimit të shpenzimeve që lidhen me projektin ka për qëllim të sigurojë se një shumë adekuate e shpenzimeve të përgjithshme do të alokohet për projektet e ndryshme dhe do të mbulohet në tërësi nga donatorët përkatës qeveritarë. Përkundër sfidave ekzistuese në kompensimin e plotë të shpenzimeve të përgjithshme nga ana e departamenteve qeveritare, Raporti i vitit 2007 i përgatitur nga Zyra e auditorit të përgjithshëm për Zyrën e sektorit të tretë – i quajtur *Implementimi i kompensimit të plotë të shpenzimeve* - thekson se “çështja e kompensimit të plotë të shpenzimeve qëndron lartë në agjendë nga viti 2002”,⁴³ dhe se “ministritë nuk e vënë në diskutim korrektësinë e parimit financiar që mbështet kompensimin e plotë të shpenzimeve të përgjithshme.” Raporti ka ndihmuar që të sqarohet mënyra e zbatimit të këtyre parimeve në marrëdhëniet e ndryshme të financimit, duke përfshirë edhe marrëveshjet dhe financimet e projekteve (granteve). Praktika ka treguar se departamentet që ofrojnë financime të projekteve janë angazhuar më shumë në zbatimin e kësaj skeme: “koncepti i kompensimit të plotë të shpenzimeve është më i logjikshëm sepse donatorët do të jenë të interesuar që projektet e caktuara të financohen në tërësi dhe në mënyrë të qëndrueshme.”⁴⁴

Më saktësisht, udhëzuesi i publikuar nga UK HM Treasury në vitin 2006 "Avancimi i marrëdhënieve financiare me sektorin e tretë: "Udhëzues për donatorët dhe blerësit"⁴⁵ thekson:

⁴³ “Zyra e sektorit të tretë- Implementimi i kompensimit të plotë të shpenzimeve ” Raport i vitit 2007, mund ta gjeni në: http://www.nao.org.uk/publications/0607/full_cost_recovery.aspx

⁴⁴ “Zyra e sektorit të tretë- Implementimi i kompensimit të plotë të shpenzimeve ” Raport i vitit 2007, mund të gjendet në: http://www.nao.org.uk/publications/0607/full_cost_recovery.aspx

⁴⁵ HM Thesari, Përmirësimi i marrëdhënieve financiare me sektorin e tretë: Udhëzues për financuesit dhe blerësit (2006): <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+/http://www.hm-treasury.gov.uk/d/guidncefunders1505061v1.pdf>

- Nuk ka asnjë arsye që prokuruesit e shërbimeve të mos lejojnë përfshirjen e shpenzimeve të përgjithshme relevante në tender. Për më tepër, financuesit apo blerësit nuk duhet ta hedhin poshtë apo ta refuzojnë prerazi financimin e shpenzimeve në tërësi. Organet financuese duhet t'ia njohin të drejtën organizatave të sektorit të tretë që t'i kompensojnë shpenzimet e përgjithshme që lidhen me ofrimin e një shërbimi të caktuar deri në nivelin e duhur.
- Me rastin e përcaktimit të donacioneve, donatori duhet të vlerësojë në mënyrë të qartë, proporcionale dhe të drejtë nëse organizatat e sektorit të tretë kanë llogaritur shpenzimet e përgjithshme relevante dhe të sigurohet se këto shpenzime kompensohen vetëm një herë.
- Në një regjim kompetitiv të prokurimit, blerësit duhet ta bëjnë të qartë se ata presin nga ofruesit e shërbimeve nga sektori i tretë të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e mos kompensimit të plotë të shpenzimeve. Organizatat e sektorit të tretë që subvencionojnë në mënyrë të pavetëdijshme një shërbim publik nuk paraqesin vlerë të mirë për para, posaçërisht në planin afatgjatë.
- Përqindjet fikse pa asnjë bazë faktike nuk paraqesin bazë të shëndoshë për llogaritjen dhe ndarjen e fondeve për shpenzimet e përgjithshme relevante. Alokimi i qartë dhe i përpiktë i shpenzimeve të përgjithshme relevante mund të ofrojë udhëzues më të saktë për financuesit për koston reale të ofrimit të shërbimit ose të produktit.

Kërkesat teknike

Kërkesat teknike janë kërkesa për informata dhe dokumente të cilat i vërtetojnë kriteret kualifikuese. Këto zakonisht përfshihen:

- Vërtetimi për regjistrim;
- Vërtetimi për statusit për përfitim publik (nëse kërkohet);
- Raportet vjetore financiare (të audituara);
- Vërtetimi se nuk ka borxhe publike;
- Prezantimi i të dhënave tjera financiare (buxheti operativ, raporti i shpenzimeve të përgjithshme, qarkullimi i të hollave etj.)
- Statuti apo aktet tjera të organizatës;
- Deklaratat që kanë të bëjnë me partneritetin me organizatat apo organet tjera shtetërore;
- Formulari për dorëzimin e propozimeve narrative;
- Formulari për dorëzimin e propozimeve të buxhetit;
- Referencat.

Programi financues i Fondacionit kombëtar kroat “Bashkë për më mirë” vë theksin në këto kërkesa teknike:

1. Vërtetimi mbi regjistrimin e OSHC-së (vërtetimi mbi regjistrimin e shoqatave nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 muaj, duke llogaritur kohën nga dita e shpalljes së thirrjes për aplikime dhe të tregojë në mënyrë të qartë se organizata funksionon të paktin 2 vjet nga dita e publikimit të shpalljes; për fondacionet – vërtetimi duhet të provojë në mënyrë të qartë se organizata funksionon të paktën dy vjet nga dita e regjistrimit deri në ditën e publikimit të thirrjes);
2. Formulari i verifikuar dhe nënshkruar i propozim narrativit (në letër (hard copy) bazuar në formularin e publikuar nga Fondacioni);

3. Formulari elektronik i plotësuar i propozim narrativit (në formën e publikuar nga Fondacioni dhe në CD);
4. Formulari i vërtetuar dhe i nënshkruar i propozimit financiar (në letër (hard copy) bazuar në formën e publikuar nga Fondacioni);
5. Formulari i plotësuar i projekt propozimit narrativ financiar (në formën e publikuar nga Fondacioni dhe në CD);
6. CV-ja e udhëheqësit të projektit në letër (hard copy);
7. CV-ja e udhëheqësit të projektit në formën elektronike në CD;
8. Për ata që kryejnë llogaritje të dyfishtë – një kopje e formularit të raportit financiar të vitit paraprak me vulë nga Zyra e auditorit të shtetit, dhe për ata me sistem të thjeshtë të llogari-mbajtjes, vendimi i organit qeveritar i vulosur nga Zyra e auditorit të shtetit që i liron nga përgatitja e raportit financiar dhe një kopje e librit të llogarimbajtjes financiare;
9. Deklarata e partneritetit të nënshkruar dhe të vërtetuar nga partneri i projektit në letër (hard copy);
10. Deklarata e partneritetit të nënshkruar dhe të verifikuar nga partneri i projektit në formë elektronike në CD;
11. Kopja e statutit;
12. Deklarata e nënshkruar dhe verifikuar nga udhëheqësi i projektit për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i qeverive lokale dhe rajonale apo nga fondet e lotarisë, ministrive dhe agjencive tjera shtetërore për vitin e kaluar;
13. Dokumentacioni tjetër (materialet, publikimet dhe artikujt në gazeta që ilustrojnë punën e organizatës).

VI. TENDERIMI I GRANTIT DHE PROCESI I APLIKIMIT

Sfida më e shpeshtë në financimin publik është distribuimi i mjeteve në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme. OSHC-të në disa shtete ankohen se shpeshherë kanë vështirësi t’iu qasen fondeve qeveritare sepse financimi nuk është transparent, nuk ka kritere të qarta dhe vendimet për dhënien e granteve janë të politizuara. Përpos kësaj, procesit i mungon një mekanizëm efektiv për vlerësimin dhe monitorimin e mënyrës së shfrytëzimit të fondeve dhe për sigurimin e llogaridhënies nga OSHC-të fituese të granteve.⁴⁶

Me qëllim që ta adresojnë këtë problem, disa shtete, duke përfshirë edhe ato për të cilat është folur në këtë dokument, kanë miratuar rregulloret apo kodet që paraqesin kornizën e procedurës transparente të financimit. Dokumentet e tilla kornizë sigurojnë një proces korrekt dhe të rregullt të tenderimit, financimit dhe kompletimit të suksesshëm të programit dhe projekteve të financuara. Përpos kësaj, ato kanë për qëllim t’i harmonizojnë praktikën e financimit mes organeve të ndryshme shtetërore dhe të sigurohen se OSHC-të i kuptojnë mirë mundësitë që lindin nga këto financime.

Ekzistojnë disa çështje që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të kornizës mbi procedurën e financimit. Këto janë sqaruar shkurtimisht më poshtë:

⁴⁶ Hadzi-Miceva., K., me Bullain, N., “Korniza për mbështetjen financiare të organizatave shoqërore-ekonomike” në Ekonominë shoqërore – Krijimi i ekonomive ekskluzive (OECD Programi për zhvillimin lokal ekonomik dhe punësim (LEED), 2007.

1. Tenderimi një apo dyfazësh

Shpallja e grantit mund të bëhet përmes tenderëve një apo dyfazësh. Në tenderët njëfazësh pas shpalljes pranohen propozimet dhe merret vendimi për fituesit. Kjo është praktika më e shpeshtë. Kur nëse procesi është dyfazësh, gjatë fazës së parë kërkohen vetëm përmbledhje të shkurtra të projekt-propozimeve dhe pas vlerësimit të përmbledhjeve, varësisht nga rezultatet, vetëm një numër i kufizuar i OSHC-ve ftohen t'i dorëzojnë propozimet e plota. Gjatë këtij procesi, propozimet e pranuar në rrethin e parë ("shprehja e interesit") shoshiten nga personeli i agjencisë apo ekspertët e ftuar dhe jo nga organi vendimmarrës.

Procedura dyfazëshe të shumtën e rasteve është më e vështirë për agjencitë grant-dhënëse meqenëse kërkon më shumë kohë, më shumë përpjekje administrative dhe është më e shtrenjtë krahasuar me tenderimin njëfazësh. Sidoqoftë, në disa raste qeveria mund të shqyrtojë aplikimin e procesit dyfazësh (për shembull, në rastet kur pranohen shumë aplikacione dhe një përqindje e konsiderueshme e tyre nuk i plotësojnë kriteret elementare të përzgjedhjes). Edhe OSHC-të mund ta preferojnë propozimin në dy faza, meqenëse përgatitja e propozimeve të plota në mënyrë të pashmangshme i rrit shpenzimet e organizatës dhe – në mungesë të prospekteve serioze të financimit – OSHC-të preferojnë ta dinë sa më herët në mënyrë që t'i ruajnë burimet e kufizuara për zhvillimin e projektit.

2. Sistemet e para-kualifikimit

Sistemi i para-kualifikimit do të thotë se agjencia posedon databazën e OSHC-ve 'të kualifikuara' të cilat i plotësojnë kushtet për financim nga programi i tyre i granteve dhe nuk kërkon prova për përmbushjen e kriterëve kualifikues sa herë që OSHC-ja aplikon. Ky sistem kursen në masë të madhe shpenzimet administrative gjatë vendosjes mbi kualifikimin institucional dhe teknik të OSHC-ve për secilin tender. Sistemi mund të jetë efikas posaçërisht kur ministria apo agjencia qeveritare konstaton se i njëjti grup i OSHC-ve aplikon në shumicën e tenderëve për grantet që i shpall ajo (për shembull në rastin e zhvillimit ndërkombëtar vetëm një numër i kufizuar i OSHC-ve në shtet aplikon për implementimin e programe të granteve që ofrohen si ndihmë e huaj). Për shembull, Ministria maqedonase e Punës dhe Mirëqenies Sociale i regjistron organizatat që duan të aplikojnë për financimet që ofron kjo ministri.

3. Dizajni (përmbajtja & forma) i konkursit për grant

Kushtet më të rëndësishme që duhet përmbushur gjatë dizajnit të tenderit për grant janë:

- të jetë i qartë për lexuesit;
- t'i përmbajë të gjitha informatat e nevojshme për përgatitjen e propozimit të mirë;
- të përfshijë të gjitha informatat e nevojshme teknike dhe procedurale për aplikim;
- të jetë proporcional me fushëveprimin e tenderit dhe financimit në dispozicion.

Thirrjet për propozime duhet të jenë specifike dhe të qarta sa i përket kualifikimit, me qëllim që të rritet numri i aplikacioneve me potencial për të fituar. Megjithëse mund të ofrohen edhe informata të detajuara shtesë; informacionet kryesore të thirrjes duhet të përmbledhen në një faqe të vetme, nëse jo për gjë tjetër, atëherë për qëllime reklamimi.

Në Hungari, Rregullorja implementuese e Fondit kombëtar qytetar bën dallim në mes të Thirrjes për propozime dhe Udhëzuesit për Thirrje për propozime; kjo e dyta përmban të gjitha informatat e detajuara që u nevojiten aplikuesve. Thirrja për propozime e publikuar gjerësisht përmban vetëm titullin, qëllimin, shumën e fondeve në dispozicion dhe kriteret kryesore kualifikuese së bashku me linkun për ueb-faqen ku mund të gjenden Udhëzuesit me informacione të detajuara dhe të shkarkohen formularët për aplikim. (shih shembullin e mëposhtëm.)

Përfshirja e informacioneve që kanë të bëjnë me kriteret e seleksionimit, për shembull informimi i aplikuesve për kriteret e procesit të vendimmarrjes është e dobishme dhe praktikë e mirë. Kjo e rrit transparencën e vendimmarrjes dhe e përmirëson kualitetin e propozimeve, meqenëse aplikuesit do t'ua përshtatin propozimet e tyre kriterëve të caktuara. Në disa raste, agjencitë që ofrojnë grante i publikojnë tabelat e poentimit, për shembull pikët potenciale që mund t'i marrë aplikanti për çdo kriter përzgjedhës apo peshën në përqindja, respektivisht pikët me të cilat vlerësohet çdo kriter në procesin e poentimit.

Kriteret e përzgjedhjes duhet të përcaktohen para shpalljes së thirrjes për aplikime. Kjo ngase dizajni i formularit për aplikim duhet të reflektojë kriteret e përzgjedhjes. Për shembull, nëse një nga kriteret përzgjedhëse është përvoja e mëhershme e aplikuesit në këtë fushë, në formularin për aplikim duhet të përfshihet edhe pyetja mbi përvojën përkatëse.

Gjithashtu është me rëndësi të jepen informacione për procedurën që ndiqet pas aplikimit: sa kohë duhet për marrje e vendimit, cilat janë kushtet e kontraktimit, kur mund të presë fituesi që t'i marrë fondet, a do të jepen mjetet në këste, cilat janë kërkesat për raportim etj. Kjo i informon organizatat për atë se çka mund të presin, gjë që e lehtëson hartimin e propozimeve fituese. Nëse këto informata nuk janë dhënë në thirrjen për propozime, atëherë do të ishte praktikë e mirë postimi i tyre në ueb-faqen e agjencisë në mënyrë që të jenë në dispozicion të organizatave.

Estonia: Rregullat e financimit të Fondacionit kombëtar për shoqëri civile (NFCS):
Ekspertët i vlerësojnë aplikacionet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Në rast të thirrjeve të hapura, kriteret për vlerësimin e thirrjes së hapur të NFCSë aprovohen nga drejtori ekzekutiv i NFCS-së;
- Në rast të projekteve „Idea e mirë” do të zbatohet qasja analitike dhe pas kësaj analiza e projektit të vlerësuar do të formalizohet, kurse rekomandimet do t'u ofrohen implementuesit të projektit dhe Bordit mbikëqyrës së NFCS-ë që financon projektin.

Do të vlerësohen aktivitetet e mëhershme të aplikantit, kapacitetet për implementimin e projektit, respektimi i kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në thirrjen e hapur, përmbajtja, përputhja e aktiviteteve dhe buxhetit me qëllimet e thirrjes së hapur, orientimi drejt arritjes së qëllimit dhe lidhja e plotë dhe e qartë me buxhetin, definimi i qartë i rezultateve në aplikacion, qasja e orientuar në arritjen e rezultateve dhe qëndrueshmëria e projektit, sinqeriteti në partneritet dhe bashkëpunimi me autoritetet publike, organizatat e biznesit dhe organizatat tjera jo për profit apo fondacionet.

Fondacioni kombëtar kroat është i obliguar të përfshijë informatat e mëposhtme në tenderët dhe thirrjet e publikuara:

- kushtet e tenderit;
- organizatat dhe programet që kualifikohen dhe ato që nuk kualifikohen për të aplikuar në tender /thirrje për shprehje të interesit;
- shumën maksimale të fondeve të caktuara për grante;
- numri i granteve që ofron ai tender/thirrje për shprehje të interesit;
- si të aplikoni (duke përfshirë qasjen në mënyrat dhe instruksionet se si të aplikohet);
- afati i fundit për aplikime;
- procedura e vlerësimit të grantit;
- procedura e përmbylljes së kontratës mbi grantin e fituar;
- mënyra e shfrytëzimit të fondeve dhe metoda e raportimit për mënyrën e shfrytëzimit të grantit.

Skema e Udhëzuesve për thirrje për propozim – Fondacioni kombëtar civil, Hungari⁴⁷

1. Hyrje (qëllimi dhe struktura e udhëzuesit, informacion i përgjithshëm për NCF)
2. Procedura e financimit (kohështrirja)
3. Thirrja për propozime (metoda e dorëzimit të tenderit, shpenzimet që kompensohen, shumën e ndihmës)
4. Pakoja e aplikimit (procedura e regjistrimit të obligueshëm, formulari i aplikimit, konflikti i interesit, rregullat e kontabilitetit, anekset e obligueshme)
5. Dorëzimi shtesë i dokumenteve të munguara (gabimet tipike, monitorimi formal)
6. Procedura dhe afati për marrjen e vendimit
7. Vlerësimi i aplikantëve pas vendimit
8. Kontrata (Monitorimi i kontratës dhe anekseve të saj, kërkesa për dokumente shtesë)
9. Formulari për amandamentime (parimet dhe informatat e përgjithshme)
10. Pjesa e ndihmës
11. Marrëveshja dhe monitorimi i ndihmës (raporti profesional dhe financiar, rregullat për ankesë)
12. Ndryshimi i datave
13. Mbyllja
14. Ankesa
15. Qasja në dokumente për rishikim
16. Anekset

Aneksi I. Parimet e financimit të Këshillit.

Aneksi II. Forma e raportit financiar.

Aneksi III. Ekstrakti i raportit për përfitim publik.

Aneksi IV. Drafti i letrës motivuese.

Aneksi V. Vendimi që ka të bëjë me procedurën raportuese dhe amandamentuese

.

⁴⁷ Udhëzuesi është amandamentuar për herë të fundit më 21 prill të viti 2010.

4. Shpallja e tenderit

Është në interes të agjencisë tenderuese që pas hartimit të thirrjes për propozime të ketë një numër sa më të madh të aplikacioneve. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është qarkullimi dhe publikimi sa më i madh i shpalljes së tenderit mes grupeve të caktuar. Disa nga mekanizmat më të zakonshme të shpërndarjes, bazuar në praktikën e tenderimit në CEE dhe Evropë, janë:

- Ueb-faqja e ministrisë apo agjencisë qeveritare;
- Baza e të dhënave e ministrisë dhe biltenët (informatorët) elektronik;
- Rrjetet profesionale (për shembull, rrjeti i shërbimeve sociale të OSHC-ve, organizatat për mbrojtjen e mjedisit, organizatat për fëmijë dhe rini);
- Qendrat e ndihmës – qendrore / rajonale/ lokale;
- Mediat elektronike dhe të shtypura “jo për profit”;
- Gazetat e përditshme;
- Ofertuesit për-profit që mbikëqyrin dhe njoftojnë për thirrjet për propozime në fusha të caktuara.

Fondacioni kombëtar kroat bën shpalljen e tenderëve/thirrjeve për propozime publike për donacione për shfrytëzuesit dhe thirrjet publike për shprehje të interesit për bashkëpunim, të paktën një herë në vit, në ueb-faqen e Fondacionit dhe në konferencat e shtypit.

Fondacioni estonez (NFCS)⁴⁸, procedurat për financimin e projekteve „Idea e mirë”:

“1.3. Reklamat për shpalljen e thirrjes së hapur do të botohen në gazetën e përditshme kombëtare, në faqen elektronike të NFCS-së dhe do të shpërndahen përmes pamfleteve informative për organizatat e shoqërisë civile. Reklamat do të informojnë për afatet kohore për dorëzimin e aplikacioneve, shumën e mjeteve financiare të thirrjes së hapur, informatat që kanë të bëjnë me dorëzimin e aplikacioneve dhe marrjen e informacioneve shtesë.”

5. Koha dhe afatet

Qëllimi

Kërkesa kryesore me rastin e shpalljes së tenderit është të sigurohet kohë e mjaftueshme për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacionit. Preferohet që para shpalljes së thirrjes për propozime të publikohet një mundësi e tillë me qëllim që t’u jap OSHC-ve kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur për aplikacion (për shembull, në formë të paralajmërimit të kohës së shpalljes së tenderit apo kalendarit të tenderit për grante për vitin pasues).

Dorëzimi

Nuk ka rregulla të qarta apo praktika më të mira sa i përket kohës optimal prej shpalljes së thirrjes për propozime deri në afatin për dorëzimin e aplikacionit. Kjo në tërësi varet nga

⁴⁸ Procedurat për shpalljen e thirrjeve të hapura, procedimi i aplikacioneve për projektin “Idea e mirë”, shpallja e grantit dhe mbikëqyrja e implementimit të tij www.kysk.ee/sisu/310_8739674_Procedures_for_announcing_open_calls_proceeding_applications_and_Good_Idea_projects_disclosing_and_monitoring_the_implementation_of_the_grant.pdf

agjencitë përkatëse dhe natyra respektivisht madhësia e tenderit në fjalë. Afatet mund të ndryshohen me qëllim që t'iu përshtaten rrethanave të posaçme. Sidoqoftë, duhet të ekzistojë një kornizë e përgjithshme kohore. Si rregull, çdo periudhë më e shkurtër se një muaj (ose 30 ditë) do të ishte shumë e shkurtër për të lansuar thirrje të suksesshme. Ja ku janë disa shembuj:

Kodi kroat përcakton se “tenderët për aplikimin e shoqatave duhet të jenë të hapur për të paktën 30 ditë pas publikimit të tyre.”

Projekti “Ideja e mirë” i bën thirrje Fondacionit të Estonisë që “Thirrja e hapur të shpallet të paktën 45 ditë kalendari para afatit për dorëzimin e aplikacioneve”.

Kodi maqedonas përcakton se: “çdo organ i administratës shtetëror do të ndajë fonde në përputhje me thirrjen publike të shpallur në shtypin ditor, në faqet e internetit të organeve administrative shtetërore dhe Sekretariatit të përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë/Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare, 30 ditë pas miratimit të buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe programit për financim”.

Sipas rregullore implementuese të Ligjit për financim kombëtar civil në Hungari⁴⁹, thirrjet për propozime duhet të publikohen të paktën 30 ditë para afatit për dorëzimin e aplikacionit.

Vlerësimi dhe vendimi

Afatet kohore që duhet të respektohen nga agjencia pas dorëzimit të aplikacionit janë çështje sensitive në procesin e grant-dhënies. Shumica e ligjeve dhe rregulloreve nuk parashohin afate të brendshme kohore, për këtë arsye ato ose nuk janë përcaktuar ose janë përcaktuar me procedurat e brendshme që mund të jenë mjaft fleksibile. Megjithatë, koha prej dorëzimit të propozimit e deri te transferimi i mjeteve është me rëndësi qenësore jo vetëm për OSHC-të që i pranojnë ato por edhe për donatorin qeveritar. Për këtë arsye vendosja e afateve kohore edhe për vendimmarrje nga donatori qeveritar është praktikë e mirë.

Projekti Ideja e mirë i bën thirrje Fondacionit estonez që t'i kërkojë Fondacionit kombëtar për shoqëri civile t'i vlerësojë aplikacionet dhe projektet brenda 60 ditësh nga përfundimi i afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Në Hungari, Udhëzuesi përcakton se evaluimi i aplikacioneve do të bëhet brenda 77 ditëve nga moment i dorëzimit të aplikacionit, në përputhje me afatin a aprovuar nga Këshilli⁵⁰. Sipas këtij afati, organizatat e refuzuara do të informohen brenda 103 ditëve, përderisa organizatat fituese do të informohen brenda 115 ditësh. Kontrata duhet të nënshkruhet jo më vonë se 165 ditë nga dorëzimi i aplikacionit dhe

⁴⁹ 160/2003. (X.7.) Rregullorja qeveritare mbi Implementimin e ligjit No. 2003/L. për Fondin kombëtar qytetar

⁵⁰ Vendimi numër 43/2009 i Këshillit të Fondit kombëtar qytetar mbi përcaktimin e rezultateve të vendimit (4 prill 2009)

transferimi i mjeteve duhet të ndodh brenda 180 ditësh. Në bazë të asaj që është përshkruar më lartë e gjithë procedura mund të zgjasë deri në gjysmë viti.

6. Dokumentacioni i nevojshëm

Informacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të bazohen në parimin e proporcionalitetit, i cili nënkupton se sasia e informatave të kërkuara duhet të jetë proporcionale me shumën e mjeteve të ofruara dhe objektivat e synuar përmes skemës së financimit.

Një problem i shpeshtë me të cilin ndeshen OSHC-të gjatë aplikimit është numri i madh i dokumenteve që duhet dorëzuar siç janë: statutet, rregulloret, certifikatat e regjistrimit, raportet financiare dhe të auditimit, certifikatat bankare, licencat dhe certifikatat nga autoritete të ndryshme (puna, tatimet, sigurimi social etj.). Donatorët i kërkojnë këto dokumente si prova se aplikuesi i plotëson kushtet për kualifikim. Dokumentacioni i kërkuar mund të kalojë 100 faqe dhe nganjëherë duhet të dorëzohet në dy apo tre kopje. Procedura e tillë përbën barrë të madhe si për aplikuesin ashtu edhe për zyrtarët qeveritarë të cilët e pranojnë dhe e shqyrtojnë dokumentacionin. Më poshtë janë prezantuar metodat e përdorura nga qeveritë për ta lehtësuar punën:

- përmes sistemit të para-kualifikimit (shih më lartë);
- përmes krijimit të dosjes së përbashkët qendrore me dokumentacionin e OSHC-ve që harmonizon nevojat e departamenteve të ndryshme të qeverisë;
- duke kërkuar apo preferuar që aplikacionet të dorëzohen në mënyrë elektronike; apo
- duke zbatuar rregullën procedurale sipas së cilës dokumentacioni në mbështetje të kualifikimit institucional apo teknik kërkohet vetëm nga aplikuesit e suksesshëm para nënshkrimit të kontratës për grant. Fillimisht të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë vetëm deklaratën e nënshkruar se OSHC-të i plotësojnë në tërësi kriteret e cekura në thirrjen për propozime.

Problem tjetër është se aplikuesit shpesh ofrojnë informacione jo të plota në lidhje me kërkesat teknike. OSHC-të më të vogla apo organizatat që nuk kanë personel administrativ profesional do ta kenë të vështirë përmbushjen e të gjitha kërkesave teknike në mënyrë precize. Nganjëherë thirrjet për propozime nuk janë të qarta sa duhet për llojin e dokumenteve që duhet dorëzuar. Kjo mund të rezultojë me refuzimin e aplikacioneve kualitative për shkak të mos përmbushjes së kriterëve zyrtarë për “shkaqe teknike”.

Politika e donatorit mund të jetë e tillë që të mbështes vetëm organizatat shumë profesionale që kanë kapacitete administrative për t'i përmbushur kërkesat teknike, me ç'rast refuzimi i aplikacioneve tjera është pjesë e procesit të përzgjedhjes. Në raste tjera donatori mund të përcaktohet për politikën që lejon dorëzimin e mëvonshëm të dokumenteve që mungojnë. Nëse kjo ndodh, sipas procedurës OSHC-të njoftohen për dokumentet të cilat duhet t'i dorëzojnë apo t'i ndryshojnë dhe u jepet një kohë relativisht e shkurtër për ta kompletuar dokumentacionin. Kjo praktikë është treguar e suksesshme në përmirësimin e aplikacioneve të OSHC-ve sepse ato ofrojnë mundësi për t'i korrigjuar gabimet teknike dhe për të mësuar nga ato.

Fondi kombëtar qytetar, Hungari⁵¹

Në rast të aplikacionit të pakompletuar apo aplikacionit me gabime të cilat mund të korrigjohen, autoriteti përzgjedhës e thërret organizatën në fjalë brenda 10 ditëve të punës nga dita e pranimit të aplikacionit dhe i kërkon të dorëzojë dokumentet shtesë. Dorëzimi i dokumenteve të munguara mund të bëhet brenda 10 ditëve të punës nga dita e marrjes së njoftimit, por jo më vonë se 15 ditë pune nga dita kur është dërguar njoftimi. Në rast të aplikimit online marrja e njoftimit nënkupton hapjen e mesazhit me kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë.

Aplikacioni është i pavlefshëm nëse:

- a) mungesat në aplikacion nuk mund të korrigjohen me dokumentacion shtesë, apo
- b) nëse organizata që ka aplikuar nuk i përgjigjet kërkesës për dorëzimin e dokumentacionit shtesë, apo nuk e bën këtë në mënyrën e përcaktuar në mesazhin njoftues.

Fondacioni i Estonisë (NFCS)⁵² procedurat për financimin e projekteve „Ideja e mirë”:

4.2.2. Nëse vlerësimi teknik konstaton se aplikanti, aplikacioni apo projekti “Ideja e mirë” nuk është në përputhje me kërkesat, ai do të **zyrtarizohet** me protokollin e brendshëm të vlerësimit dhe nuk i nënshtrohet vlerësimit të përmbajtjes. Në rast të aplikacionit të mangët, NFCS-ja i informon aplikuesit përmes postës elektronike brenda shtatë ditëve të punës pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Aplikuesi mund ta kundërshtojë këtë në përputhje me rregulloret e NFCS-së për kundërshtim.

4.2.3. Në rast të të metave të vogla në aplikacion, aplikuesit do t’i kërkohej të dorëzojë aplikacionin korrekt brenda tre ditëve të punës.

VII. VENDIMMARRJA

Vendimmarrja është një hap i rëndësishëm në procesin e financimit publik. Gjatë këtij procesi është me rëndësi që të sigurohet zbatimi i kritereve të hartuara në tender. Çështjet që duhet shqyrtuar kur diskutohet për vendimmarrje gjatë procesit të financimit janë:

1. Komisioni përzgjedhës

Çështjet që duhet marrë parasysh me rastin e përzgjedhjes së komisionit janë përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të tij, kush merr vendime dhe cila është përbërja e organit vendimmarrës (dhe si të shmangët konflikti i interesit në organin që merr vendime). Ekziston mendimi se komisioni përzgjedhës takohet vetëm një herë për të vlerësuar propozimet, por e vërteta është se përgjegjësia e komitetit shkon përtej detyrës së përzgjedhjes. Organi vendimmarrës ka këto përgjegjësi që lidhen me programin e granteve:

- Të përcaktojë qëllimet e programit;

⁵¹ 160/2003 (X.7.) Rregulloret qeveritare mbi Implementimin e ligjit numër 2003/L. mbi Fondin kombëtar civil

⁵² Procedurat për shpalljen e thirrjeve të hapura, procedimi i aplikacioneve dhe projekteve të „Idesë së mirë”, bërja publike dhe mbikëqyrja e implementimit të grantit www.kysk.ee/sisu/310_8739674_Procedures_for_announcing_open_calls_proceeding_applications_and_Good_Idea_projects_disclosing_and_monitoring_the_implementation_of_the_grant.pdf

- Të përcaktojë objektivat / indikatorët e suksesit të programit të granteve;
- Të përcaktojë kriteret kualifikuese;
- Të përcaktojë kriteret vlerësuese;
- Të pajtohet për parimet e vendimmarrjes (duke përfshirë edhe poentimin apo sistemin tjetër vlerësues, rregullat për shmangien e konfliktit të interesit, procedurën e votimit, etj.);
- Të pajtohet për të gjitha elementet e Thirrjes për propozime;
- Të shqyrtojë Thirrjen për propozime /shpalljen e granteve;
- Të shqyrtojë dhe vlerësojë/poentoj propozimet;
- Të pajtohet për vendimet;
- Të pajtohen për mënyrën e komunikimit të vendimeve;
- Të vlerësojë suksesin e programit.

Këto detyra mund të ndahen mes aktorëve të ndryshëm.

- Personeli i agjencisë që ofron grante mund të ketë rolin udhëheqës në përgatitjen e pjesës më të madhe të kriteve dhe thirrjeve për propozime.
- Zgjedhja e rëndomtë është kontraktimi i jashtëm i profesionistëve të pavarur për të bërë shqyrtimin dhe poentimin e propozimeve (bazuar në udhëzime të qarta) ashtu që vendimmarrësit të kenë në dispozicion rezultatet e vlerësimit për secilin propozim.
- Një mënyrë tjetër është që procesi i vendimmarrjes të ndahet në mes të komisionit (që zakonisht përbëhet nga ekspertë të pavarur), i cili shqyrton dhe rekomandon propozime të cilat ia përcjellë bordit të lartë (që zakonisht përbëhet nga zyrtarë të qeverisë), i cili merr vendimin përfundimtar.

Fondacioni i Estonisë (NFCS)⁵³ - Procedurat për financimin e projekteve “Ideja e mirë”:

“4.2.4. Aplikacionet dhe projektet që kanë kaluar vlerësimin teknik do t’iu dorëzohen të paktën dy ekspertëve të pavarur (kur kemi të bëjmë me garën në kuadër të projekteve „Ideja e mirë”) apo tre ekspertëve të pavarur (në rastin e Thirrjes për propozime)” për të vlerësuar përmbajtjen e tyre.

Kodi maqedonas:

“Zgjedhja e projekteve do të bëhet nga **komisioni**. Anëtarët e komisionit do të jenë të punësuarit në administratën shtetërore, në organet tjera të administratës shtetërore dhe, nëse është e paraparë, ekspertët e ftuar nga administrata shtetërore. Metoda dhe procedura për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit, përcaktimin e detyrave të tyre dhe mënyrën e shmangies së konflikteve të interesit duhet të përcaktohet nga secili organ i administratës shtetërore”.

⁵³ Procedurat për shpalljen e thirrjeve të hapura, procedimi i aplikacioneve dhe projekteve të „Idesë së mirë”, bërja publike dhe mbikëqyrja e implementimit të grantit www.kysk.ee/sisu/310_8739674_Procedures_for_announcing_open_calls_proceeding_applications_and_Good_Idea_projects_disclosing_and_monitoring_the_implementation_of_the_grant.pdf

Konflikti i interesit

Një nga pyetjet që shtrohet me rastin e përzgjedhjes së komisionit është se kush duhet të jetë pjesë e tij dhe nëse aty duhet të inkuadrohen edhe përfaqësuesit e OSHC-ve. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të OSHC-ve do t'i mundësonte komisionit të ketë anëtarë të cilët e njohin këtë fushë, i kuptojnë problemet dhe janë politikisht të pavarur. Megjithatë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të OSHC-ve mund të paraqesë konflikt të interesit, problem ky që është vështirë të shmanget.

Konflikti i interesit nënkupton çdo situatë ku një person me autoritet vendimmarrës ka një interes që – potencialisht apo realisht – mund të ndikojë në vendimin e tij apo saj. Zhvillimi i politikave që parandalojnë konfliktin e interesit është shumë i rëndësishëm për organet qeveritare vendimmarrëse. Politikat e këtilla sigurojnë shfrytëzimin racional të parave të taksapaguesve sikurse edhe transparencën, objektivitetin dhe trajtimin korrekt të OSHC-ve dhe përfituesve tjerë.

Fondi civil hungarez është ballafaquar me kritika për shkak të mungesës së mbrojtjes nga konflikti i interesit. Bordi i fondit civil përbëhej nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe qeverisë, kurse përfaqësuesit e shoqërisë civile kishin të drejtë të pranojnë grante nga Fondi civil.⁵⁴ Për më tepër, nuk kishte asnjë udhëzues që ua ndalonte përfaqësuesve të votojnë për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Si rezultat u paraqit tendenca që OSHC-të e afërta me liderët e shoqërisë civile të përfshirë në vendimmarrje t'i merrnin të gjitha fondet për të cilat aplikonin, ndërsa OSHC-të tjera nuk e kishin këtë fat. Në fund, kritikantët e ministrit dhe shoqërisë rezultuan me miratimin e rregullores së brendshme e cila i adreson çështjet që lidhen me konfliktin e interesit.

Përpos hartimit të politikave për shmangien e konfliktit të interesit, anëtarëve të këtij organi mund t'iu kërkohet t'i nënshkruajnë këto politika apo t'i dorëzojnë deklaratat vjetore përmes të cilave njoftojnë për konfliktet reale apo potenciale të interesit ose të deklarojnë për lidhje të caktuar apo të gjitha lidhjet që kanë me organizatat e ndryshme, të cilat pastaj mund të verifikohen.

Politikat dhe procedurat e financimit duhet të sqarojnë: (1) çka konsideron konflikt interesi organi vendimmarrës (për shembull lidhjet me OSHC-në përfituese; pranimi i dhuratave, shpërblimeve dhe mirënjohjeve tjera nga aplikuesi dhe kështu me radhë); (2) çfarë procedure zbatohet për të zbuluar një interes të tillë (për shembull deklarata vjetore); dhe (3) cilat janë mënyrat për t'u ballafaquar me konfliktet e interesit.

Në shumë shtete problematika e konfliktit të interesit në ndarjen e fondeve publike është trajtuar në kuadër të rregulloreve anti-korrupsion apo rregulloreve etike të një fushe më të gjerë, duke përfshirë edhe ligjet e prokurimit, ligjet për lobim dhe rregulloret mbi sjelljen e zyrtarëve qeveritarë.

2. Kriteret e seleksionimit

Kriteret objektive kundrejt atyre subjektive

⁵⁴ “Fondi kombëtar qytetar në Hungari,” ECNL (2008).

Dallimi kryesor në mes të kriterëve kualifikuese dhe kriterëve përzgjedhëse është se të parat janë kushte objektive që mund të plotësohen me dokumentacion të qartë, kurse të dytat zakonisht u referohen kushteve që mund të vlerësohen (maten) vetëm me vendimin e përbashkët të organit vendimmarrës. Kriteret kualifikuese përcaktojnë prapësin për pjesëmarrje, kurse kriteret seleksionuese e përcaktojnë propozimin fitues. Shkalla e përbashkës së kriterëve përzgjedhëse do të matet në mënyrë subjektive (që përbën arsyen pse në shumë thirrje për propozime theksohet qartë se nuk ka asnjë mundësi për apelimin e vendimit).

Pavarësisht kësaj, publikimi i kriterëve seleksionuese (shih më lartë) dhe hartimi i procedurës për vlerësimin kolektiv të këtyre kriterëve (p.sh. tabelës poentuese) në kohën e shpalljes së thirrjes për propozime paraqet praktikë të mirë. Kjo do t'i ndihmojë OSHC-të të kuptojnë prioritetet e donatorit dhe t'i përgatisin aplikacionet e tyre në mënyrë adekuate, duke e bërë procesin e vlerësimit më të lehtë për vlerësuesit. Më poshtë janë paraqitur dy tabela të cilat tregojnë kriteret e shfrytëzuara nga Fondacioni i Estonisë.

Një vit pas fillimit të veprimtarisë së vet, Fondacioni kombëtar në Kroaci u përball me kritika të ashpra për shkak të mënyrës së ndarjes së fondeve, e posaçërisht për shkak të konfliktit potencial të interesit si pasojë e përfaqësimit të OSHC-ve në Bordin menaxhues të Fondacionit. Rregullorja⁵⁵ aktuale përmban dispozitën e mëposhtme që adreson konfliktin e interesit, në përpjekje për të siguruar një proces transparent dhe korrekt.

Neni 9: Masat mbrojtëse për parandalimin e konfliktit të interesit

“Konflikti potencial i interesit lind nëse anëtari i Bordit menaxhues apo anëtari i ndonjë organi tjetër të Fondacionit vendos për çështje që kanë të bëjnë me një person juridik i cili është anëtar, pjesë e menaxhmentit apo posedon asete në atë organizatë. Në këtë rast, vlen dispozita e nenit 11 paragrafi 1 i Aktit mbi Fondacionin kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile, prandaj anëtari i Bordit menaxhues ose anëtari i ndonjë organi tjetër të Fondacionit (Komisioni i programit, Këshilli për investime strategjike në zhvillimin e shoqërisë civile etj.) nuk ka të drejtë të votojë apo të vendosë.

Procedura për bërjen publike apo mbrojtjen nga konflikti i mundshëm i interesit është plotësuar me Rregullat e procedurës për punën e Bordit menaxhues dhe organeve tjera të Fondacionit.

Regjistri me konfliktet e mundshme të interesit për secilin anëtar të Bordit menaxhues dhe organeve tjera të Fondacionit ndodhet në arkivin e këtij organi. Regjistri nuk është dokument publik, por ai mund t'u vihet në dispozicion për inspektim përfaqësuesve të organeve të autorizuara.”

Tabela 1: Fondacioni i Estonisë: Kriteret teknike të vlerësimit

⁵⁵ Rregullorja mbi kushtet dhe procedurat për ndarjen e fondeve për përbashkjen e qëllimeve të fondacionit, 2005

Aplikuesi:		Numri i aplikimit:	
Titulli i projektit:			
	Po	Jo	Komenti
Aplikacioni dërgohet në mënyrë elektronike dhe në formë të shtypur (hard-copy) - i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor, apo dërgohet në mënyrë elektronike - i nënshkruar në mënyrë digjitale nga përfaqësuesi ligjor:			
Të gjitha hapësirat në formularin për aplikim janë të plotësuara:			
Aplikuesi i plotëson kushtet (duke përfshirë edhe kushtin e punës në interes të publikut për të paktën një vit):			
Partnerët i plotësojnë kushtet, janë të paktën dy komuna lokale si partnerë:			
Statutet e organizatave të aplikuesve, bordi i drejtorëve dhe raporti i konfirmuar për vitin e fundit fiskal publikohen në ueb-faqen e aplikuesit; nuk ka shmangie nga tatimi:			
Buxheti është në përputhje me kërkesat e paraqitura në Thirrjen e hapur, shpenzimet janë të pranueshme:			
Lartësia e bashkëfinancimit është në përputhje me kërkesat:			
Shpenzimet janë llogaritur në mënyrë korrekte, janë të arsyeshme dhe të sqaruara në aplikacion:			
Komente:			
Aplikacioni kalon vlerësimin teknik:	Po	Jo	Emri, data, nënshkrimi

Tabela 2: Fondacioni i Estonisë: Kriteret e vlerësimit të përmbajtjes

Kriteret e vlerësimit
1. Përputhshmëria e qëllimeve të projektit me qëllimet e programit dhe thirrjes së hapur
1.1. A janë qëllimet e projektit në përputhje me qëllimet e programit dhe thirrjes së hapur dhe a janë aktivitetet e financuara konkrete dhe të arritshme në praktikë?
1.2. Sa është i kuptueshëm dhe konkret përkufizimi i grupeve të caktuar dhe përfituesve përfundimtar dhe a janë arsyetuar nevojat e tyre në mënyrë të kënaqshme?
2. Përvoja dhe kapaciteti i aplikuesit
2.1. A posedon aplikuesi dhe menaxheri i projektit njohuritë, shkathtësitë, përvojën dhe aktivitetet e duhura (duke përfshirë edhe ato etike) si dhe kapacitetet e nevojshme ekonomike për ta implementuar projektin?
3. Metodologjia (mënyra e punës)
3.1. Arsyet pse nevojitet projekti: a është arsyetuar si duhet në aplikacion domosdoshmëria për t'u marrë me këtë problem? A ekziston ndonjë analizë përkatëse?
3.2. A është plani i punës i qartë, logjik dhe i zbatueshëm? A janë menduar si duhet aktivitetet e planifikuara, a janë ato praktike dhe a mundësojnë arritjen hap pas hapi të objektivave të projektit dhe rezultateve të dëshiruara? A mjaftojnë aktivitetet e planifikuara për arritjen e objektivave të përcaktuara dhe a zhvillohen këto aktivitetet gjatë gjithë kohës sa zgjat projekti?
3.3. A janë përfshirë përfaqësuesit e grupeve të caktuar dhe përfituesit përfundimtarë (organizatat partnere) në implementimin e projektit dhe, nëse po, deri në ç'masë? A e ndihmon projekti pjesëmarrjen e grupeve të caktuar?
4. Rezultatet dhe produktet
4.1. A janë rezultatet e planifikuara (impaktet) relevante dhe në përputhje me objektivat e planifikuara? Nëse po, deri në çfarë mase? A mund të maten rezultatet? A përmban projekti indikatorë objektivë për vlerësimin e rezultateve?
4.2. A janë produktet e planifikuara relevante, të domosdoshme dhe të arsyetuara? Nëse po, deri në ç'masë?
5. Qëndrueshmëria
5.1. Çfarë ndikimi kanë aktivitetet e planifikuara në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë civile të Estonisë (përkujdesja për OSHC-të, aftësimi i tyre për hartimin e politikave publike apo ndikimi në përmirësimin e pjesëmarrjes, ngritjen e vetëdijes së publikut etj.)?

5.2. A janë të qëndrueshme rezultatet e planifikuara:

- institucionalisht (ndikimi dhe/ose vazhdimi i aktiviteteve pas përfundimit të projektit);
- ndikimi struktural i aktiviteteve – vlerësimi i kohëzgjatjes së formave të ndryshme të bashkëpunimit të lansuar
- bashkëpunimi në mes të shoqatave, autoriteteve publike dhe sektorit privat etj.?

6. Vlerat tjera

6.1. Çfarë vlerash tjera ka projekti që meritojnë pikë shtesë (qasje inovative, zgjidhje interesante, mundësi për t'u përdorur dhe shfrytëzuar edhe nga shoqatat tjera jo profitabile; shpërndarje efikase e informatave; partneritet me shoqatat tjera jo profitabile dhe/ose strukturat e autoriteteve publike, qeverisje e mirë, pjesëmarrje, avancim i pjesëmarrjes, zhvillim i qëndrueshëm, përfshirje sociale etj.)?

7. Saktësia e buxhetit dhe sqarimi i përpiktë

7.1. Deri në ç' masë kërkohet mbulimi i shpenzimeve të planifikuara dhe sa janë ato reale për realizimin e aktiviteteve të planifikuara? Si sqarohen, arsyetohen dhe llogariten shpenzimet në pjesën ku arsyetohet buxheti?

7.2. A është optimal raporti në mes të shpenzimeve të llogaritura dhe rezultateve të planifikuara?

7.3. Deri në ç' masë janë përfshirë vullnetarët dhe sa e saktë është llogaritja e punës së tyre vullnetare?

Zgjedhjet themelore strategjike dhe politikat e përzgjedhjes

Një nga problemet më të shpeshta me të cilin përballlet çdo donator është pranimi i një numri më të madh të aplikacioneve se ç'mund të financohen me buxhetin e tij. Me qëllim që të mundësohet vendimmarrja efektive dhe transparente, prioritetet dhe strategjitë që do të ndiqen nga paneli vendimmarrës gjatë procesit të përzgjedhjes duhet të diskutohen dhe përcaktohen paraprakisht (para shqyrtimit të propozimeve). Kjo do t'i ndihmojë OSHC-të t'i kuptojnë arsyet e mos-përzgjedhjes së propozimeve të tyre edhe kur ato janë vlerësuar lartë dhe kualifikuar për mbështetje financiare. Çështjet që duhet adresuar janë:

- A do të mbështesim një numër më të madh të organizatave me shuma më të vogla, apo më pak organizata me shuma më të mëdha?
- A do t'i mbulojmë buxhetet e plota, ashtu siç janë kërkuar, apo do të propozojmë ndihmë financiare më të vogla se buxhetet e propozuara?
- A do të kujdesemi për mbulimin e plotë gjeografik të vendit, duke kufizuar numrin e aplikacioneve fituese në secilin rajon apo qark?
- A do të sigurojmë diversitet apo baraspeshë bazuar në fushat e aktivitetit, madhësisë, etnitetit, formës ligjore apo cilitdo kriter tjetër?

Sipas Ligjit mbi Fondin kombëtar qytetar, Këshilli është i thirrur të përcaktojë rregullat themelore të sistemit financiar, ndërsa kolegjet do të veprojnë në përputhje

me të. Në përputhje me këtë autorizim, kohëve të fundit Këshilli ka miratuar parimet e reja të financimit nga viti 2011⁵⁶.

Me qëllim të implementimit të parimit të mundësive të barabarta për aplikuesit nga të gjitha fushat, rregullat e financimit theksojnë se gjatë procesit të tenderimit dhe vlerësimit të aplikacioneve kolegjet nuk duhet të shqyrtojnë aspektet e mëposhtme:

- (a) vlerësimin apo klasifikimin e fushave të aktiviteteve profesionale apo aktiviteteve në kuadër të një profesioni;
- (b) diferencimin e organizatave të shoqërisë civile në bazë të kategorive ligjore; dhe
- (c) përcaktimin e limiteve, proporcioneve dhe rendit në mes të distrikteve apo aranzhimet e veçanta për distriktet.

Sipas raportit të ministrisë, në vitin 2009 kolegjet profesionale e shpërndanë ndihmën financiare në mënyrë të tillë që 34.8% e mjeteve u takuan organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Budapest.

3. Procesi i vendimmarrjes

Metodat, proceset dhe rregullat e vendimmarrjes

Metodologjia që do të përdoret me rastin e marrjes së vendimit do të varet nga madhësia e programit, numri dhe volumi i aplikacioneve të pranuar, numri i anëtarëve në organin vendimmarrës dhe kështu me radhë. Shpeshherë vendimmarrësi (për shembull Bordi) nuk i shqyrton të gjitha propozimet në detaje, por vetëm një përmbledhje të rekomandimeve të përgatitura nga personeli, ekspertët apo komisioni i caktuar për përzgjedhje (ky skenar është përshkruar më poshtë, me shembullin e Fondacionit kombëtar në Kroaci). Është me rëndësi që në rastet e tilla Bordit t'i ofrohen informatat e plota dhe të domosdoshme për të marrë vendimet e duhura. Praktika e mirë kërkon që Bordit t'i jepet kohë dhe mundësi e mjaftueshme për të shqyrtuar, hulumtuar dhe, nëse ka nevojë, për t'i shqyrtuar përsëri propozimet e rekomanduara nga ekspertët vlerësues. Njëkohësisht Bordi nuk duhet t'i ndryshojë rekomandimet bazuar në kritere tjera (për shembull, në bazë të lidhjeve politike apo interesave personale), por vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara.

Fondacioni kombëtar kroat shfrytëzon procesin tre-fazësh në marrjen e vendimit⁵⁷:

1. *Verifikimi* se janë plotësuar kushtet zyrtare të përcaktuara në tender.
2. *Vlerësimi i cilësisë* së aplikacionit nga Komiteti i Programit, që është organ kolegjal me 5 ekspertë.
3. *Vendimmarrja* mbi aprovimin e grantit nga Bordi Menaxhues i Fondacionit. Nëse Bordi nuk pajtohet me vendimin e Komitetit të Programit për ndarjen e

⁵⁶ Këshilli mori vendim më 10 nëntor 2010 dhe është publikuar në ueb-faqen më 15 nëntor 2010.

⁵⁷ Hadzi-Miceva K., dhe Suplisson, F., "Vështrim i skemave të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile", ECNL dhe COW I/A (2007)

grantit, ai i kërkon këtij të fundit që ta rishqyrtojë propozimin. Në këtë rast, procedura për ndarjen e grantit përsëritet.

Procesi i verifikimit mund të bëhet përmes listës kontrolluese e cila vërteton se aplikacioni i plotëson të gjitha kriteret kualifikuese. Komiteti i programit të Fondacionit kombëtar vazhdon me procesin e vlerësimit të kualitetit duke shfrytëzuar *tabelat vlerësues* për OSHC-të dhe vlerësuesit që udhëheqin procesin e evaluimit të granteve. Është me rëndësi që sistemi i rangimit të përputhet me kriteret e seleksionimit. Zakonisht pikët jepen për çdo kriter dhe propozim, qoftë si pikë mesatare apo pikë të përgjithshme (për shembull, në shkallën prej 1-10). Ky proces çon në radhitjen numerike të propozimeve, që pastaj mund të diskutohet dhe finalizohet në mbledhjen e komitetit.

Hungaria: Në përputhje me Udhëzuesin, procedura prej dorëzimit të aplikacionit e deri te njoftimi i aplikuesit mbi vendimin është si më poshtë:

1. Pas pranimit të aplikacioneve ato do të jenë nën mbikëqyren formale të autoriteteve menaxhuese. Vetëm aplikacionet që i plotësojnë të gjitha kërkesat formale janë të vlefshme. Aplikacione që nuk janë në përputhje me të gjitha kërkesat formale konsiderohen të mangëta apo të pavlefshme. Për hir të përgatitje së aplikacioneve të vlefshme, Udhëzuesi përmban diagramin me të gjitha aspektet mbikëqyrëse.
2. Në rast se aplikacioni është i mangët, aplikuesi ka një mundësi t'i përmirësojë defektet pas lajmërimit nga autoriteti menaxhues. Në rast se autoriteti menaxhues përcakton se aplikacioni është i pavlefshëm, aplikuesi ka të drejtën të ankohet për vendimin brenda tre ditëve të punës.
3. Pas dorëzimit të dokumenteve të munguara, autoritetet menaxhuese do t'ia dërgojë aplikacionet e vlefshme kolegjeve. Kolegjet janë të autorizuar t'i vlerësojnë aplikacionet dhe të marrin vendim.
4. Vendimet e kolegjeve aprovohen dhe nënshkruhen nga autoritetet menaxhuese.
5. Autoritetet menaxhuese do ta njoftojnë aplikuesin me shkrim mbi vendimin.

Transparenca dhe komunikimi i kriterëve dhe vendimit

Shumica e ligjeve mbi financimin publik kërkojnë publikimin e rezultateve të vendimmarrjes, për shembull, listën me organizatat e mbështetura financiarisht dhe shumën që ato kanë pranuar. Mënyra më e mirë e shpërndarjes së kësaj informate është përmes kanaleve të njëjta sikurse edhe thirrja për propozime; sidoqoftë, duhet të ekzistojë të paktën një platformë në të cilën kanë qasje shumica e organizatave (siç është interneti apo gazeta ditore) ku të interesuarit mund t'i gjejnë këto informata.

Për shembull, Zyra kroate për bashkëpunim me shoqatat mirëmban online bazën e të dhënave me projektet e financuara nga agjencitë e ndryshme shtetërore që financojnë OSHC-të: (<http://ëëë.uzuvrh.hr/potpore.aspx?pageID=58>). Baza e të dhënave mund të kërkohe sipas nivelit (kombëtar, lokal, rajonal, ndërkombëtar), institucionit, projektit/programit, organizatës dhe menaxherit kryesor të projektit.

Një nga dilemat kryesore me të cilën ballafaqohen donatorët qeveritarë është nëse duhet të jepen arsyet për refuzimin e projekt-propozimeve. Zakonisht aplikuesit marrin një letër refuzuese me vetëm një fjali ku thuhet se projekt-propozimi është me vlerë por nuk ka fonde të mjaftueshme për të financuar të gjitha propozimet. Sidoqoftë, kjo formë e sqarimit le të hapur pyetjen se pse pikërisht ky propozim është refuzuar. Mosdhënia e arsyeve të qarta mund të krijojë përshtypjen e mungesës së transparencës në procesin e vendimmarrjes dhe nuk i ndihmon OSHC-të të përgatisin propozime më të mira në të ardhmen.

Prandaj komunikimi i arsyeve për refuzimin e propozimit duke ofruar sqarime për fushat në të cilat projekt-propozimi ka pasur mangësi, e që ka ndikuar në refuzimin e tij, konsiderohet praktikë e mirë. Përkundër faktit se OSHC-të nuk mund të presin nga donatori të jap sqarime të detajuara për arsyet e refuzimit për secilin projekt-propozim, donatori ka mundësi të ofrojë një listë kontrolluese të kriterëve përzgjedhëse, duke nënvizuar pikët e dobëta. Nga ana tjetër, organi vendimmarrës mund të ofrojë informacion të plotë mbi mënyrën e poentimit të aplikuesit, duke i ndihmuar atij që t'i përmirësojë aftësitë për zhvillimin e projektit.

Kodi civil hungarez kërkon që të gjitha sesionet e organeve vendimmarrëse (për shembull, sesionet e Këshillit dhe kolegjeve) të jenë të hapura për publikun.

Sipas seksionit 9 të Ligjit mbi Fondin kombëtar qytetar, sesionet e Këshillit dhe kolegjeve janë të hapura për publikun. Këshilli apo Kolegji mund të vendos për mbajtjen e sesioneve apo negociatave të mbyllura për ndonjë pikë të caktuar të agjendës, në rast se kjo arsyetohet me mbrojtjen e të drejtave personale, të dhënave personale apo mbarëvajtjes së punëve. Vendimet që do të merren në sesionet e mbyllura do të publikohen. Sesioni apo negociatat për ndonjë pikë të caktuar të agjendës do të jenë të mbyllura nëse për të votojnë 2/3 e anëtarëve prezent. Për hir të promovimit të veprimtarisë së NCF-së, ministri duhet ta menaxhojë ueb-faqen ku lajmërohet për vendin, datën dhe agjendën e sesionit.

Fondacioni kombëtar kroat

Rregullorja mbi kushtet dhe procedurën e ndarjes së fondeve për arritjen e qëllimeve të Fondacionit:

“Vendimet e miratuara nga Fondacioni kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile lidhur me aprovimin apo refuzimin e granteve janë përfundimtare. Çdo organizatë që ka aplikuar për grant mund të ankohet në Bordin e Fondacionit/Menaxhues brenda 8 ditëve nga dita e marrjes së rezultatit të tenderit, nëse ka vërejtur lëshime në procedurën e vlerësimit të aplikacionit. Bordi menaxhues i Fondacionit do t'i përgjigjet ankesës brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të saj”.

VIII. KONTRAKTIMI DHE PAGESAT

Përvojat me financimet qeveritare tregojnë se sfidat për OSHC-të nuk përfundojnë në momentin e ndarjes së granteve. Në realitet, OSHC-ja mund ta ketë më të vështirë ta ekzekutoj kontratën sesa ta fitojë grantin, sepse në këtë fazë nuk ka presion nga publiku mbi qeverinë dhe kjo e fundit mund ta ushtrojë autoritetin e saj në çdo kohë duke bllokuar fondet. Prandaj, është shumë me rëndësi përpilimi i dispozitave bazë që rregullojnë procedurat e kontraktimit dhe pagesës, me qëllim që t’iu mundësohet OSHC-ve t’i zbatojnë me sukses projektet e financuara. Praktikrat e mira që zbatohen në shtetet e analizuara në këtë dokument përfshijnë:

1. Përmbajtja e kontratës

Kontraktimi pason procesin e përzgjedhjes së aplikacioneve fituese. Në disa shtete përmbajtja e kontratës është e përcaktuar në mënyrë të detajuar në ligjet që rregullojnë financimin publik të OSHC-ve. Në mungesë të ligjeve të tilla, kontrata do të bazohet në rregullat e përgjithshme, duke përfshirë edhe ato mbi masat ndëshkuese dhe përfundimin e kontratës. Organet qeveritare, si rregull, përdorin formularë standard të kontratave. Për shkak të dallimeve në autoritetin e palëve të përfshira, ekziston shumë pak hapësirë për negociata të mëtutjeshme.

160/2003. (X. 7.) Rregullorja e qeverisë, Hungari

Kontrata

“9. § (1) Autoriteti menaxhues i Fondit e bën kontraktimin e organizatës që ka aplikuar për ndihmë financiare duke u bazuar në vendimin e Kolegjit për ndarjen e grantit. Me qëllim të finalizimit të kontratës, autoriteti menaxhues i Fondit u bën thirrje organizatave të cilat aplikojnë për ndihmë financiare (grant) që t’i dërgojnë dokumentet e nevojshme për finalizimin e kontratës brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të vendimit për grante.

(2) Kontrata duhet t’i përmbajë patjetër të gjitha kushtet e cekura më poshtë:

- a. Qëllimet specifike të grantit;
- b. Kushtet dhe periudha e transferimit të grantit;
- c. Afati dhe mënyra e raportimit dhe shfrytëzimit të fondeve;
- d. Deklarata e përfituesit përmes së cilës ai zotohet se do të jetë i përgjegjshëm në pagesën e faturave, tatimeve dhe do t’i respektojë rregulloret që kanë të bëjnë me sigurimet sociale gjatë kohës së shfrytëzimit të fondeve;
- e. Deklarata e përfituesit përmes së cilës ai pajtohet të respektojë rregulloret që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik gjatë kohës së shfrytëzimit të fondeve;
- f. Deklarata e përfituesit përmes së cilës ai pajtohet me obligimet për të raportuar në lidhje me shfrytëzimin e fondeve publike;
- g. Deklarata e përfituesit përmes së cilës ai pajtohet me kontrollin fiskal për verifikimin e shfrytëzimit të ligjshëm të fondeve nga Zyra e kontrollit qeveritar, Zyra e auditorit shtetëror, institucionet tjera në bazë të rregulloreve të posaçme si dhe persona dhe institucione të caktuar nga ministri;
- h. Rastet e shkeljes dhe sanksionet për shkeljen e kontratës;
- i. Procedurat në rast të heqjes dorë;

- j. Deklarata e përfituesi përmes së cilës ai vërteton se nuk është në procedurë të bankrotimit apo likuidimit, dhe se zyra e prokurorit publik nuk ka iniciuar procesin e çregjistrimit nga regjistri i gjykatës;
- k. Bërja publike e të gjitha llogarive bankare të përfituesit, duke theksuar xhirollogarinë ku dëshiron të bëhet transferimi i grantit;
- l. Certifikatat tjera dhe deklaratimet, siç është paraparë me ligj.”

2. Modifikimi i kushteve të kontratës

Me rastin e planifikimit të projekteve duhet të merren parasysh edhe zhvillimet e paparashikuara, prandaj është e rëndësishme që në kontratë të theksohen rrethanat kur mund të ndryshohet ajo. Për këtë arsye kontrata duhet të ofrojë zgjidhje për rastet kur gjatë implementimit të projektit shfaqen ndryshime të paparapara të rrethanave.

Për shembull, kontrata mund të specifikoj:

- cilat ndryshime kërkojnë lajmërimin e financuesit dhe aprovimin e tij, kur dhe brenda cilave afate kohore përfituesi i grantit duhet të njoftojë donatorin për ndryshimet që tashmë janë implementuar dhe kur duhet njoftuar paraprakisht donatorin për ndryshimet e planifikuara;
- kur duhet të kërkojë përfituesi i grantit aprovimin për ndryshimin e planifikuar;
- kur mund të bëhet lajmërimi me gojë dhe kur duhet të bëhet me shkrim;
- kur duhet të bëhet modifikimi i kontratës për të mundësuar ndryshimin e propozimit.

Fondacioni kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile, Kroaci

Shembull kontrate:

“Organizata kontraktuese është e obliguar ta informojë Fondacionin në formë të shkruar dhe brenda afateve të përcaktuara mbi rrethanat objektive të cilat ndikojnë negativisht në implementimin e projektit (apo përkrahjes institucionale) brenda periudhës kohore për të cilën është rënë dakord, ashtu që palët të pajtohen me ndryshimin e obligimeve që burojnë nga kontrata.”

Fondacioni estonez (NFCS)⁵⁸ - procedurat për financimin e projekteve „Ideja e mire”:

6.4. “Qëllimi i NFCS-së është të përmirësojë kapacitetet e organizatave të financuara (duke përfshirë edhe kapacitetet e tyre financiare). Nga kjo rrjedh se në rast të shmangieve gjatë implementimit të projektit, NFCS-ja së bashku me partnerët e saj përpiqet të gjejë zgjidhje që siguron vazhdimin e implementimit të projektit, në përputhje me ligjin, rregulloret në fuqi si dhe kushtet e përcaktuara në thirrjen e hapur për garën „Ideja e mirë”. NFCS-ja do të caktojë një periudhë kohore për përmirësimin e të metave të konstatuara nga organizatat implementuese gjatë

⁵⁸ Procedurat për shpalljen e thirrjeve të hapura, procedimi i aplikacioneve dhe projekteve të „Idesë së mirë”, bërja publike dhe mbikëqyrja e implementimit të grantit www.kysk.ee/sisu/310_8739674_Procedures_for_announcing_open_calls_proceeding_applications_and_Good_Idea_projects_disclosing_and_monitoring_the_implementation_of_the_grant.pdf

implementimit të projektit. Eliminimi me kohë i të metave dhe vazhdimi i aktiviteteve tjera adekuate të organizatës implementuese i mundësojnë NFCS-së ta vazhdojë përkrahjen financiare”.

3. Çështja e afateve në kontratë

Një problem i zakonshëm është vonesa në procesin e kontraktimit. Ligjet dhe rregulloret rrallëherë caktojnë afate për përgatitjen e kontratës apo transferimin e pagesave. Përpos kësaj, nganjëherë, autoriteti për nënshkrimin e kontratave apo transferimin e pagesave mund të mos jetë në të njëjtin departament me atë që është përgjegjës për procesin e tenderimit të grantit. Si rezultat, edhe në rast se ekziston vullnet i mirë i të gjitha palëve, koha prej momentit të njoftimit të OSHC-ve për ndarjen e grantit deri në pranimin e fondeve mund të zgjasë disa muaj, madje deri në një vit.⁵⁹

Vonesat e tilla paraqesin problem serioz për të dyja palët. Problemet për OSHC-të shfaqen në planifikimin e programeve dhe menaxhimin e financave, meqenëse të shumtën e herëve programet kushtëzohen nga koha dhe vonesa ndikon në efikasitetin e projektit. Përpos kësaj, vonesa e një pagese të madhe mund të shkaktojë problem në financimin e veprimtarive të OSHC-ve. Nga ana tjetër, për organin qeveritar mund të shfaqen probleme me rastin e buxhetimit dhe llogarimbajtjes, sepse organi në fjalë duhet t’i shpenzojë fondet e veta brenda vitit fiskal, gjë që do të jetë e vështirë të arrihet nëse pagesat vonohen.

Një përjashtim interesant është paraparë në Kodin kroat, i cili thekson se organet shtetërore financuese duhet t’i përmbahen afatit prej 60 ditësh nga dita e ndarjes së grantit për finalizimin e kontratës.

Në Hungari, sipas afatit të aprovuar nga Këshilli, i cili është paraparë edhe në Udhëzues, aplikuesit duhet dhënë afat 40 ditë për dorëzimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara për finalizimin e kontratës nga dita e lajmërimit, pas së cilës kontrata do të nënshkruhet brenda 10 ditëve të ardhshme, ndërsa mjetet do të transferohen brenda 15 ditëve tjera. Duke pas parasysh gjithë kohë-shtrirjen, kontrata duhet të nënshkruhet jo më vonë se 165 ditë nga dita e dorëzimit të aplikacionit dhe transferimi i mjeteve do të realizohet brenda 180 ditësh.

4. Çështjet financiare gjatë kontraktimit

Një prej dispozitave kryesore të kontratës për financim është afati kohor i financimit. Ekzistojnë tre mënyra të zakonshme të transferimit të fondeve:

- (1) Rimbursimi i shpenzimeve pas performancës
- (2) Pagesa e grantit nga fillimi
- (3) Financimi me këste.

⁵⁹ Në disa nga shtetet e reja të BE-së është raportuar se periudha kohore nga vendimi për ndarjen e grantit e deri te kontraktimi ka zgjatuar një vit, për shkak të ballafaqimit me problemet fillestare të kontraktimit për fondet strukturale.

Duhet theksuar se problemet që hasen gjatë financimit të OSHC-ve dallojnë nga ato të financimit të subjekteve tjera ligjore. Gjendja financiare e OSHC-ve dallon nga ajo e organizatave tjera për profit për faktin se OSHC-të përgjithësisht nuk kanë qasje në kredi bankare, financim të barabartë dhe mjete të ngjashme për ngritjen e fondeve që do t'iu mundësonte atyre t'i përballojnë shpenzimet e aktiviteteve të projektit. Përpos kësaj, fondet e OSHC-ve zakonisht ndahen për projekte të veçanta, kështu që edhe një organizatë mirë e financuar mund të mos jetë në gjendje t'i ri-alokojë fondet për një projekt tjetër. Për këtë arsye rimbursimi shpenzimeve pas performancës mund të ndikojë seriozisht në aftësinë e OSHC-ve për t'i implementuar projektet. Meqenëse donatori qeveritar është i interesuar që projekti të implementohet në mënyrë të suksesshme, rimbursimi i mëvonshëm i shpenzimeve të OSHC-ve mund të konsiderohet praktikë e keqe.

Në rast se financimi bëhet me këste, në kontratë duhet theksuar qartë orari i pagesës dhe raportimit, sikurse edhe kërkesat tjera administrative që duhet plotësuar në mënyrë që të kryhet pagesa e secilit këst. Është praktikë e zakonshme që donatorët të mbajnë një pjesë të fondeve deri në përfundimin e plotë të projektit dhe pranimin e raporteve të auditimit. Përderisa kjo mund të konsiderohet praktikë e mirë, ia vlen të përkujtojmë se qëllimi kryesor i ndalimit së një pjese të fondeve bëhet si garanci kundrejt gabimeve të kohëpaskohshme financiare, shfrytëzimit jo të plotë të mjeteve, dështimit për të prezantuar shpenzimet etj., dhe nuk ka për qëllim të ndërhyjë në implementimin e projektit. Për këtë arsye, kësti përfundimtar mund të jetë mes 10-20% të shumës së përgjithshme (e jo, për shembull, 40-50% të shumës së mjeteve)

Fondacioni i Estonisë i lëshon mjetet financiare në përputhje me skemën e mëposhtme: kontrata nënshkruhet brenda pesë ditësh pas aprovimit të grantit nga Fondacioni, kur edhe bëhet pagesa e 50% të mjeteve. Pas dorëzimit të raportit fillestar – paguhet edhe 40% e grantit. Shuma e mbetur prej 10% jepet pas dorëzimit dhe miratimit të raportit përfundimtar.

IX. VLERËSIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Qeveria ka në dispozicion metoda të ndryshme për të vlerësuar efikasitetin e programeve të saj të granteve. Në këtë proces është me rëndësi të bëhet dallimi në mes (1) vlerësimit të projekteve të shpërblyera dhe (2) vlerësimit të programit të granteve (si në aspektin e procedurës ashtu dhe të përmbajtjes). Kjo është e rëndësishme sepse mund të ndodhë që projekti i shpërblyer të implementohet me sukses, por përkundër kësaj programi i granteve të mos arrijë qëllimin e proklamuar; kjo mund të ndodh, për shembull, në rastet kur programi ndjek një premisë të gabuar në strategjinë e tij (p.sh. programimin).

Sa për ilustrim, Fondi qytetar hungarez u vlerësua në mënyrë kritike nga Zyra e auditorit të shtetit pas dy viteve të para të veprimtarisë së tij. Zyra e auditorit të shtetit konstatoi se përderisa donacionet individuale – marrë në përgjithësi – ishin implementuar mirë, Fondi qytetar nuk kishte arritur të përmbushë në tërësi qëllimet e proklamuar statutores për shkak të vështirësive në përcaktimin e strategjive dhe metodologjisë së përkrahjes.

1. Pse duhet bërë vlerësimi?

Vlerësimi bëhet për të përcaktuar efikasitetin e programit për grante apo efikasitetin e ndonjë projekti individual:

- Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të programeve për grante zakonisht shërben si bazë për përmirësimin e tyre, duke mundësuar ngritjen e aftësive të ministrive apo agjencive donatore për arritjen e qëllimeve strategjike. Vlerësimi gjithashtu është i lidhur ngushtë edhe me planifikimin e skemave dhe programeve financuese në të ardhmen, për arritjen e qëllimeve strategjike.
- Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve individuale shërben, para së gjithash, për të siguruar menaxhimin e mirë dhe shfrytëzimin adekuat të fondeve dhe në mënyrë që organizatës t'i lëshohet pjesa e mjeteve të mbetura.

Parimet e mbikëqyrjes dhe raportimit proporcional, Angli⁶⁰

Për donatorët monitorimi dhe raportimi i mirë:

- Ndhmon për të siguruar “vlerën për paratë e dhëna”;
- Tregon se si po shpenzohen mjetet nga ana e përfituesit, dhe
- Demonstron ndikimin që ka financimi.

Për organizatat e financuara monitorimi dhe raportimi i mirë u ndihmon atyre të:

- Tregojnë punën që ata bëjnë, dhe
- Mësojnë dhe zhvillohen.

Qeveria duhet t'i ketë të qarta qëllimet që synohet të arrihen përmes procesit të vlerësimit dhe parimet në bazë të të cilave do të kryhet vlerësimi.

Instrumenti që ndihmon në marrjen e vendimit, Anglia vë theksin në parimet e mëposhtme:⁶¹

Monitorimi

Monitorimi ka të bëjë me mbledhjen e informacioneve dhe vlerësimin e tyre. Këto informata nevojiten për tre arsye:

1. *Menaxhimin e programit.* Këtu përfshihen informacione në lidhje me: progresin në arritjen e qëllimeve të programit, mënyrën e shfrytëzimit të financave të projektit, menaxhimin e rrezikut nga ju dhe donatori.
2. *Llogaridhënia më e madhe për programin dhe shpenzimet e programit ndaj zyrtarit të financave, ministrave, parlamentit dhe publikut.* Këtu mund të përfshihen informatat jo të domosdoshme për menaxhimin e programit, por që mund të jenë të nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve nga parlamenti apo informatat që mund të kërkojnë gjatë auditimit. Në rastin e tillë nevojitet një baraspeshë e ndjeshme. Mos kërkonit informata nga donatorët që do t'ju mundësonin juve të përgjigjeni në ndonjë pyetje të parashikuar, por bëni kërkesa

⁶⁰ <http://www.cabinetoffice.gov.uk/media/216752/principles.pdf>

⁶¹ Zyra e auditorit kombëtar, *Instrumenti që ndihmon në marrjen e vendimit për organet publike në Angli*, www.nao.org.uk/guidance_and_good_practice/toolkits/better_funding.aspx

për informacione të zakonshme. (Parashtrimi i mëvonshëm i kërkesave për informacione, posaçërisht kërkesave në baza ad-hoc, do të rris shpenzimet dhe do të krijojë frustrim)

3. *Zhvillimi i politikave*. Është e arsyeshme të kërkon nga donatorët tuaj të mbledhin dhe t'u ofrojnë informacione në lidhje me ambientin politik, që do t'ju ndihmojnë të zhvillonin strategjinë e bazuar në fakte. Edhe në këtë rast ju duhet të balanconi në mes të grumbullimit të 'çdo gjëje' dhe 'asgjëje'.

Evaluimi

Evaluimi është vlerësimi se deri në ç'masë programi i ka arritur qëllimet e tij. Kjo do t'ju ndihmojë juve dhe të tjerëve të përmirësoni dizajnin dhe aktivitetet e programit dhe të hartoni programe të reja. Ka dy lloje të vlerësimit:

1. *Vlerësimi sumativ* nënkupton vlerësimin e programit që është në zhvillim e sipër për një kohë të caktuar apo programit i cili ka përfunduar kohë më parë; kohëzgjatja mund të nxirret nga afati kohor i objektivave të programit.
2. *Vlerësimi formativ* e vlerëson programin në momentin e fillimit të implementimit dhe gjatë fazës së hershme.

Ju duhet të:

1. Përgatisni skemën e vlerësimit për programin tuaj që në fillim, në të kundërtën mund ta keni të vështirë t'i përcaktoni rezultatet e arritura;
2. Përfshini skemën e vlerësimit në marrëveshjen/marrëveshjet që arrini me donatorët;
3. Integroni, sa më shumë që është e mundur, kërkesën për informacion dhe grumbullimin e informacionit në kuadër të skemës për evaluim, me skemën për monitorim.

2. Çështjet që duhet marrë parasysh gjatë përgatitjes së mekanizmave vlerësuese dhe monitoruese

Çështjet që shtrohen më së shpeshti gjatë procesit të vlerësimit janë: kush e bën vlerësimin, çka vlerësohet dhe si kryhet vlerësimi.

Kush e bën vlerësimin?

Vlerësimi i grantit individuale mund të kryhet nga aktorët e mëposhtëm:

- Anëtari i personelit të organit qeveritar zakonisht kryen monitorimin dhe vlerësimin e grant projekteve individuale. Vlerësimi zakonisht përfshinë monitorimin e implementimit të grantit; miratimin e raporteve fillestare dhe përfundimtare; negocimin dhe miratimi e ndryshimeve, nëse për to shfaqet nevoja, etj.
- Në rastet tjera bëhet kontraktimi me pagesë i monitoruesve të grantit, me qëllim që ata ta përcjellin implementimin e projekteve dhe të propozojnë ndryshimet e nevojshme në lidhje me projektet e veçanta apo/dhe organizatat që kanë fituar grante.

- OSHC-të mund të ngarkohen të kryejnë vlerësimin e programeve të tyre dhe në këtë rast shpenzimet që lidhen me kryerjen e vlerësimit duhet të përfshihen në buxhetin e projektin.

Vlerësimi i programeve të granteve mund të bëhet nga organi shtetëror që implementon programin, agjencia e pavarur, këshilli i ngritur nga ministria kompetente apo nga vet qeveria. Në Hungari, për shembull, Zyra e auditorit shtetëror shqyrton periodikisht të gjitha agjencitë që shfrytëzojnë fondet publik.⁶² Këshilli për zhvillimin e shoqërisë civile në Kroaci është krijuar si organ këshillues për politikën që kanë të bëjnë me financimet publike. Kodi kroat thekson se Këshilli “do të mbikëqyrë, analizojë dhe vlerësojë asistencën e donatorëve që ofrojnë ndihmë financiare nga buxheti i shtetit përmes tenderëve për programet dhe projektet e shoqatave në Republikën e Kroacisë, në përputhje me këtë Kod.” Me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave, organet shtetërore/donatorët e ndihmës financiare duhet t’i dorëzojnë Këshillit dhe Zyrës së shoqatave informacionin në lidhje me programet dhe projektet e financuara.

Kodi maqedonas parasheh që:

Çdo organ i administratës shtetërore do ta vlerësojë procedurën për ndarjen e fondeve dhe rezultatet e arritura përmes aktiviteteve që ajo i ka përkrahur, duke u bazuar në raportet e dorëzuara nga shoqatat dhe fondacionet. Rezultatet e vlerësimit duhet t’i dorëzohen Njësisë për bashkëpunim me organizatat joqeveritare, në formë të raportit vjetor. Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare do ta informojë qeverinë një herë në vit në lidhje me mënyrën e shfrytëzimit të fondeve të ndara dhe për rezultatet e arritura. Organet qeveritare dhe shtetërore gjithashtu duhet ta vlerësojnë programin për financimin e OSHC-ve, që përbën bazën për skemën financuese, dhe të ofrojnë rekomandime që do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit dhe financimit të mëtutjeshëm të OSHC-ve.

Fondi i madh i lotarisë, Programi i mirëqenies kombëtare, shfrytëzojnë kombinimin e disa metodave të ndryshme për vlerësimin e projekteve:⁶³

1. Vetëvlerësimi i projekteve nga OSHC-të që bëjnë implementimin e tyre, i cili kryhet si gjatë implementimit ashtu edhe pas përfundimit të tij.
2. Pyetësorët: u dërgohen përfituesve të projekteve të implementuara nga OSHC-të, për të vlerësuar ndikimin e projekteve. Meqenëse projektet janë dizajnuar të promovojnë ushqimin e shëndetshëm, aktivitetin fizik dhe shëndetin mental, pyetjet kanë të bëjnë me ushqimin dhe aktivitetet e përfituesve.
3. Evaluimi i kryer nga vlerësuesit e jashtëm (të huaj);
 - Mbajtja e shtatë punëtorive para fillimit të projektit me qëllim të informimit të OSHC-të për mënyrën e vlerësimit;
 - Komiteti etik i krijuar për të monitoruar hulumtimin;

⁶² Megjithëse mandati i Zyrës së Auditorit të Shtetit Hungarez është para së gjithash të mbikëqyr respektimin e kërkesave legale dhe fiskale, ajo në mënyrë të përsëritur ka dhënë mendimin dhe këshillat e veta në çështje më të gjera të politikave dhe programeve, të cilat janë marrë parasysh nga qeveria dhe aktorët tjerë.

⁶³ http://www.biglotteryfund.org.uk/prog_well_being

- Është organizuar një ngjarje e përmasave të mëdha për të iniciuar lansimin e procesit të vlerësimit;
- Janë hartuar dy dokumente strategjike dhe janë publikuar tre informatorë me rezultate (informatorët u janë dedikuar aplikuesve potencialë për grant dhe sqarojnë mënyrën se si të përgatitet një projekt i suksesshëm).

Cka duhet vlerësuar?

Vlerësimi duhet të përqendrohet në atë se sa janë arritur rezultatet dhe qëllimet e projektit bazuar në aktivitetet e kryera. Nganjëherë aktivitetet duhet të ndryshojnë gjatë zhvillimit të projektit, në mënyrë që t'iu përgjigjen rrethanave të reja që mund të paraqiten. Prandaj, gjatë implementimit, monitorimit, vlerësimit dhe raportimit duhet të ekzistojë një nivel i caktuar i fleksibilitetit në mënyrë që projekti t'i plotësojë qëllimet dhe të ketë ndikimin e dëshiruar.

Metodat e vlerësimit

Vlerësimi i projekteve individuale mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Më poshtë janë prezantuar disa nga shembujt e mundshëm: dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare nga shfrytëzuesit e granteve, thirrjet telefonike, email-at e shkëmbyera, kontributet e palëve me interes ose vizitat e drejtpërdrejta. Vlerësimet drejtpërdrejta dhe monitorimi nga organet shtetërore mundëson që të sigurohen informacione më të detajuara në lidhje me projektin dhe problemet me të cilat ballafaqohen përfituesit e granteve gjatë implementimit të projektit. Në rastin e vizitave personale duhet respektuar procedurat dhe kërkesat ligjore (për shembull, njoftimi paraprak mbi vizitën; marrëveshja për kohën e vizitës; e drejta për të kontrolluar vetëm dokumentet që kanë të bëjnë me projektin, por jo edhe dokumentacionin konfidencial të organizatës). Me qëllim të shmangies së keqkuptimeve, marrëveshja për donacion duhet të përfshijë edhe dispozitat mbi monitorimin qeveritar.

Fondacioni i Estonisë (NFCS)⁶⁴ - procedurat e financimit të projekteve “Idea e mirë”:

7.2.2. Organizatat implementuese të projekteve duhet t'iu dorëzojnë raportet e përkohshme dhe përfundimtare të projektit, së bashku me deklaratat bankare, në përputhje me formularët e NFCS-së, brenda afatit të përcaktuar me kontratën e NFCS-së për implementim. Formularët për deklarimin e gjendjes do t'iu dërgohen implementuesve të projektit përmes postës elektronike brenda dhjetë ditëve të punës pas nënshkrimit të kontratës.

7.3. Vlerësimi, monitorimi dhe kontrollimi i mënyrës së implementimit të grantit përfshinë komunikimin me organizatën implementuese (ku përfshihet komunikimi përmes telefonit apo postës elektronike) me qëllim të informimit me ecurinë e implementimit të projektit, vizitat në terren (duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në ngjarjet që lidhen me projektin), dorëzimin e raporteve të përkohshme dhe përfundimtare të projektit në formën e aprovuar nga drejtori ekzekutiv i NFCS-së,

⁶⁴ Procedurat për shpalljen e thirrjeve të hapura, procedimi i aplikacioneve dhe projekteve të „Idesë së mirë”, bërja publike dhe mbikëqyrja e implementimit të grantit www.kysk.ee/sisu/310_8739674_Procedures_for_announcing_open_calls_proceeding_applications_and_Good_Idea_projects_disclosing_and_monitoring_the_implementation_of_the_grant.pdf

kontrollimin e tyre dhe ecurinë e projektit si dhe dorëzimin e dokumentacionit që e vërteton këtë ecuri.

7.4. Organizata implementuese obligohet të lejojë menaxhmentin dhe anëtarët e bordit mbikëqyrës së NFCS-ë si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave që të bëjnë vlerësimin, monitorimin dhe kontrollimin e projekteve të financuara nga NFCS-ja.

7.5. Të punësuarit në NFCS-ë bëjnë vizita të rregullta në terren në funksion të kontrollimit të implementimit të projekteve dhe marrin pjesë në ngjarjet e organizuara në kuadër të projektit. Të gjitha inspektimet do të regjistrohen në formularin për inspektimin e projektit, i cili miratohet nga drejtori ekzekutiv i NFCS-ë, ndërsa hapet pas nënshkrimit të kontratës për implementim. Formulari për kontrollimin e projektit përmban gjetjet e inspektorit në terren, gjendjen në të cilën ndodhet implementimi i projektit në momentin e komunikimit (sipas nevojës do t'i referohemi email-it), rezultatet e inspektimit të raporteve të përkohshme dhe atyre përfundimtare të projektit dhe, nëse ka nevojë, afatet për eliminimin e mangësive. Menaxherit të projektit do t'i dërgohet një e-mail përmes së cilit do të njoftohet me mangësitë e hasura gjatë inspektimit dhe afatet për eliminimin e tyre, i cili duhet të sigurojë përmirësimin e këtyre lëshimeve brenda afateve dhe ta njoftojë udhëheqjen e NFCS-ë gjithashtu përmes e-mail-it.

3. Kërkesat për raportim

Kërkesat për raportim do të varen nga lloji dhe fushëveprimi i programit për grante dhe nga projektet. Nëse vlerësimi i programit do të mbështetet në raporte, atëherë raportet duhet të përmbajnë informacione relevante që do ta mundësojnë vlerësimin e kërkuar. Këto janë kërkesat minimale që duhet t'i plotësoj një raport:

- Në rast të projekteve më të gjata, zakonisht kërkohet një apo disa raporte të ndërmjetme dhe një raport përfundimtar;
- Shfrytëzuesit e grantit duhet ta dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar në secilin rast;
- Pagesat e mbetura mund të shtyhen deri në aprovimin e raporteve të tilla;
- Kërkesat për raportim duhet t'i bëhen të ditura përfituesit të grantit paraprakisht, në kohën e nënshkrimit të kontratës, dhe duhet të jenë pjesë e kontratës.
- Informacioni i kërkuar në raportet narrative dhe financiare ndryshon dukshëm. Vendimmarrësit duhet t'i shqyrtojnë çështjet e përmendura më lartë.
- Raportimi duhet të përqendrohet në rezultate (për shembull, duhet mbledhur informacione mbi qëllimet, të arriturat, vlerësimin dhe reagimet (feedback-un) e përfituesit, mësimet e nxjerra etj.) dhe të lejojë pak fleksibilitet sa u përket aktiviteteve dhe ndarjes së buxhetit (për shembull, fleksibilitet për metodat dhe aktivitetet përmes së cilave janë arritur qëllimet)

- Dokumentimi i produkteve dhe rezultateve nuk duhet të ngarkohet me gjëra të panevojshme;
- Duhet të qartësohen rastet kur përfituesi i grantit duhet të ofrojë arsyetim për ndryshimet e bëra dhe rastet kur nevojitet aprovimi paraprak për ndryshimet e kërkuara.
- Detajet dhe volumi i raportit duhet të jetë në përputhje me fondet e shpenzuara për projektin.
- Koha e raportimit duhet të shqyrtohet me kujdes, sidomos në rastet kur OSHC-të duhet të mbështeten në fondet vetanake deri në arritjen e kështit të radhës.

Modelet për raportim

Organet shtetërore mund të përgatisin modele për raportimet narrative dhe financiare me qëllim që ta lehtësojnë dhe ndihmojnë procesin e raportimit. Kjo do të mundësojë që qeveria t'i marrë pikërisht ato informata për të cilat ka nevojë dhe ta ngushtojë fokusin e raportit vetëm në informacionet e nevojshme për vlerësimin e implementimit të projektit. Modeli mund t'u shërbejë organizatave si udhëzues për të sqaruar nëse dhe në ç'masë aktiviteti i financiar ka arritur rezultatet e dëshiruara, mësimet e nxjerra nga implementimi i projektit të cilat do të mund të shfrytëzoheshin në financimet e ardhshme dhe si të identifikohen nevojat e paplotësuara në fushën përkatëse.

Ministria për familje, çështje të veteranëve dhe solidaritetit mes-gjeneratave në Kroaci ka përgatitur modele për raportimet narrative dhe financiare për programet e ndryshme të financimit. Për shembull, modeli për raportimin mbi projektet që kanë të bëjnë me fëmijët kërkon informacionet e mëposhtme:

1. Përshkrim i shkurtër i qëllimeve të projektit;
2. Emri, data e saktë, kohëzgjatja dhe përmbajtja e secilit aktivitet;
3. Përshkrimi i rezultateve të arritura;
4. Numri i përfituesve të përfshirë në projekt;
5. Numri i atyre që e kanë implementuar projektin, për shembull numri i ekspertëve, vullnetarëve (dhe emrat e tyre);
6. Në ç'masë është implementuar projekti;
7. Informata për organizatat që kanë bashkëpunuar në projekt;
8. Informata për burimet tjera të financimit të shfrytëzuara për implementimin e projektit;
9. Përshkrimi i shkurtër i problemeve kryesore të shfaqura gjatë implementimit të projektit.

X. VËREJTJET DHE REKOMANDIMET PËRMBYLLËSE

Financimi publik është burim i rëndësishëm i financimit për OSHC-të në të gjitha shtetet e analizuara në këtë dokument. Mjete të rëndësishme për këtë sektor sigurohen përmes

kanaleve të ndryshme (për shembull, përmes ministrive të qeverisë, fondeve dhe fondacioneve) dhe burimeve (vijave buxhetore të buxhetit të shtetit, lojërave të fatit, mekanizmeve të përqindjes). Madje edhe në kohë krizash ekonomike shumica e qeverive janë përpjekur ta mbajnë nivelin e duhur të financimit për këtë sektor, edhe pse kjo nuk ka qenë gjithmonë e mundur.

Ndarja e resurseve shtetërore bëhet në përputhje me rregulloret dhe kodet që përcaktojnë parimet kryesore të financimit nga fondet publike dhe rregullojnë aspekte të ndryshme të këtij procesi. Këto korniza përmbajnë strategjitë dhe politikat për mbështetjen e shoqërisë civile. Secili nga katër shtetet e prezantuara në këtë dokument (Kroacia, Anglia, Estonia dhe Hungaria) ka krijuar fondet apo fondacionet nacionale të cilët janë dëshmuar si mekanizma efikase për shpërndarjen e fondeve publike me qëllim të mbështetjes institucionale të sektorit civil dhe projekteve të tij.

Disa nga parimet themelore janë të përbashkëta për të gjitha sistemet e shqyrtuara në këtë dokument. Për të qenë më specifik duhet thënë se këto parime garantojnë pavarësinë e sektorit; mundësojnë një proces transparent dhe llogaridhënës për mënyrën e ndarjes dhe shpenzimit të fondeve; mundësojnë trajtim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikuesit; dhe sigurojnë që proceset për shpërndarjen e fondeve dhe monitorimin e tyre të jenë adekuate.

Në shumicën e rasteve këto parime të përgjithshme janë inkorporuar në rregullore dhe ligje, në kuadër të rregullave specifike mbi proceset dhe kriteret që u janë besuar organeve të caktuara shtetërore apo fondeve kombëtare për të implementuar skemat financuese. Këto rregullore përfshijnë një varg çështjes mes të cilave edhe:

- Kohëzgjatjen e financimit (financim njëvjeçar apo shumëvjeçar);
- Llojet e përkrahjes (për shembull, përkrahje financiare apo mbështetje në shërbime dhe produkte);
- Nivelin e bashkëfinancimit të lejuar apo të kërkuar;
- Kriteret për kualifikim (për shembull, nëse aplikuesi duhet të ketë status të posaçëm juridik, siç është statusi i organizatave për përfitim publik);
- Rregullat e shpalljes së tenderit; dhe
- Procesin e vlerësimit dhe raportimit;

Shumica e proceseve efikase të financimit, të shqyrtuara në këtë dokument, kanë dy parime apo karakteristika kryesore të përbashkëta. Së pari, ato përcaktojnë paraprakisht dhe me kujdes synimet dhe strategjitë për arritjen e qëllimit të financimit dhe së dyti, procesi për ndarjen, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e fondeve është përcaktuar qartë dhe u është përshtatur qëllimeve specifike të financimit.

Rekomandimet e mëposhtme kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të procesit të financimit:

- Programet e financimit, thirrjet për propozime dhe planet strategjike duhet të përgatiten në **konsultim me palët me interes**.
- Programet e financimit duhet të jenë në dispozicion të publikut të gjerë, ndërsa organet përgjegjëse duhet të përgatisin **raporte** dhe të bëjnë **evaluimin** e rezultateve, në mënyrë që të mund vlerësohet ajo që është arritur dhe të jepen rekomandimet për përmirësime;

- **Financimi afatshkurtër** duhet të merret parasysh si mënyrë për të lehtësuar aplikimin e një numri të madh të OSHC-ve dhe ta ndihmojë qeverinë për ta mbikëqyrur më lehtë efikasitetin e procesit brenda sektorit.
- Duhet ofruar **grante afatgjate (shumëvjeçare)** për të inkurajuar dhe ndihmuar projektet komplekse dhe për të mundësuar financimin më të sigurt të OSHC-ve.
- Në rastet kur kërkohet **bashkëfinancim** - ai duhet të jetë racional dhe të planifikohet bazuar në rrethanat specifike të projektit dhe gjendjes së përgjithshme financiare të sektorit;
- Shtetet duhet të shqyrtojnë zbatimin e skemave të cilat mundësojnë **financimin institucional** për zhvillimin e sektorit, me qëllim që t'i plotësojnë skemat ekzistuese financimit. Financimi institucional ndihmon në krijimin e një sektori të fuqishëm dhe siguron financim afatgjatë dhe më efikas të projekteve dhe në këtë **mënyrë luan një rol të rëndësishëm** në adresimin e nevojave qytetare dhe të komunitetit. Sidoqoftë, skemat e tilla është vështirë të përgatiten dhe kërkojnë planifikim të gjithanshëm. Organi i ngarkuar për të dizajnuar, zbatuar dhe mbikëqyrur realizimin është pjesë e rëndësishme e skemave të suksesshme (shembujt të mirë janë fondacionet kroate, estoneze dhe hungareze).
- Është i domosdoshëm një **proces transparent i financimit** me kritere të qarta për të udhëhequr fazat e ndryshme të procesit të financimit. Kriteret e tilla mund të përgatiten para publikimit të thirrjes për propozime dhe duhet të jenë në dispozicion të OSHC-ve dhe publikut të përgjithshme në kohën e publikimit të thirrjes.
- **Thirrja për propozime** duhet të jetë e kuptueshme nga lexuesit; të përfshijë të gjitha informatat e nevojshme për përgatitjen e propozimit të mirë; të sqarojë qartë qëllimet që synon t'i arrijë; dhe t'i përfshijë të gjitha informatat e nevojshme teknike dhe procedurale për të aplikuar. Dokumentet e kërkuara duhet të jenë proporcionale me fondet në dispozicion.
- Thirrja për propozime, rezultatet e procesit të përzgjedhjes dhe rezultatet e raporteve/evaluimeve duhet të **publikohen gjerësisht** përmes kanaleve të ndryshme.
- Palëve të interesuara **duhet ofruar kohë e mjaftueshme** për përgatitjen e propozimeve në përgjigje të thirrjes së caktuar për propozime. Praktika e paralajmërimit të shpalljes së thirrjeve për propozime para publikimit të saj, me qëllim që OSHC-ve t'iu ofrojë kohë të mjaftueshme për të planifikuar dhe përgatitur aplikacionin, konsiderohet praktikë e mirë.
- Donatorët duhet të përcaktojnë, shpallin dhe respektojnë **afatet kohore** për marrjen e vendimeve për ndarjen e granteve.
- **Procesi i vendimmarrjes** duhet të bazohet në kritere objektive duke marrë parasysh çështjet që do të ndihmojnë në shmangien e konflikteve të mundshme të interesit. Vendimet mund të merren nga palët e ndryshme, por qeveritë apo agjencitë përkatëse duhet të sigurojnë që të gjithë këta aktorë të kanë njohuri për programet e financimit, të jenë të kualifikuar për skemat e grant-dhënies dhe të mos kenë interes personal nga procesi. Metoda specifike e përzgjedhjes duhet të jetë proporcionale me madhësinë e programit, numrin dhe volumin e aplikacioneve të pranuar dhe numrin e anëtarëve të organit vendimmarrës.

- Duhet të ekzistojnë **procedura të qarta të kontraktimit dhe pagesës** në mënyrë që t'u mundësojë OSHC-ve ta ekzekutojnë projektin e dhënë në mënyrë të suksesshme.
- **Kërkesat për raportim** duhet të varen nga lloji dhe fushëveprimi i programit dhe projektit. Raportimi duhet të përmbajë informacione relevante për zbatimin dhe vlerësimin e projektit.
- Me qëllim që ta ndihmojë procesin e aplikimit, përzgjedhjes, raportimit dhe vlerësimit, qeveria mund të përgatis **modele të posaçme** (për shembull, formularët për propozime dhe raportime narrative, formularët për propozimin e buxhetit dhe raportim, tabelat vlerësuese etj).
- Duhet **vlerësuar** si efikasitetin e projekteve individuale ashtu edhe efikasitetin e programit të granteve në tërësi. Rezultatet e vlerësimit ndihmojnë në identifikimin e masave tjera të nevojshme për arritjen e qëllimeve dhe përgatitjen e rekomandimeve për përmirësimin e projekteve, në mënyrë që ato të përballen më lehtë me sfidat dhe rreziqet në të ardhmen dhe të promovojnë praktikatat më të mira.

BIBLIOGRAFIA

- Bullain, Nilda, "Mësimet e nxjerra nga Fondi kombëtar qytetar në Hungari," ECNL, 2008
- Kroaci, *Kodi i praktikës së mirë, standardeve dhe kritereve për ndarjen e granteve për programet dhe projektet e shoqatave*, 2007
- Kroaci, Fondacioni kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile, *Shpallje për përkrahje institucionale*
- Kroaci, Fondacioni kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile, *Së bashku për më mirë program financues*
- Kroaci, Fondacioni kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile, *Rregullorja mbi kushtet dhe procedurat për ndarjen e fondeve për përmbushjen e qëllimeve të fondacionit*, 2005
- Kroaci, Ministria e familjes, çështje të veteranëve dhe solidaritet mes gjeneratave, *Modele për raportimin mbi projektet që kanë të bëjnë me fëmijët*
- Angli, *Marrëveshja mbi raportet në mes të qeverisë dhe sektorit të tretë në Angli*, 2009
- Angli, "Zyra e sektorit të tretë- Implementimi i kompensimit të plotë të shpenzimeve" Raport 2007
- Angli, Fondi i madh, Programi i tranzicionit, 2010
- Angli, Fondi i madh i lotarisë, Grant programi "Të rinjtë në fokus", 2010
- Angli, *Fondi i madh i lotarisë, Programi i mirëqenies kombëtare*, 2006
- Estoni, "Zbatimi i aktiviteteve në interes të publikut të shoqatave jo-për-profit dhe fondacioneve që përfitojnë nga lehtësimet në tatimin në të ardhura" Bordi i Tatimeve dhe Doganave
- Estoni, *Rregulloret e financimit të fondacionit kombëtar për shoqëri civile*
- Estoni, *Kodi i etikës së organizatave estoneze jo-për-përfitim*
- Estoni, *Koncepti i zhvillimit të shoqërisë civile – EKAK*, 2002
- Estoni, *Thirrja për financim operacional të OSHC-ve rajonale të Fondacionit kombëtar për shoqëri civile*, 2010
- Estonia, *Procedurat për financimin e projekteve „Ideja e mirë” të Fondacionit kombëtar për shoqëri civile*
- Estoni, Fondacioni kombëtar për shoqëri civile, *Kriteret për vlerësimin kritik*
- Estoni, Fondacioni kombëtar për shoqëri civile, *Përmbajtja e kritereve vlerësuese*
- Qendra evropiane për Ligjin jo për përfitim, "Financimi publik i organizatave të shoqërisë civile në Evropë: Parimet dhe praktiket e tenderimit", 2010
- Komisioni Evropian, "Iniciativat publike dhe vetërregulluese të kohëve të fundit për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organizatave jo-për-profit në Bashkimin Evropian", hartuar nga ECNL, 2009
- Hadzi-Miceva., Katerina, dhe Bullain, Nilda, "Kornizë mbështetëse financiare për organizatat socio-ekonomike" në Ekonominë Sociale – Krijimi i Ekonomive Ekskluzive (OECD Programi për Zhvillimin Lokal dhe Punësim (LEED), 2007
- Hadzi-Miceva, Katerina, "Mekanizmat ligjorë dhe institucional për bashkëpunimin e Qeverisë dhe OJQ-ve në Hungari, Estoni dhe Kroaci", në "Organizacje pozarçadoëe.

Dialog obyęatelski. Polityka państęa,” edituar nga Marek Rymysza, publikuar nga Instituti pęr cęshtje Publike, Poloni, 2007

Hadzi-Miceva Katerina, dhe Suplisson, Fabrice, “Vęshtrim i skemave tę financimit shtetęror pęr organizatat e shoqęrisę civile”, EU, ECNL dhe COĒI/A (2007)

Hadzi-Miceva-Evans, Katerina, *Praktikat evropiane mbi implementimin e dokumenteve tę politikave dhe zyrove ndęrlidhęse qę mbęshtesin zhvillimin e shoqęrisę civile*, ICNL dhe ECNL, 2009

Hadzi-Miceva Evans, Katerina, “Lojęrat e fatit si instrument i mbęshtetjes sę kauzave tę mira tę organizatave tę shoqęrisę civile – fat apo koncept i planifikuar?”, nę „Trzeci Sektor” quarterly (Katerina Hadzi-Miceva „Loterie charytatyęne ě Europie. Ęspółczesne rozęiazania ě ěybranych krajach”, issue 22, 2010

HM Thesari, Pęrmiręsimi i marrędhęnieve financiare me sektorin e tretę: udhęzues pęr donatoręt dhe pęrfituesit, Maj 2006

Hungari, Ligji numęr 2003/L mbi Fondin civil kombętar

Hungari, Vendimi numęr 43/2009 i Kęshillit tę Fondit civil kombętar pęr pęrcaktimin e fazave tę vendimmarrjes (4 prill 2009)

Hungari, 160/2003. (X. 7.) Rregullorja qeveritare mbi implementimin e Ligjit No. 2003/L. mbi Fondin civil kombętar

Hungari, *Skema e udhęzuesve pęr thirrje pęr propozime tę Fondit kombętar civil*

Qendra ndęrkombętare pęr Ligjin jo-pęr-pęrfitim (ICNL), “Fondet kombętare pęr pęrkrahjen e organizatave tę shoqęrisę civile” pęrgatitur nga ICNL pęr Ministrinę e Zhvillimit Social tę Mbretęrisę Hashemite tę Jordanisę

Kubar, Urmo., “Koncepti pęr zhvillimin e shoqęrisę civile nę Estoni (EKAK): Kornizę pęr bashkępunim nę mes tę sektorit tę tretę dhe atij publik: Vęshtrim i shkurtęr dhe disa męsime tę nxjerra”, Konferenca Evropiane „Si tę forcohet dialogu civil nę Evropę”, Bruksel, 15 maj 2008

Maqedoni, *Kodi i praktikave tę mira pęr pęrkrahjen financiare tę OSHC-ve*, 2007

Maqedoni, *Programi pęr financimin e aktiviteteve programore tę shoqatave dhe fondacioneve*, 2009

Maqedoni, *Vendimi pęr pęrcaktimin e kritereve pęr distribuimin e financimit tę aktiviteteve programore tę shoqatave dhe fondacioneve nga buxheti i Republikęs sę Maqedonisę*, 2009

Moore, D., Hadzi-Miceva, K., dhe Bullain N., *Vęshtrim krahasues i statusit pęr pęrfitim publik nę Evropę*, Gazeta ndęrkombętare e Ligjit jo-pęr-pęrfitim, Volumi 11, Numri 1, nęntor 2008

Zyra e Auditorit Kombętar, *Instrumenti qę ndihmon ne marrjen e vendimit pęr organet publike nę Angli*

NCVO, *Shteti dhe Sektori Vullnetar; Trendet e fundit nę financimin qeveritar dhe ofrimin e shęrbimeve publike*, 2009

NCVO, Komisioni financues, *Dokumenti numęr 4 – Financimi i sektorit publik- konstatimet dhe rekomandimet e nxjerra*, 2010

Zyra pęr Bashkępunim me Shoqatat, *Raport mbi ndihmęn financiare dhęnę projekteve dhe programeve tę organizatave tę shoqęrisę civile*, 2009

Vidacak, Igor, “*Krijimi i standardeve dhe mekanizmave për financimin publik të OJQ-ve në Kroaci*”, Gazeta zyrtare e Ligjit jo për profit (JNL)

Indeksi i qëndrueshmërisë së OSHC-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazi, për vitet 2008 dhe 2009, USAID